Rruga e Arbërit

SKËNDERBEUT - 2018 - VITI MBARËKOMBËTAR I GJERGJ KASTRIOTIT

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 12 (152) / 2018. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Profil

Ilmi Murati, themeluesi i "Riu-Mermer" që po konkuron në tregun europian

Nga **SHAQIR SKARRA**



Histori

Origjina dhe vendlindja e Skënderbeut


Nga **BARDHYL HOXHA**



Intervistë

Erman DINE: Ëndrra amerikane është ëndërr shqiptare

Nga **YGERTA GJELESHI**



Rruga e Arbrit, **punimet vazhdojnë** *me ritme të shpejta*

Që nga 28 mars 2018, kur qeveria shqiptare vendosi firmën mbi kontratën koncensionare për Rrugën e Arbrit me kompaninë Gjoka Konstruksion, punimet në terren kanë ecur me ritme të shpejte. Inagurimi i punimeve u bë zyrtarisht më 17 qershor 2018 në Klos, por në terren punimet filluan që në fund të vitit 2017 në vendin e quajtur Ura e Cerenecit. Në fillim të shkurtit të këtij viti, ndërsa u firmos marrëveshja mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në luginën e lumit të Tiranës, pranë Zall Bastarit, punimet kishin filluar.

Lajmet se si po ecin punimet, përveç segmentit Ura e Cerenecit - Maqellarë që janë vazhdimisht nën syrin e publikut, segmentet e tjera vijnë shpesh përmes postimeve në Facebook të Kryeministrit të vendit dhe ndonjë punonjësi të kompanisë.

Vetëm brenda dhjetorit, Kryeministri Edi Rama shkroi dy statuse në FB. Më 5 dhjetor Kryeministri përcolli një foto nga ura mbi lumin Drin në Gjoricë, dhe shkruan: "Një kartolinë me një përqafim nga larg për ata që përqeshnin 3D e Rrugës së Arbërit: Kjo është ura e re mbi Drin, në Gjoricë/Maqellarë, pjesë e shtratit të Rrugës së Arbërit, ku po punohet me ritme e cilësi të lartë, nën supervizionin e një kompanie të specializuar gjermane, të kontraktuar nga shteti shqiptar për mbikqyrjen e punimeve".

(Vijon në faqen 2-3)



Ura mbi Drin

NË BRENDËSI:

- Roli i komunitetit në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve bashkiake
- 2018, një vit me prodhim, por pa treg
- Kampionët tanë të botës!
- Cubat e Dibrës
- Karakteri atdhetar i luftërave të Skënderbeut, themelues i shtetit të parë kombëtar shqiptar
- Poetët nuk vdesin kurrë
- "Shtëpia prej fjale", me Islamin në prag!
- "Vikama e Skënderbeut",një poemë dhe poezi të suksesshme të autorit Astrit Gjunkshi

EKONOMI

Bimët aromatike dhe mjekësore, një potencial i rëndësishëm zhvillimi

Nga **OSMAN XHILI, VULLNET TAFA**

Rajoni në të cilën shtrihet territori administrativ i Bashkisë Dibër është ndër më të pasurit përsa i përket shumëllojshmërisë dhe përhapjes së fondit të bimëve aromatike dhe mjekësore. Kushtet e përshtatshme klimaterike dhe tokësore kanë bërë të mundur praninë e shumë llojeve bimësh mjekësore të rritura në mënyrë spontane dhe në gjendje të egër me vlera të larta aromatike dhe mjekësore që përbëjnë një pasuri të çmuar jo vetëm në aspektin e florës dhe të biodiversitetit,por edhe në atë ekonomik,si një burim i rëndësishëm të ardhurash për ekonominë lokale.

(Lexoni në faqen 4)

AKTUALITET

Mungesa e ekspertëve zvarrit gjyqin mes HEC-it dhe një rezervati peshku në Dibër

Nga **Hysen LIKDISHA**

Një gjyq mes kompanisë së kultivimit të peshkut Bio-Trofta në Dibër dhe asaj të hidrocentralit "Balkan Green Energy"(BGE), të cilat shfrytëzojnë rrjedhën e lumit Seta për bizneset e tyre zgjat prej gati dy vjetësh pa zgjidhje në Gjykatën e Shkallës së Parë në Dibër. Gjykimi filloi pas një padie të Bio Troftës ndaj BGE për një dëm në vlerën 300 mijë euro në dhjetor 2016 dhe është është ende larg përfundimit. Ndërkohë, të dy palët dhe gjykata pranojnë se nevoja për një sërë ekspertizash dhe mungesa e eskpertëve ka qenë shkak i zvarritjes së procesit gjyqësor.

(Lexoni në faqen 5)

HISTORI

Elez Isufi, dibrani që u dekorua nga mbreti i Austro-Hungarisë

Nga **ISMAIL STRAZIMIRI**

Kujtoj se asht e tepërt me u zgjat në përshkrimin e gjendjes s'administratës, kur ishte Ahmet Zogu kryeministër e ministër i Punëve të Mbrendshme, mbasi të interesuemit e dinë fare mirë. Veprimet arbitrare dhe ilegale provokuen që të bahesh antentati kundër Ahmet Zogut në parlament. Ahmet Zogu shpëtoi me nji plagë të vogël në dorë. Por, përveç disa pak besnikëve të tij, gjithë populli dhe ushtria u çue kundër tij dhe banë Revolucionin e Qershorit, i cili përfundoj me fitimin e kryengritësve dhe me ikjen jashtë Atdheut të Ahmet Zogut me shokët e vet... Elez Jusufi e çmonte delikatesën e gjendjes së turbullueme, prandaj herë pas here i shkruente ...

(Lexoni në faqen 15)

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 12 (152). Dhjetor 2018
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit dhjetor 2018.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA / BIRN
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI
Grehans UKA
Arsim KOLARI

Kontribuan për këtë numër:
Xhafer MARTINI
Vullnet TAFA
Sami Curri
Bardhyl Hoxha
Ahmet PRENÇI
Ygerta GJELESHI
Besnik KËBEJ
Ali HOXHA

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **ëëë.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Rruga e Arbrit, **punimet**

“Është një vepër që do të kushtojë 240 milionë euro dhe në këtë kontratë ne kemi parashikuar që shteti do të marrë përsipër të likujdojë kontraktorin brenda një periudhe 13 vjeçare. Kontraktori do të marrë përsipër të ndërtojë rrugën në fillim me shpenzimet e tij dhe mirëmbajtjen e kësaj rruge gjatë gjithë periudhës së koncesionit



Pamje nga punimet te Ura e re e Vashës. Aty po vazhdojnë ndërtimin e dy këmbëve të urës, e cila do të jetë e gjatë 280m dhe me lartësi 152m. Profilet e urës po prodhohen në Turqi.

Foto: B.Karoshi

Që nga 28 mars 2018, kur qeveria shqiptare vendosi firmën mbi kontratën koncensionare për Rrugën e Arbrit me kompaninë Gjoka Konstruksion, punimet në terren kanë ecur me ritme të shpejte. Inagurimi i punimeve u bë zyrtarisht më 17 qershor 2018 në Klos, por në terren punimet filluan që në fund të vitit 2017 në vendin e quajtur Ura e Cerenecit. Në fillim të shkurtit të këtij viti, ndërsa u firmos marrëveshja mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në luginën e lumit të Tiranës, pranë Zall Bastarit, punimet kishin filluar.

Lajmet se si po ecin punimet, përveç segmentit Ura e Cerenecit - Maqellarë që janë vazhdimisht nën syrin e publikut, segmentet e tjera vijnë shpesh përmes postimeve në Facebook të Kryeministrit të vendit dhe ndonjë punonjësi të kompanisë.

Vetëm brenda dhjetorit, Kryeministri Edi Rama shkroi dy statuse në FB. Më 5 dhjetor Kryeministri përcolli një foto nga ura mbi lumin Drin në Gjoricë, dhe shkruan: “Një kartolinë me një përqafim nga larg për ata që përqeshnin 3D e Rrugës së Arbërit: Kjo është ura e re mbi Drin, në Gjoricë/Maqellarë, pjesë e shtratit të Rrugës së Arbërit, ku po punohet me ritme e cilësi të lartë, nën supervizionin e një kompanie të specializuar gjermane, të kontraktuar nga shteti shqiptar për mbikqyrjen e punimeve”.

Dhjetë ditë më pas, ai përcolli sërish një video 80 sekondëshe ku jepen pamje nga punimet në urën e Vashës dhe në urat mbi lumin Drin dhe Zallin e Bulqizës.

“Me këto pamje nga kantieri i rrugës së Arbrit ku pas hapjes së tre tuneleve po punohet intensivisht edhe për Urën e Vashës, ju uroj një ditë të mbarë”, shkroi ai në Facebook në orën 8 të mëngjesit.

Një informacion se si po ecin punimet përcolli edhe deputetja e Dibrës, Almira Zebi Xhembulla. Gjatë fjalës së saj në Parlament, në kuadrin e miratimit të buxhetit 2019, ajo theksoi se “në këtë rrugë po punohet për ndërtimin e trasesë të rrugës në të gjithë gjatësinë e saj, me përjashtim të 4 km në Fshatin Shkallë. Nga 6 tunele qe ka projekti i Ndërtimit të Rrugës së Arbërit, deri më sot janë hapur 2 prej tyre, është në përfundim tuneli i tretë dhe po punohet për hapjen e tunelit të Murrizit. Gjatësia e tuneleve të hapur është 1.55 km, nga rreth 8 km gjithsej që ka projekti. Gjithashtu është përfunduar hapja e tunelit nr.5 me gjatësi 500m, tunelit nr. 6, që është 360 m i gjatë, si dhe brenda javës pritet të përfundoj hapja e tunelit nr.4 me gjatësi 370m. Ndërkohë tek tuneli i Murrizit deri më sot në të dy tubat e tij janë hapur 360 m tunel”.

Ajo theksoi edhe volumin e madh të punës që po bëhet për ndërtimin e Urës së Vashës, e cila ka një gjatësi 280m dhe lartësi 152m.

Korrespondentët tanë ishin në terren gjatë fillimit të muajit dhe konstatuan se aty po punohej për ndërtimin e dy këmbëve të urës së Vashës në të dy brigjet e lumit Mat, si dhe u konstatua se disa kamionë nga Turqia po shkarkonin profilet e urës, që pritet të fillojë montimin menjëherë pas ndërtimit të këmbëve.

DEBATI POLITIK

Debati politik e ka shoqëruar rrugën e Arbrit që nga nisja. Por gjatë këtij viti ka qenë edhe një çështje që palët kanë akuzuar njëra-tjetrën për “nënshkrim kontratash me daulle” dhe “abuzime me fondet publike”

“Rruga e Arbrit është një çështje drejtësie! Drejtësi e historisë, po aq sa drejtësi njerëzore ndaj një populli të tërë të kyçur këtu brenda në izolim prej kaq shumë e shumë dekadash. Drejtësi që shteti shqiptar ka detyrën absolute dhe shtrëngim moral ta vërë dhe ta garantojë një herë e përgjithmonë!”, tha kryeministri në inagurimin e punimeve më 17 qershor në Klos.

“Rruga u la rrugëve për 20 e kusur vite dhe nëse do të ishin bërë gjërat me mend, me projekte dhe me radhë, Rruga e Arbrit do të kishte përfunduar të paktën 10 vjet më parë”, tha Rama atëherë duke shënjestruar me deklaratat e tij qeverinë e Partisë Demokratike.

Deputeti Xhemal Gjunkshi organizoi protesta kundër tubimeve të kryeministrit në atë kohë dhe akuzoi qeverinë për abuzime dhe shpërdorime të financave publike.

“Rruga Arbërit duhet bërë sa më parë por jo duke u dhënë oligarkëve falas 160 milion euro”, shkroi në një status në FB më 15 nëntor deputetja e Dibrës Dhurata Çupi Tyli, 15 nëntor. Ajo akuzon qeverinë se “Rruga duhet bërë për banorët e Dibrës jo për të certifikuar mega-vjedhjen e radhës të kësaj qeverie. Rruga e Arbërit ka qenë projekt prioritar i qeverisë Berisha, por jo si një projekt për hajdutët por për qytetarët. Dëgjova ministrin e financave të akuzojë opozitën që nuk e don ndërtimin e rrugës. Po, po dhe dhe Po, e duam rrugën por jo për të vjedhur ju, sepse ky projekt parashikohej të kryhej për 140 milionë euro dhe jo për të dërguar në xhepat tuaj të paktën edhe 160 milion euro taksa te Dibraneve duke i adresuar kësaj rruge një shumë prej 300 milion euro.

Kosto e rrugës ka qenë një debat i vazhdueshëm mes qeverisë dhe opozitës për vite ma radhë, duke sjelle shpesh herë

Edhe për shkak se gazeta ka një pune 12 vjeçare në lobimin për këtë çështje, interesi i lexuesve është të marrë më shumë informacion të drejtë dhe të paanshëm, por kjo nuk është bërë e mundur. Shpresojmë se në vazhdim do të kemi një bashkëpunim të dyanshëm me kompaninë për këto pyetje dhe të tjera që janë me interes publik.

vazhdojnë *me ritme të shpejta*

Në gusht të këtij viti Qeveria Shqiptare hapi edhe një tender për përzgjedhjen e kompanisë që do të mbikqyrë punimet në Rrugën e Arbrit. Ndërsa më 1 nëntor, është përzgjedhur edhe kompania fituese, që është një bashkim i operatorëve ekonomikë "GR Albania" me qendër në Tiranë dhe kompanisë gjermane "Gauff GmbH & Co Engineering" me qende në Nurnberg.
Dy kompanitë kanë fituar tenderin prej afro 3.5 milionë euro (pa tvsh) për të mbikqyrur punimet në Rrugën e Arbrit.

konfuzion në shifra dhe interpretimin e tyre.

"Është një vepër që do të kushtojë 240 milionë euro dhe në këtë kontratë ne kemi parashikuar që shteti do të marrë përsipër të likujdojë kontraktorin brenda një periudhe 13 vjeçare. Kontraktori do të marrë përsipër të ndërtojë rrugën në fillim me shpenzimet e tij dhe mirëmbajtjen e kësaj rruge gjatë gjithë periudhës së koncesionit", pati theksuar ish-Ministri i Infrastrukturës Damian Gjiknuri në shkurt të këtij viti.

Gjiknuri ishte edhe ministri që, gjatë përurimit të një projekti të kompanisë celulare Vodafone, bëri një udhëtim virtual në rrugën e Arbrit, duke vëzhguar punimet me anë të rrjetit Gigabit. Direkt nga zyrat e Vodafone, pa nevojën për të udhëtuar drejt kantierit të ngritur në zonën e Klosit, Ministri Gjiknuri monitoroi në kohë reale ecurinë e punimeve në rrugën e Arbrit, nëpërmjet një lidhjeje direkte nga kamera e dronit në syzet VR. "Ky është një hap përpara për industrinë. Kjo përvojë mund të dëshmojë që koncesionet e rrugëve po punojnë", tha ai.

Në gusht të këtij viti Qeveria Shqiptare hapi edhe një tender për përzgjedhjen e kompanisë që do të mbikqyrë punimet në Rrugën e Arbrit. Ndërsa më 1 nëntor, është përzgjedhur edhe kompania fituese, që është një bashkim i operatorëve ekonomikë "GR Albania" me qendër në Tiranë dhe kompanisë gjermane "Gauff GmbH & Co Engineering" me qende në Nurnberg.

Dy kompanitë kanë fituar tenderin prej afro 3.5 milionë euro (pa tvsh) për të mbikqyrur punimet në Rrugën e Arbrit.

QYTETARËT PRESIN MË SHUMË INFORMACIONE NË KOHË REALE

Pavarësisht se qeveria shprehet e angazhuar për vazhdimin me shpejtësi të punimeve dhe ato duket se po ecin mirë në terren, një peticion online vazhdon të qëndrojë i hapur në change.org. Peticioni, i nisur që në mars të vitit 2013, megjithëse nuk është marrë parasysh nga qeveria, vazhdon të mbledhë firma për këtë.

Një anëtar i grupimit, i kontaktuar përmes faqes së tyre në facebok, iu përgjigj pyetjes sonë se cili është qëllimi që peticioni mbetet i hapur, edhe pse punimet në terren vazhdojnë.

"Ne jemi koherent me qëndrimin tonë fillestar. Të zhgënjyer nga premtimet elektorale të partive që kur kjo histori nisi në vitin 1995, ne kemi premtuar se peticionin do ta mbyllim kur të mbarojë edhe metri i fundit i rrugës. Ne jemi në dijeni të ecurisë së punimeve, theksohej në përgjigjen e tyre përmes Facebook-ut, pasi ndjekësit tanë në dërgojnë vazhdimisht fotografi nga terreni ku po kryhen punimet. Por ne jemi akoma larg metrit të fundit të rrugës. Ndaj nuk është koha për të shprehur besim të tepruar. Kur rruga të përfundojë, të gjithë do të jemi të fituar."



Postimi i kryeministrit Edi Rama më 5 dhjetor, që njofton përfundimin e urës mbi Drin



Një kampion Duke u shkarkuar profilet e urës së Vashës nga një kamion i ardhur nga Turqia.
Foto: B.Karoshi

Gazeta ka nisur vazhdimisht emaile në adresën zyrtare të kompanisë në Ëeb, por deri më tani nuk kemi marrë përgjigje. Disa pyetje që shqetësojnë publikun që kanë të bëjnë me cilësinë e punimeve, kompanitë e specializuara që po punojnë në terren, kalendarin e punës sipas kantierëve ku po punohet, garancitë që punimet nuk do të ndërpriten, e të tjera çështje që kanë interes për publikun, nuk kanë marrë një përgjigje zyrtare. Edhe për shkak se gazeta ka një pune 12 vjeçare në lobimin për këtë çështje, interesi i lexuesve është të marrë më shumë informacion të drejtë dhe të paanshëm, por kjo nuk është bërë e mundur. Shpresojmë se në vazhdim do të kemi një bashkëpunim të dyanshëm me kompaninë për këto pyetje dhe të tjera që janë me interes publik.

TË DHËNA MBI PROJEKTIN

Rruga e Arbrit është e përfunduar plotësisht në 20.12 km, 15.175 km janë përfunduar pjesërisht si dhe ka një projekt ekzistues edhe për 26.372 km. Në total janë 61.667 km të projektuar për gjurmën kryesore me standardin C3, nga të cilët 26.372 km nuk janë prekur me punime ndërtimi. Sipas Studimit te fizibilitetit te hartuar rreth vitit 2005 e gjithë gjurma Tiranë-Bllatë sipas këtij varianti pritet të jetë afërsisht rreth 73.5 km e gjatë, çka do të thotë që afërsisht ne total 11.8 km rrugë janë ende të pa projektuar (gjatësi ne skajin e lidhjen me Tiranën dhe gjatësi në skajin e lidhjes me Blladën - pika kufitare).

Në këto kushte Projekt Ideja për "Përmirësim, Ndërtim, Operim, dhe Mirëmbajte e Rrugës se Arbrit" për kompletimin e të gjithë gjurmës së Rrugës së Arbërit qe përfshin: projektet e segmenteve të pa projektuar(skajet lidhëse) , përmirësimin e projekteve të segmenteve ku punimet janë ende të papërfunduar me synimin e përmirësimit të tyre nga standardi C3 te standardit te vitit 2001 në atë C2 sipas standardit te vitit 2015, përmirësimin e projekteve të zbatimit për segmentet ku ka projekt zbatim por qe nuk është ndërtuar duke përmirësuar standardin C3 te rrugës sipas standardit te vitit 2001 në atë C2 sipas standardit te vitit 2015 dhe mirëmbajtjen e segmenteve te ndërtuara.

Ne projekt ide, të nxitur nga rëndësia që ka segmenti Zall Bastar-Dalja e Urës së Vashës, që është sa 1/3 e të tërë Rrugës së Arbrit është studiuar dhe projektuar sipas standardit C2 te vitit 2015 ku është projektuar edhe lidhja e Rrugës së Arbrit me Klosin. Ne projekt ide është marr ne konsideratë distance kohore më e shkurtër, siguria e kërkuar në tunele, pasi parashikon edhe një tub emergjence, krahas atij kryesor dhe aksesi me i shpejt i rrugës nga banoret e Matit përmes lidhjes me Klosin. Kështu, në Projekt Ide, Rruga e Arbrit nga Tirana deri në Bllatë skematikisht në mënyrë të njëpasnjëshme është e ndarë në 8 segmente si më poshtë:

Segmenti 1, fillon në dalje të Tiranës, aty ku mbaron rruge ekzistuese, dhe përfundon tek Ura e Brarit, aty ku kane filluar punimet për ndërtimin e rrugës. Gjatësia e tij është 1.153 km.

Segmenti 2 : Ura e Brarit - Zall Bastar, me L = 5.46 km.

Segmenti 3: Zall Bastar – Dalja e Urës së Vashës, sipas projekt idesë eshte me gjatësi L = 23.188 km.

Segmenti 4: Dalja e Urës së Vashës – Bulqizë, me gjatësi L = 9.715 km.

Segmenti 5: Bulqizë-Ura e Çerenecit, me L = 20.12 km, i përfunduar në v. 2009 dhe 2011.Nuk është pjese e Projekt Idesë.

Segmenti 6: sipas studim-projektim qe lidh Urën e Çerenecit me rrugën Maqellarë-Pika kufitare Bllatë. Gjatësia e tij është L = 9.111 km.

Segmenti D (7): Për të plotësuar nevojat e trafikut të ardhshëm, rruga ekzistuese Maqellarë-Pika kufitare Bllatë duhet të rikonstruktohet në standardin e një rruge urbane për shpërndarjen e të tërë trafikut të Rrugës së Arbrit në Drejtim të Peshkopisë (Maqellarë) dhe Maqedonisë (Pika kufitare Bllatë).

Segmenti K (8) është degëzimi Dalje Ura e Vashës - Klos (Segmenti K) me L = 3.092 km.

Projektet e segmenteve 1 deri 6 (pervec segmentit 5-qe nuk është pjese e Projekt Idesë) janë hartuar sipas Standardin C2 të Manualit për Projektimin e Rrugëve Shqiptare – MPRrSh 2 – Projektimi Gjeometrik (viti 2015). Ky standard kënaq kërkesat që burojnë nga Studimi i Fizibilitetit për Rrugën e Arbëri. Ky standard, kërkesat evropiane të sigurisë për rrugët automobilistike dhe elementëve përbërës të tyre.

Segmenti D është projektuar për të plotësuar nevojat e kalimtarëve, trafikut urban dhe ato në interes të Rrugës së Arbrit. I vetmi Segment i projektuar në standardin C3 është ai i degëzimit për në Klos (Seg. K), kjo në përputhje me volumit e trafikut në atë rrugë.

BUJAR KAROSHI

Gazeta ka nisur vazhdimisht emaile në adresën zyrtare të kompanisë në Web, por deri më tani nuk kemi marrë përgjigje. Disa pyetje që shqetësojnë publikun që kanë të bëjnë me cilësinë e punimeve, kompanitë e specializuara që po punojnë në terren, kalendarin e punës sipas kantierëve ku po punohet, garancitë që punimet nuk do të ndërpriten, e të tjera çështje që kanë interes për publikun, nuk kanë marrë një përgjigje zyrtare

Rruga e Arbërit nr. 152

Përfshirja e biznesit në përpunimin e tyre nëpërmjet ndërtimit të linjave përpunuese me cikël të mbyllur me qëllim rritjen e vlerës së tyre ekonomike dhe të numrit të të punësuarve nga ky sektor.

ekonomi

Bimët aromatike dhe mjekësore, një potencial i rëndësishëm zhvillimi

Nga **Osman XHILI**
Vullnet TAFA





Rajoni në të cilën shtrihet territori administrativ i Bashkisë Dibër është ndër më të pasurit përsa i përket shumëllojshmërisë dhe përhapjes së fondit të bimëve aromatike dhe mjekësore. Kushtet e përshtatshme klimaterike dhe tokësore kanë bërë të mundur praninë e shumë llojeve bimësh mjekësore të rritura në mënyrë spontane dhe në gjendje të egër me vlera të larta aromatike dhe mjekësore që përbëjnë një pasuri të çmuar jo vetëm në aspektin e florës dhe të biodiversitetit,por edhe në atë ekonomik,si një burim i rëndësishëm të ardhurash për ekonominë lokale. Përveç sigurimit të medikamenteve mjekësore duke shërbyer si lëndë e parë për prodhimin e tyre në industrinë farmaceutike ato ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e ekosistemit, në përmirësimin e klimës dhe të ajrit, në mbrojtjen e tokës nga erozioni, rregjimin e ujërave, përmirësimin panoramik të peisazhit, etj. Ato rriten në gjendje të lirë në natyrë, pa ose me shpenzime minimale për mirëmbajtjen e tyre, janë burime të rinovueshme prej të cilave merren prodhime të përvitëshme si edhe kanë aftësinë e rigjenerimit të shpejtë dhe rritjes së kapacitetit të tyre prodhues. Janë të përhapura kryesisht në sipërfaqet pyjore dhe kullosore,në çeltirat e pyjeve, kullota dhe livadhe si edhe në kategoritë e tjera të fondit pyjor në terrene të thata e shkëmbore, në terrene të lira e jo të përshtatshme ku bimësia tjetër do ta kishte të pamundur të rritej dhe zhvillohej në kushte normale. Gjithashtu ato janë të përhapura edhe në tokat bujqësore të fermerëve, anës ledheve, përrenjve etj. Prania e pakët e tokës bujqësore, karakteri i copëtuar i saj kanë imponuar një bujqësi pak të zhvilluar dhe larg përdorimit intensiv të herbicideve dhe insekticideve, gjë që e bën fondin e bimëve mjekësore dhe aromatike që rritet dhe zhvillohet në gjendje të egër në rajonin tonë mjaft cilësor dhe shumë të kërkuara nga tregu i brendshëm nëpërmjet të cilit ato pastaj eksportohen për në tregjet e tjera ndërkombëtare si në atë Europian e veçanërisht atë Amerikan. Gjithashtu mungesa e aktiviteteve industriale dhe e shkarkimeve ndotëse prej tyre të gazrave helmuese në arealin e përhapjes së këyre bimëve është një tregues tjetër i cilësisë së lartë të tyre. Pikërisht për arsyet e mësipërme grumbullimi i bimëve mjekësore ka zënë një vend të veçantë në aktivitetin ekonomik si në të kaluarën e largët ashtu edhe atë të afërt me përfitime të drejtpërdrejta jo vetëm për ekonominë familjare të banorëve që jetojnë dhe banojnë në zonat rurale në afërsi apo brendësi të zonave pyjore, por edhe për ekonominë kombëtare në tërësi në sajë të sigurimit të të ardhurave në valutë për shkak të eksportit të tyre. Grumbullimi i tyre ka patur një traditë të hershme që nga periudha e ekonomisë së centralizuar dhe që ka vazhduar dhe vazhdon edhe në ditët e sotme duke përbërë një nga aktivitetet më me rëndësi në ekonominë lokale dhe angazhuar një numër të madh njerëzish. Grumbullimi i këtyre bimëve sidomos në kushtet e tranzicionit dhe të futjes së vendit në rrugën e ekonomisë së tregut të lirë ka ndikuar në zbutjen e problemeve të punësimit të shtresave më vulnerabël të popullsisë të ekspozuara ndaj varfërisë dhe si një faktor i rëndësishëm i të ardhurave të tyre. Në këtë mënyrë ky aktivitet ka dhënë një kontribut të drejtpërdrejtë në ekonominë familjare të përqendruar kryesisht në zonat rurale dhe që përfaqësojnë shtresat më të varfëra të popullsisë duke përbërë të vetmin burim të të ardhurave për shumicën dërrmuese të tyre. Parë nga ky këndvështrim kjo pasuri duhet trajtuar si një aset i rëndësishëm lokal, burim të ardhurash e cila duhet të zhvillohet mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të rritjes së përfitimeve prej saj me qëllim rritjen e të ardhurave dhe ekonomisë familjare të banorëve.

Siç dihet fondi i bimëve mjekësore dhe aromatike administrohet nga strukturat e sektorit të pyjeve dhe kullotave publike në Bashki. Si në të kaluarën edhe sot me gjithë përpjekjet e bëra nga strukturat tona për një menaxhim dhe zhvillim të qëndrueshëm duhet pranuar që nuk është arritur një zhvillim i tillë. Përkundrazi duhet thënë që fondi i bimëve aromatike dhe mjekësore që rriten në gjendje të egër ka ardhur në përkeqësim të vazhdueshëm dhe disa popullata prej tyre janë në rrezik zhdukjeje. Një gjendje e tillë ka ardhur prej një sërë faktorësh por më kryesorët do të citonim kryesisht mungesën e zbatimit të ligjit dhe reagimi i dobët i organeve ligjzbatuese të fushës, mungesa e respektimit të kritereve teknike të vjeljes, grumbullimit dhe manipulimit të tyre gjë që ka çuar në pakësimin e popullatave të tyre, mungesa e investimeve në këtë drejtim, presioni i lartë për shkak të varfërisë së popullsisë së zonave rurale ku janë të përqëndruara këto burime pa marrë në konsideratë potencialin e mundshëm teknik prodhues si edhe mungesa e koordinimit në të gjitha hallkat e zinxhirit të këtij procesi grumbullues – përpunues – sipërmarrës etj. Synimi për të grumbulluar sa më shumë dhe më shpejt si edhe me çfarëdo lloj formash dhe metodash pa marrë parasysh ciklin biologjik të bimëve, kohën e përshtatshme të vjeljes, ka sjellë pasoja të rënda në përhapjen, rritjen dhe zhvillimin e tyre të qëndrueshëm. Sidomos më të dëmtuara paraqiten llojet e bimëve nga të cilat grumbullohen edhe rrënjët pasi shkulja e tyre pa kriter duke qenë një proces i pa kontrolluar në shumicën e rasteve nga pikëpamja teknike, ka pakësuar ndjeshëm mundësitë dhe aftësitë riprodhuese të tyre.

Për sa më sipër duke parë përkeqësimin e situatës së përhapjes dhe të zhvillimit të bimëve aromatike mjekësore që rriten në gjendje të egër me qëllim harmonizimin e përpjekjeve të të gjithë aktorëve për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tyre në të ardhmen,për ta kthyer këtë pasuri në një burim mirëqenieje për një nga shtresat e popullsisë më të ekspozuara ndaj varfërisë siç janë ato të zonave rurale,sektori i pyjeve dhe kullotave ka mbështetur dhe mbështet çdo bashkëpunim dhe iniciativë në këtë drejtim.

Së pari dhe më i rëndësishëm do të ishte reagimi më i vendosur institucional i strukturave tona dhe veçanërisht i Inspektoriatit të Pyjeve dhe të Mjedisit për të vënë nën kontroll aktivitetet e paligjshme të grumbullimit të tyre dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të personave kundërvajtës.

Së dyti bashkëpunimi me grupet e interesit që veprojnë në këtë fushë sidomos i grumbulluesve individualë në sensibilizimin dhe trajnimin e tyre në lidhje me kohën, mënyrën dhe praktikat më të mira të vjeljes e të grumbullimit, duke respektuar mundësitë teknike të shfrytëzimit të tyre. Për këtij qëllim janë organizuar ndër vite një sërë takimesh dhe seminaresh në bashkëpunim dhe me ndihmën e ish SNV, sot CNVP një organizatë ndërkombëtare e pranishme me aktivitetin e saj në Bashkinë tonë me këto grupe qofshin këto grumbullues individual, sipërmarrës të grumbullimit të tyre për vendosjen e kontrollit dhe zbatimin e rregullave teknike të vjeljes dhe grumbullimit të bimëve mjekësore si edhe është hedhur ideja e projekteve të ndryshme të kultivimit të tyre në të ardhmen.

Së treti përfshirja e biznesit në përpunimin e tyre nëpërmjet ndërtimit të linjave përpunuese me cikël të mbyllur me qëllim rritjen e vlerës së tyre ekonomike dhe të numrit të të punësuarve nga ky sektor.

Përpjekjet e përbashkëta të aktorëve të mësipërm duhet të synojnë në ruajtjen dhe zhvillimin e tyre në gjendje të egër pasi ekzistojnë të gjitha mundësitë e shtimit ekstensiv nisur nga kushtet e përshtatshme të zhvillimit të tyre,si e vetmja mënyrë që ato të vazhdojnë të jenë të kërkuara nga tregu vendas dhe ai i huaj për të siguruar të ardhura financiare të qëndrueshme dhe me tendencë rritjeje nga viti në vit. Shfrytëzimi racional dhe me efektivitet i kësaj pasurie në të ardhmen do ti shërbente zhvillimit të tyre të qëndrueshëm dhe në të njëjtën kohë do të ishte një faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të popullsisë së zonave rurale.

Rreth projektit

Projekti "Menaxhimi i qendrueshëm i pyjeve bashkiake nga komuniteti" financohet nga Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) dhe Bashkia Dibër dhe zbatohet nga organizata AGRO EKO DIBRA.

ReLOaD është financuar me fonde të Bashkimit Evropian nga Instrumentet e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA), dhe zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në të gjitha vëndet përfituese: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova Ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia.

Qëllimi i projektit ReLOaD është që të forcojë demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integrimit në BE në vendet e Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet fuqizimit të shoqërisë civile duke mundësuar pjesëmarrjen e saj aktive në vendimmarrje si dhe nxitjen dhe krijimin e një mjedisi ligjor dhe financiar inkurajues për shoqërinë civile.

Projekti "Menaxhimi i qendrueshëm i pyjeve bashkiake nga komuniteti" ka si qëllim:

a. Përmirësimi i situatës pyjore në territorin e vargmaleve të Kerçinit, deri në Malin e Korabit e duke zbritur poshtë, buzë Drini, me qëllim rritjen e vizitueshmerise nga turistet vendas dhe te huaj.

b. Rritja e kujdesit ndaj pyjeve me një proces të integruar, ku të gjithë aktorët të jenë pjesëmarrës, dhe të zbatohen rreptësisht reformat dhe ligjet në fuqi.

c.Mbrojtja e florës dhe faunës së Dibrës, duke shtuar masat për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe përfshirjen e institucioneve në përpjekjet për zbatimin e reformave dhe ligjeve që rregullojnë biodiversitetin.

Programi Rajonal mbi Demokracine Vendore ne Ballkanin Perendimor financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve te Bashkuara per Zhvillim (UNDP).

analizë

Një kompani e kultivimit të peshkut mbi lumin Seta në Dibër pretendon se punimet e hidrocentralit i kanë shkaktuar 300 mijë euro dëm, por konflikti gjyqësor zvarritet prej dy vitesh për shkak të mungesës së ekspertëve dhe refuzimit të tyre për të kryer ekspertizat.



Lugina e lumit Seta në Dibër. Foto: Sami Curri

Mungesa e ekspertëve zvarrit gjyqin mes HEC-it dhe një rezervati peshku në Dibër

Nga **Hysen LIKDISHA**

Një gjyq mes kompanisë së kultivimit të peshkut Bio-Trofta në Dibër dhe asaj të hidrocentralit "Balkan Green Energy"(BGE), të cilat shfrytëzojnë rrjedhën e lumit Seta për bizneset e tyre zgjat prej gati dy vjetësh pa zgjidhje në Gjykatën e Shkallës së Parë në Dibër.

Gjykimi filloi pas një padie të Bio Troftës ndaj BGE për një dëm në vlerën 300 mijë euro në dhjetor 2016 dhe është është ende larg përfundimit. Ndërkohë, të dy palët dhe gjykata pranojnë se nevoja për një sërë ekspertizash dhe mungesa e eskpertëve ka qenë shkak i zvarritjes së procesit gjyqësor.

Lumi Seta në zonën e Dibrës, pjesërisht i mbrojtur si park natyror, është bërë pjesë e përplasjeve të ndryshme gjyqësore për shkak të një sërë lejesh për ndërtimin e HEC-eve në zonë. Në vitin 2016, kryepleqtë e tetë fshatrave u ankuan në Ministrinë e Mjedisit për pasojat e hidrocentraleve, të përshkruara prej tyre si "masakër mjedisore".

Administratori i Bio Troftës, Bajram Krashi i tha BIRN se punimet e kryera nga kompania BGE i shkaktuan atij dëme të mëdha si dhe shfarosjen e rreth 500 kuintalëve peshk. Krashi pretendon gjithashtu se konflikti gjyqësor po zvarritet për shkak se ekspertët refuzojnë të bëjnë detyrën, duke vonuar dhënien e drejtësisë.

Avokati i kompanisë BGE, Altin Ibro hedh poshtë pretendimet se punimet në HEC shkaktuan dëme në rezervatin e peshkut, duke ia faturuar ato shkaqeve natyrore.

"Kompania që unë përfaqësoj sulmohet pasi shihet si 'lopë që mund të milet', për shkak se nuk ka lidhje lokale dhe nuk përfshihet në korrupsion," tha Ibro.

PADIA DHE KUNDËR ARGUMENTET

Konflikti gjyqësor nisi në dhjetor të vitit 2016 me padinë e kompanisë Bio Trofta. Kompania që kultivon peshk pretendon se punimet për shtimin e kapacitetit të HEC Arrasit, që ndodhet disa kilometra mbi rezervatin, kishin shkaktuar rrëshkitje të një shpati mali.

Kjo masë e rrëshkitur dhe dhera të hedhura nga punimet, sipas përfaqësuesve të Bio Troftës, shkaktoi dëmtimin e 80 për qind të rasatit të peshkut.

"Një grumbullim i tillë i masës argjilore bllokoi të gjitha velzat e troftës me llum e zhavor, duke prishur kështu cilësinë në përbërjen e ujit, gjë e cila çoi në ngordhjen e 500 kv peshku,"tha Bajram Krashi.

Hec Arrasi është ndërtuar në vitet '80 dhe është marrë me koncesion nga kompania Balkan Green Energy në mesin e viteve 2000. Kompania është pjesë e grupit italian Essegei, e cila operon 23 hidrocentralë të vegjël në Shqipëri.

Sipas paditësve, shtimi i kapacitetit është bërë duke zgjeruar kanalin e mbledhjes së ujit dhe duke ndërhyrë në shpatet e malit. Krashi thotë se ndërhyrjet kanë qenë të vazhdueshme prej vitit 2010 deri në vitin 2016, duke shkaktuar rrëshkitjen dhe dëmtuar biznesin e tij.

Përfaqësues të kompanisë BGE pranuan shtimin e kapaciteteve, por kjo sipas tyre është bërë përmes investimit në teknologji, ndryshimit të turbinave dhe paneleve dhe jo në kanalin ujëmbledhës. Avokati Ibro i tha BIRN se kompania kishte zgjatur lartësinë e betonit në kanalin ujëmbledhës, por nuk e kishte zgjeruar atë dhe se punonte me të njëjtën sasi uji si më parë.

Ibro shtoi gjithashtu se punimet ishin kryer në vitin 2012, ndërsa padia ishte bërë 4 vjet më pas. Por kundërshtimi kryesor i kompanisë BGE lidhet me argumentin se dëmtimet janë shkaktuar nga prurjet e mëdha të lumit pas reshjeve të dendura dhe jo nga punimet e kryera prej saj.

Avokati i Bio Troftës, Xhemal Gazidede thotë ekspertizat kanë gjetur se ristrukturimi i HEC-it për 4-fishimin e kapacitetit të prodhimit të energjisë, është bërë jo nëpërmjet investimeve të reja, por nëpërmjet prurjeve të ujit si dhe pa leje ndërtimi dhe mjedisore.

"Vetëm ky fakt [mungesa e lejes], pa hyrë në detaje të tjera e penalizon të paditurin," tha Gazidede.

Por Ibro thotë se mungesa e lejeve, e presupozuar prej paditësve, nuk ka lidhje me çështjen e dëmit të shkaktuar. Ai shton se nëse kjo do të ishte e saktë duhej të ndiqej prej autoriteteve, por nuk provonte fajësinë e BGE sa i përket prurjeve të lumit që kishin ngordhur troftën.

"Prurjet me dhe të lumit varen kryesisht nga faktorë natyrorë, përfshi faktin që është një lumë malor dhe se përshkak të prerjes së pyjeve, zona ishte prekur prej erozionit," tha Ibro.

KONTESTIMI I EKSPERTËVE

Bazuar në këtë padi, Gjykata e Dibrës filloi gjykimin në dhjetor 2016, por në janar, për shkak të refuzimit të ekspertëve që sillnin si shkak largësinë, ajo vendosi të trasferojë çështjen për kompetencë në Tiranë. Gjykata e Tiranës në një seancë ia kaloi çështjen e kompetencës Gjykatës së Lartë, e cila në mars 2017 vendosi rikthimin e gjyqit në Dibër ku duhet të shqyrtohet me themel.

Prej këtij momenti në këtë gjykatë janë bërë rreth 19 seanca, një pjesë e mirë e të cilave për thirrje ekspertësh dhe pritje të ekspertizave. Palët thonë se ky ka qenë një prej problemeve kryesore gjatë shqyrtimit të kësaj padie.

"Kemi një ngjarje ku ndërthuren faktorë ambjentalë dhe ndërtimorë të pretenduar nga pala tjetër bashkë me elementë që kërkojnë njohuri nga gjeologjia, hidrogjeologjia, vlerësimi i dëmit dhe mjedisi," tha avokati i BGE për BIRN.

Duke qenë një çështje e një natyre teknike dhe ekspertët lokalë mungonin ose shiheshin të pabesueshëm, ekspertët u kërkuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës. Por një pjesë e mirë e të thirrurve refuzuan të shkonin duke nxjerrë si pretekst largësinë. Ibro thotë se në një rast gjykata mori vendim për të penalizuar me gjobë një profesor që kishte refuzuar të kryente ekspertizë.

Megjithatë sipas palëve ekspertizat kryesore janë paraqitur tashmë, por ato ndajnë qëndrime të ndryshme mbi rezultatet.

Avokati i Bio Troftës thotë se ekspertizat kanë përcaktuar se faji binte mbi BGE.

"Shkakun e rrëshqitjes së masivit argjilor dhe vlera e dëmit të shkaktuar ndaj Bio-Troftës është përcaktuar mbi bazën e ekspertizave të kryera nga specialistë të licensuar të fushave përkatëse," tha Gazidede.

Ndërkohë BGE si palë e paditur pretendon se të paktën në dy raste ekspertët mjedisorë kishin qenë të njëanshëm dhe jo profesionalë, ndërkohë që paralajmëroi kallëzim penal për njërin prej tyre. Ibro tha se në një rast ekspertiza mjedisore ishte rrëzuar nga gjykata, pasi "ishte si muhabet kafeje".

Në rastin e dytë Ibro thotë se ekspertiza është teorikisht më profesionale, por sipas tij e pavërtetë.

"Eksperti thotë se largësia mes HEC dhe Bio Troftës është katër kilometra, ndërsa është e matur që largësia është 6 kilometra," thotë Ibro duke kontestuar vërtetësinë e ekspertizës.

(Burimi: www.reporter.al)

Ndërtimi i HEC-it Seta 4 në Dibër, Gjykata Administrative rrëzon padinë e banorëve

***Nga* Sami CURRI**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në Tiranë rrëzoi të premten padinë e 11 banorëve të fshatit Çidhën në Dibër, për shfuqizimin e pjesshëm të kontratës koncesionare për ndërtimin e hidrocentralit SETA 4.

Kjo çështje kishte si relator gjyqtarin Avni Sejdi, ndërsa vendimi u mor me shumicë votash. Gjykata u shpreh se banorët nuk i kishin provuar pretendimet e tyre se HEC cënonte zonat e mbrojtura. Banorët i thanë BIRN se do të apelonin vendimin.

Avokati i kompanisë dhe Ministria e Energjitikës dhe Industrisë që po ashtu përfaqësohej në gjyq, mbajtën qëndrim se HEC-i ishte brenda rregullave dhe nuk cenonte zonat e mbrojtura.

Në vitin 2015-të, në Njësinë Administrative Arras dhe Lurë, të Qarkut Dibër, Këshilli Kombëtar i Territorit, miratoi ndërtimin e 4 HEC-eve në luginën e lumit Seta nga kompania "HYDROSETA POËER". Sipas banorëve dhe avokatëve të tyre, kjo është një zonë e mbrojtur, si monument natyre me VKM- 676 datë 20 dhjetor 2002, me burimin dhe Shpellën e Sopanikës.

Banorët në kërkesë padinë e tyre, kërkuan shfuqizimin e pjesshëm të kontratës koncesionare për ndërtimin e hidrocentralit SETA 4, pasi nga 4 kanione që janë në zonë me statusin si zonë e mbrojtur, gjurma e HEC-it prek në 2 prej tyre.

Mustafa Tola, një prej banorëve të kësaj zone që ka ndjekur të gjitha seancat gjyqësore u shpreh për BIRN se një vendim i tillë është i pa bazuar në fakte. "Ne nuk kundërshtojmë 3 HEC-et e tjera që po ndërtohen, por të katërtin. Pjesa fundore e kanionit të Setës prej 5 km po punohet të futet në tub, gjithashtu edhe burimet ujore të mrekullueshme. Gryka e Setës ka 4 kanione që janë në zonë të mbrojtur dhe ndërtimi i hidrocentralit Seta 4, gjurma e tubacionit prek në 2 kanione që janë zonë e mbrojtur me VKM", deklaroi Tola për BIRN.

Përfaqësuesja e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u shpreh gjatë seancës gjyqësore se banorët nuk kanë provuar një interes të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë që ju cënohet me ndërtimin e këtij HEC-i.

"Sipas ligjit për zonat e mbrojtura, ku përfshihen edhe burimi dhe shpella e Sopanikës, por edhe gryka e Setës rezulton që nuk preken në këtë rast nga ndërtimi i hidrocentraleve", u shpreh në seancën gjyqësore, përfaqësuesja e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Përplasja gjyqësore ndërmjet banorëve dhe kompanisë ka nisur që prej 27 korrikut 2017-të dhe për 17 muaj janë zhvilluar mbi 20 seanca gjyqësore dhe 2 ekspert të caktuar nga gjykata.

Për banorët, akt-ekspertimi nuk ka qenë plotësisht i pranueshëm. Mustafa Tola, tregon për BIRN se ekspertja e vendosur nga gjykata, nën trysninë e firmës ka bërë devijime në raportin e prezantuar para trupës gjykuese. "Monument natyre është shpallur gryka e Setës, pjesa më e ngushtë dhe më e thellë, aty ku rrjedh lumi dhe ku janë burimet ujore. Por ekspertja ka thënë të kundërtën, duke e çuar atë në bjeshkë, ku nuk ka burime ujore dhe pa asnjë cilësi për të qenë monument natyre", shprehet Tola për BIRN.

Për banorët e fshatit Çidhën, ndërtimi i 4 HEC-eve po sjell shkatërrimin e biodiversitetit, pasi në ujërat e lumit Seta jetojnë një sërë gjallesash, ku më i rëndësishmi është peshku troftë që me ndërtimin e këtij HEC-i do të zhduken.

Banorët pretendojnë se zona ka edhe rëndësi arkeologjike. Halil Xheqi, një prej banorëve të Çidhnës shprehet se zona ka një prani të madhe të gjetjeve arkeologjike dhe kërkonte një trajtesë të thelluar në këtë drejtim.

"Pa një arkeolog që të monitoroj punimet, po i bëhet një masakër historisë", u shpreh Xheqi për BIRN, ndërsa tha se vendimi ishte i pritshëm.

Në gusht të 2017-s, 20 banorë të fshatit Çidhën u proceduan penalisht nga Policia e Shtetit, pasi kishin tentuar të bllokonin punimet e kompanisë në hidrocentralin Seta 4.

Për banorët dhe avokatët e tyre që këtë çështje po e mbulojnë vullnetarisht, "beteja ligjore" kundër kompanisë dhe institucioneve shtetërore do të vazhdojë në Gjykatën Administrative të apelit.

(www.reporter.al)

Rruga e Arbërit nr. 152

debat

Programi Rajonal mbi Demokracine Vendore ne Ballkanin Perendimor financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve te Bashkuara per Zhvillim (UNDP).

Roli i komunitetit në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve bashkiake

Nga Osman Xhili

Të menaxhosh pyjet është një imperativ i kohës, është të duash natyrën, por në rradhë të parë të duash veten dhe shoqërinë. Parku kombëtar Korab - Koritnik përmbledh në vetvete mbi 50 mijë hektarë, nga të cilët, mbi 20 mijë janë në qarkun e Dibrës. Kjo sipërfaqe masive e mrekullueshme fillon me fshatin e Kllopishtit, në pjesën juglindore, në kufi me Maqedoninë dhe përfundon në Tejzë e Radomirë, duke folur gjithmonë për pjesën e Dibrës. Në mes të këtyre dy pikave ekstreme ndodhen fshatra të tilla si Kërcishti, Pocesti, Katundi i Vogël, Popinara, Erebara, Ilnica, Rabdishti, Cerjani, Zagradi, Venishti, Dypjaka, Sllatina, Sllova dhe Kalaja e Dodës, me fshatrat e saj. Këtu gjen sipërfaqe pyjore, të ulët dhe të lartë, sipërfaqe shkëmbore, kullosore dhe toka të larta të pakultivuara, që të lidhura e të ndara, të kombinuara e të crregullta, përbëjnë një mrekulli, që shpesh, të tjerët e të huajt na e vënë në dukje dhe ne nuk jemi koshientë për atë që vetë natyra na e ka afruar për ta përdorur. Ajo është për ne po aq jetike, sa dhe vetë toka bujqësore, që ne kultivojmë.

Aty marrim drurin dhe bimët medicinale, aty pastrohet ajri dhe pengohet errozioni, aty promovohet alpinizmi dhe turizmi malor, aty prodhohet mjalti, qumështi e djathi, aty kthjellohet mendimi dhe prehet shpirti. Në një ajet të Kuranit thuhet se kodrat e malet shërbekan dhe si gozhdë për të fiksuar tokën, që ajo të mos lëvizë.Po nëse nuk kemi asnjë meritë në krijimin e një mrekullie të tillë, a nuk lypset si detyrë dhe detyrim, të paktën ta ruajmë e të mos e tjetërsojmë?

PLANET E MENAXHIMIT

Pas atij shkatërrimi të madh të dy dekadave, gjërat sikur po rrokullisen në kahjen e duhur. Në Maqëllarë takuam teknikun e pyjeve Medi Shtrezi qe ka nje jete te tërë me këtë lloj shërbimi, për ti marrë disa opinione, në lidhje me këto probleme. Ai na tregon se po punohet e operohet me plane menaxhimi, që përfshijnë të paktën kufinjtë e një dhjetvjecari. Ky plan menaxhimi përshkruan gjendjen aktuale të një blloku pyjor, vlerërësimin e tij në parametra teknikë dhe ndërhyrjet komplekse që duhen bërë në këtë hark kohor. Këto ndërhyrje tonat,tregon Mediu , ndryshojnë sipas gjendjes s ë bllokut pyjor, sipas moshës dhe sipas destinacionit. Nëse është një pyll i ri lypset të heqim drunjtë e shtrembër, duke ruajtur një mesatare bimësh, mbi 50 mijë për hektarë. Nëse pylli është i lodhur dhe i degraduar, bëhet prerja rrafsh, ose ricungimi, në mënyrë që të krijohet mundësia të shpërthejnë filizat e rinj e të rigjenerohet pylli. Sëmundje të ndryshme prekin dhe pyllin, ndaj duhet herë pas here të monitorohet në kohë situata e të merren masat e duhura. Kanceri i gështenjës, krizomeri, apo krimbi i plepit, procesonarja e pishës, janë vetëm disa nga kërcënimet e shumta, që i bëhen pyllit.Nuk po flasim më këtu për rrezikun e zjarreve, pasi e bëmë objekt të vecantë në shkrimin e kaluar.

Një vend të vecantë në planet e menaxhimit zenë dhe sistemimet malore, si prita me gurë, mure, gardhe e të tjera si këto, me synimin për të penguar vërshimin e përrenjve dhe pengimin maksimal të gërryrjes dhe erozionit. Në fund, por jo pjesë më pak të rëndësishme, mund të përmendim dhe mbjelljet nga dora e njeriut, që mund të jetë me fidana pyjorë, po pse jo dhe me farëra, duke e gërvishtur më parë tokën në breza pyjorë. Janë mbjellë plepa tek rezervuari i Trepcës, plepa dhe akacje në Trenë, pyll gështenjash mes Grevës dhe Melanit, akacje në Pocest dhe plot raste të tjera si këto.

Këtu mund të përmendim dhe shembullin e shkëlqyer të bletarit të talentuar, Haxhi Miftarit, nga Kllopcishti.Ai mbolli para disa vitesh mbi njëmijë fidana akacjesh, pranë parkut të tij të bletëve, duke pasur përfitime të shumëanshme.Shembuj të tillë duhen përkrahur e promovuar, në mënyrë që të mos mbeten spontanë dhe endemikë, por të jenë pjesë organike e jetës qytetare.



BASHKPUNIMI ME KOMUNITETIN

Natyrisht që planet e menaxhimit, që sapo i përmendëm, do të kishin mbetur vetëm në letra e projekte, nëse nuk i bëjmë si pjesë përbërse vendim marrëse dhe zbatuese, banorët që jetojnë në këto anë. Krahas ndërgjegjësimit e fushatave sensibilizuese, është me interes që të bëhet dhe kalimi i pronësisë së banorëve mbi zabelet e pyjet e ulta, në mënyrë që ti ruajn e tu shërbejnë sa më mirë. Një projekt pilot po bëhet për njësinë administrative të Melanit me CVNP në dhe bashkinë Diber, për ta përhapur më tej dhe në zona të tjera, sipas këtij formati. Po ashtu me vlerë është edhe zbatimi i projektit "Menaxhimi i qëndrueshem i pyjeve bashkiake nga komuniteti" nga shoqata Agro Eko Dibra i mbështetur nga Projekti ReLOad dhe Bashkia Diber.

Një risi e vecantë do të jetë përfshirja e të rinjve në projekte që synojnë ndërgjegjësimin qytetar për pyjet. Është menduar që cdo shkollë të krijojë pyllin e vet, duke dhënë kështu një model të vecantë. Ndoshta do të ishte me interes që shkolla të vilte dhe disa të ardhura që burojnë nga pylli, duke e forcuar akoma më shumë këtë lidhje, këtë bashkëpunim e bashkëveprim. Shkolla e Melanit është në hapat e parë të implementimit të këtij projekti të ri dhe me shumë interes.

Kryetarët e këshillave, si përfaqesues legjitimë të fshatrave, kanë qenë shumë afër në hartimin e realizimin e projekteve për ruajtjen e përmirësimin e fondit pyjor. Gjuran Koci në Kërcisht, Halil Veliu në Popinarë, Vehap Hidri në Pocest, por dhe përfaqesuesit e Rabdishtit, Sllatinës, Cerjanit e më gjerë, po marrin gjithnjë e më tepër përgjegjësi në këtë mision fisnik. Halil Veliu në Popinarë tregon se kanë ngritur një grup pune dhe një skuadër zjarrfikse, për raste emergjente. Jo më kot e lamë për më pas shembullin e Kalasë së Dodës, që meriton të trajtohet në një artikull të vecantë.

Një ditë, bisedonim me mikun tim të nderuar, Sulejman Ahmati, nga fshati Tejzë i Radomirës. Ai më tregonte se ata kanë një itifak të trashëguar në breza, një ligj të shkruar e të pashkruar për pyjet, por që ka fuqi ekzekutive të padiskutueshme. Pyjet atje mbrohen, po aq sa dhe jeta e njeriut dhe për këtë ka një komision të vecantë. Të pesë lagjet apo fshatrat e Radomirës, Serdoku, Rade, Cernjeva, Kalle dhe Tejzë, kanë nga një anëtar , kurse kryetar i komisionit është Halil Ahmati. Komisioni përcakton për tu prerë cdo vit nga dy drunj të mëdhenj për secilën familje, duke u vënë damkën karakteristike. Nëse vihen re shkelje të këtij itifaku komisioni merr masa të ashpra administrative të përcaktuara në rregulloren e hartuar.Eksperienca tregon se menaxhimi i pyjeve nga banorët lokalë është i suksesshëm dhe ka vazhdimësi pasi ndiqet drejt për së drejti nga vete banoret dhe pushteti vendor për disa arsye:

- Arsye ekonomike – shpenzimet e qeverisjes vendore për mbrojtjen e pyjeve janë më të vogla, sepse banorët janë të interesuar ti mbrojnë ato.
- Banorët përmirësojnë ekonominë familjare dhe rurale pasi shfrytëzojnë pyllin si burim të ardhurash, për mbjelljen e kulturave që rriten ne gjëndje të egër brenda pyjeve (si gështenjat, bimët medicinale etj)
- Pushteti vendor nxjerr të ardhura nga përdorimi i burimeve pyjore për shkak të të ardhurave që vilen nga taksat vendore
- Arsye sociale – banoret e njesive administrative kanë qenë tradicionalisht zotërues të pyjeve pranë fshatrave që tashmë u janë transferuar pushtetit vendor, ndihen pronarë dhe kujdesen për kulturat pyjor
- Kur banorët janë të bindur se pylli u përket atyre dhe kjo është e konfirmuar edhe me dokumente. Ata bëhen më të ndjeshëm për mbrojtjen e pyjeve dhe burimeve të tjera natyrore, duke pasur edhe përfitime direkte

Ja kështu, me këto praktika të bukura, me këto njerëz që e kanë kthyer shikimin dhe vemendjen nga pyjet, si një aleat i hershëm dhe i pandashëm i jetës tonë, gjërat bëhen më të bukura e më të lehta dhe fëmijët tanë do të kenë një arësye më shumë për të na bekuar e falenderuar.

NJOFTIME

Njoftojmë lexuesit dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar ose dëshirojnë të ndihmojnë me donacione, se e vetmja mënyrë që **KONTRIBUTET TUAJA TË NJIHEN** janë pagesat **PËRMES BANKËS**. Edhe në rastet kur kontributet tuaja janë CASH, kërkoni një dokument të firmosur dhe vulosur nga redaksia.

* * *

Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo **SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA** tjetër apo rrjete sociale **NUK KA PËRPARËSI** botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!

* * *

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE. Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

* * *

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit. Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

* * *

Për më shumë na ndiqni në Facebook në linkun: **goo.gl/1bq2r6**
ose në faqen tonë
www.rrugaearberit.com

problematikë

2018, një vit me prodhim, por pa treg

Nga **Osman XHILI**

Iku edhe një vit. Në fund të tij, secili bën një analizë të thjeshtë: çfarë bëri, çfarë dha, çfarë mori, çfarë fitoi e çfarë humbi. E thënë në aspektin ekonomik, finalja e gjithë këtij bilanci është, se sa para ka në dorë njeriu për t'u përballur me vitin që vjen.

Fermerit dibran nuk i duhet shumë kohë për të bërë një analizë të tillë, sidomos atyre që merren me frutikulturë.Pranverën e vitit të kaluar ata pësuan një goditje fatale. Në dy tre net, mes datave 20 dhe 23 prill u shua gjithçka e bukur që ata mendonin se po arrinin. Ata miliona lule të kthyera në kokrra dhe që zmadhoheshin çdo ditë e më tepër, u shkrinë papritur, duke e lënë në ankth fermerin e ngratë. Hektarë të tërë me molla, qershi, kumbull e plot fruta të tjerë u kthyen në gjendje të mjeruar. Në shkrimin e bërë atëkohë vlerësuam një dëm prej të paktën dhjetë milionë dollarë. Shpresuam që qeveria do të vinte dorën në zemër. Menduam që do të hidhte pak para, aq sa për të kompensuar shërbimet e bëra deri atëherë, apo dhe të tjera që duheshin bërë në vazhdim. Të bënte jo më shumë se sa Kosova dhe Maqedonia, që janë shtete më të vogla, por ndihmojnë fermerin e tyre shumë më tepër. Asnjë sinjal nuk erdhi që andej dhe faturat e borxheve të fermerëve në shumë raste mbetën të pashlyera tek tregëtarët e pesticideve apo për kategori imputesh të tjera.

Ky vit nisi i mbarë. Sërish pemët e bekuara u ngarkuan me lule e fruta. Sytë e fermerëve qëndronin gjithë ankth e frikë nga qielli, se mos katastrofa përsëritej si një vit më parë. Po përsëri në verë, një ciklon breshëri që nuk ishte parë kurrë më parë, si në madhësi, ashtu dhe në kohëzgjatje goditi pemët dhe fermerët e pambrojtur. Në disa zona të Maqëllarës dëmet ishin të pariparueshme.

Fruti i parë për treg, si zakonisht ishte qershia. Mbi 400 hektarë me këtë frut të mrekullueshëm ishin gati për tu vjelur dhe prodhimi ishte fantastik. Por këtë rradhë ishte tregu ai që godiste me gjithë fuqinë e tij. Asnjë marrëveshje, asnjë kontratë, asnjë derë e hapur, asnjë alternativë për të bërë përpunimin industrial të këtij fruti, për ta kthyer në reçel, komposte, lëngje, apo të tjera si këto. Shpesh frutat mbetën të pavjelura në pemë, pasi 30 lekë, sa ishte vlera e tregut, i duhej fermerit vetëm për ta vjelur dhe për ta transportuar deri në pikën e shitjes. Dy kompani të interesuara, një kosovare dhe një me qendër në Tiranë, u sollën dhe u mbështollën për të tërhequr prodhimin, por pa ndonjë rezultat konkret.



Kavaletë me mollë në një pemtore.

E njëjta situatë u përsërit me mollën. Ai prodhim masiv akoma qëndron në kavaleta, nëpër dhoma dhe shtëpi të pabanuara dhe në rastin më të mirë në dhoma frigoriferike. Pak, vetëm pak është shitur. Shpesh ke shitës frutash që kanë vënë etiketat e çmimit mbi mollë, ku thuhet se tre, katër, apo pesë kilogramë kushtojnë 100 lekë. Faji mbetet gjithnjë pezull, i vetë fermerit, i tregut, i shtetit, i pafuqisë blerëse, i asaj konsumuese, i çorganizimit tonë, apo i kujt tjetër mund të jetë.

Ishte fat për fermerët që kishin blloqe me dardhë këtë vit. Kërkesa ishte e lartë,çmimi mjaft i pëlqyeshëm dhe në fund ata mbetën shumë të kënaqur. Por, ishin pak të tillë. Këtu do të theksonim dhe njëherë anomalinë dhe anarkinë e tregut dibran dhe atij shqiptar në përgjithsi.

Nëse do të jetë një vit i mbarë për pataten, po ta marrim si shembull, vitin tjetër ajo qëndron stok dhe e pashitur. Në vitin pasardhës ulet ndjeshëm kultivimi i kësaj kulture. Kështu ngjet me qepën, fasulen dhe të tjera perime. Por dhe për pemët frutore ka një kaos të vërtetë. Skemat kombëtare të qeverisë shtuan hektarët e mbjellë, kryesisht me mollë e qershi. Mjaft fermerë, të zhgënjyer nga rezultatet dhe të ardhurat, janë gati t'i presin e t'i shkulin ata pemë, që i rritën plot kujdes e dashuri. Disa e kanë bërë këtë veprim e ca të tjerë janë gati. Po dhe nëse e bëjnë këtë veprim radikal me se do ti zëvendësojnë hapësirat e boshatisura? Asgjë nuk është e sigurtë. Pastaj, a ka kohë dhe para të mjaftueshme njeriu i shkretë të bëjë eksperimente të tilla, kur një pemë do disa vite për të hyrë në prodhim?

Ne folëm për frutikulturën, por kaosi mbretëron dhe tek fermerët që mbarështojnë blektorinë, qoftë në të imta, apo dhe për të trashat. Vitin e kaluar nuk ju dhanë subvencionet e premtuara dhe ata organizuan një grevë para drejtorisë së bujqësisë. Këtë vit skema u ndryshua disa herë. U premtua aplikim me zero dokumenta, por dardha e kishte bishtin prapa. Diku penalizonte pronësia mbi tokën, diku siguracioni që kushtonte mbi gjysmën e asaj që përfitohej dhe të gjithë faktorët sëbashku bëjnë që të bjerë çdo vit interesi për subvencionet e qeverisë shqiptare në bujqësi.

Ne folëm për frutikulturën, por kaosi mbretëron dhe tek fermerët që mbarështojnë blektorinë, qoftë në të imta, apo dhe për të trashat. Vitin e kaluar nuk ju dhanë subvencionet e premtuara dhe ata organizuan një grevë para drejtorisë së bujqësisë. Këtë vit skema u ndryshua disa herë. U premtua aplikim me zero dokumenta, por dardha e kishte bishtin prapa. Diku penalizonte pronësia mbi tokën, diku siguracioni që kushtonte mbi gjysmën e asaj që përfitohej dhe të gjithë faktorët sëbashku bëjnë që të bjerë çdo vit interesi për subvencionet e qeverisë shqiptare në bujqësi.

Duhet përmendur puna e mirë e fondacionit "Sared", kooperim i qeverive gjermane, daneze e shqiptare, me koordinatorin Dali Horeshka për qarkun e Dibrës. Falë menaxhimit mjaft të mirë të këtij projekti, mjaft fermerë përfituan zetorë të fuqishëm të markave të mira, projekte frutikulture, apo për përshtatje bujtinash për të pritur vizitorë vendas dhe të huaj.

Fermeri dibran është në panik dhe pasiguri të plotë. Dhe kur arrin të prodhojë mallin me përpjekje titanike, ai nuk di ku ta tregtojë. Nuk di ku të shesë frutat, patatet, qepën, fasulet, qumështin, por dhe për mishin është në siklet. Ose duhet ta presë viçin në rrugë si dikur, ose duhet ta çojë në Lezhë, ku nuk ja vlen barra qiranë.

Bagëtia po pakësohet, fshatrat po shpopullohen, shpresa po vritet. Nëse për njerëzit e për kafshët ka akoma mjekë, po për bujqësinë vallë, a gjendet dikush që ti bëjë derman, ta shërojë e ta nxjerrë nga kolapsi?

FOTO FAKT:



Një viç i therur në një fshat të Dibrës. Banorët e vazhdojnë traditën e therjes së bagëtive në prag të festave, duke siguruar kështu një shitje të menjëhershme të mishit. Prej më shumë se një viti, është e ndaluar therja e bagëtive në kushtet private apo në baxhot e qytetit, pasi ato nuk plotësojnë kushtet higjieno-sanitare. Tani , ose duhen dërguar bagëtitë në një thertore të licensuar në Lezhë, ose bagëtitë theren në mënyrë klandestine. Dhe blektorët dibranë kanë zgjedhur të dytën. (Foto: Ketumblidhendibranet/ Facebook)

Erman DINE mes New Jersey dhe Maqellarës

Ëndrra amerikane është ëndërr shqiptare

Bisedoi: Ygerta GJELESHI*



Erman Dine është një nga pasardhësit e Fiqiri Dines, kryeministër i Shqipërisë në Korrik-Gusht 1944. Ai është djali i vogël i Sazan dhe Veronika Dines, i lindur dhe rritur në Gjazë të Lushnjes, ku familja e tij ishte e interrnuara.

"Unë ndjehem fatlum që jam pjesë e familjes dhe e fisit që bëri jo pak emër, jo vetëm në Dibër por në të gjithë Shqipërinë", e nis bisedën Ermal Dine, që njëkohësisht është edhe një kantautor i njohur në SHBA. I ndërgjegjshëm se jo gjithçka mund të thuhet në një intervistë, ai thekson se "ndjehem i privilegjuar që kam atë Baba dhe Nënë që na rritën në kushtet më të vështira të imagjinueshme. Xhaxhai im, Tomorri i cili ka qenë gjithmonë pranë babait dhe familjes së tij, na mësoi vjershat e Skëndërbeut të Naimit. Ata kaluan tek ne virtytet, vlerat njerëzore, traditën dhe kulturën e familjes tradicionale shqiptare. Na mësuan të duam vendlindjen dhe çdo gjë shqiptare pavarësisht periudhës komuniste, sepse Shqiperia është shumë më e madhe dhe më e vjetër se periudha e turpshme e komunizmit. Po ashtu ndihem fatlum për vëllezërit që kam, djemtë dhe vajzat e xhaxhallarëve dhe të hallave me të cilët u rrita dhe vazhdojmë të jemi pranë njëri-tjetrit në të keqe e në të mirë".

Cili është rrugëtimi nga "ferri "Savër të Lushnjës drejt "ëndrrës amerikane"?

Ky rrugëtim ka qenë një "Odise"e vërtetë. Nuk kishte si të ishte ndryshe kur shpërngulesh familjarisht nga Shqipëria e kohës së komunizmit për në Amerikë. Ekziston një hapësirë shumë e madhe midis të dyjave si nga aspekti gjeografik, po ashtu nga ai kulturor dhe i zhvillimit njerëzor të gjithanshëm. Ne jetuam në një vend të mbushur me bunkerë betoni, totalisht të izoluar nga pjesa e botës. Të rrethuar me tela me gjëmba, me kampe interrnimi dhe burgje të panumërta. Liria fizike dhe ajo e shprehjes nuk ekzistonin. Imagjinoni për një moment ndikimin psikologjik që një shpërngulje e tillë mund të ketë tek njerëzit e lindur dhe të rritur në një diktaturë si ajo e Shqipërisë. Brenda familjes tonë dhe shoqërisë së ngushtë ekzistonte koncepti i lirisë dhe i demokracisë, sepse kishim me çfarë ta krahasojmë, megjithatë midis konceptit dhe realitetit ekziston një hapësirë shumë e madhe. Shkuam nga një diktaturë çnjerëzore tek vendi me demokracinë më të përparuar në botë. Aty ku liria fizike dhe e shprehjes janë e drejtë elementare për çdo njeri, pavarësisht etnisë, besimit fetar apo racës. Aty, ku suksesi individual kufizohet vetëm nga aftësitë dhe ambiciet e individit! Ëndrra Amerikane është për çdo njeri që punon dhe respekton ligjet e vendit. Që mendon dhe punon për një të ardhme sa më të mirë për veten, familjen dhe fëmijët. Pra është ëndërr e çdo njeriu pavarësisht vendit ku jeton, është edhe ëndërr shqiptare. Është sidomos ëndërr shqiptare e cila për ne dhe të gjithë shqiptarët që jetuan kohën e komunizmit rezultoi të ishte e paarritshme në vendlindje. Sot, 28 vjet pas largimit nga atdheu, jemi të integruar në shoqërinë multikulturore të Amerikës. Kemi hedhur rrënjë të reja në tokë të huaj e cila për ne është "shtëpia larg shtëpisë". Për këtë jemi shumë mirënjohës ndaj shtetit Amerikan dhe shoqërisë që na pranoi mes tyre.

Ne u lindëm dhe u rritëm në një mjedis armiqësor të mirëfilltë. Njerëzit keqdashës ishin kudo, i përkisnin të gjitha moshave dhe shtresave të ndryshme të shoqërisë. Ne ishim në shënjestër. Mjaftonte shkaku më i vogël për të cënuar të pambrojturit, siç ishim edhe ne, klasa e të "deklasuarve". Unë kam një rast konkret, që më ndodhi kur isha në shkollë tetëvjeçare, në Ngurrëz të Lushnjes. Mësuesja e frëngjishtes një ditë më nxori përpara klasës dhe u tha fëmijëve të klasës "kjo është fytyra e shëmtuar e armikut" dhe më qëlloi me grusht në bark!

Si e përjetuat bashkimin e Familjes së Madhe?

Bashkimi jonë familjar pas një periudhe ndarje prej 46 vjetësh ishte një eksperiencë që nuk do ta harrojë kurrë. Ishte data 11 Shkurt e vitit 1991. Dita që lamë atdheun, dita e parë e lirisë për të gjithë ne. Ishim të gjithë pjesëtarët e familjes sime, pra nëna babai dhe të katër djemtë. Ishte po ashtu edhe djali i xhaxhait. Xhaxhai, gruaja dhe vajza e tij erdhën dy ditë më vonë. Po ashtu edhe halla me të gjithë familjen e saj. U bashkuam të gjithë në Athinë të Greqisë. Mendonim se gjëra të tilla ndodhin vetëm në filma. E kam akoma të freskët në kujtesën time dhe e kujtoj shpesh atë ditë. Do të kishte qenë një skenë ideale sikur bashkimi të kishte ndodhur në Maqellarë, aty ku e kishim lënë në 45-ën. Por ja që ëndrrat, edhe ato pak që realizohen, nuk dalin ashtu si i përfytyrojmë ne. Megjithatë ajo mbetet një nga eksperincat më mbresëlënëse që kam përjetuar në jetë. Ditën e parë na priti xhaxhai (Xhelal Dine), i cili kishte ardhur nga Amerika. U thanë shumë gjëra atë ditë, gjatë takimit të parë. Ishim të gjithë të pushtuar nga një ndjenjë e çuditshme. Ndodhën shumë gjëra, shumë shpejtë. Sidomos për ne që ishim mësuar me monotoninë e jetës në një diktaturë që i kishte mohuar njeriut të gjitha ngjyrat dhe nuancat që e bëjnë jetën të paparashikueshme dhe interesante. Edhe shpresa, e cila vdes e fundit zbehej nga dita në ditë. Nuk po e zmadhoj kur them sene jetonim me bindjen se nuk do të shiheshim më kurrë me familjarët përtej kufirit. Bashkimin mund ta quaj një ringjallje të vërtetë, me të gjithë kuptimin e fjalës. E gjithë kjo eksperiencë kishte ndjesinë e një ëndrre të bukur që shumë prej nesh e kishim përfytyruar shumë herë në imagjinatën tonë. E vetmja liri që gëzonim deri atë ditë. Kjo ndjesi vazhdoi edhe të nesërmen. Aty do të shihja edhe ribashkimin e nënës me vëllanë e saj, të cilin nuk e kishte parë që në moshën 6 vjeçe. Deri atë ditë nuk kisha parë as nënën dhe asnjë burrë të familjes të derdhte lot si atë ditë. Pak ditë më vonë do të takoja edhe Mixhën Dilaver, vëllanë e Fiqiriut, dhe gruan e tij. Dilaveri ka qenë pranë Fiqiriut gjatë gjithë jetës së tij, politike, ushtarake dhe private, deri ditën që ai ndërroi jetë. Fiziku dhe qëndrimi i tij edhe pse i moshuar, ishte dinjitoz dhe të impononte respekt. Përkrahja dhe ndihma që familjarët tanë na dhanë gjatë procesit të aprovimit të azilit politik, më pas edhe në Amerikë është e paçmueshme!

Ëndrra Amerikane është për çdo njeri që punon dhe respekton ligjet e vendit. Që mendon dhe punon për një të ardhme sa më të mirë për veten, familjen dhe fëmijët. Pra është ëndërr e çdo njeriu pavarësisht vendit ku jeton, është edhe ëndërr shqiptare. Është sidomos ëndërr shqiptare e cila për ne dhe të gjithë shqiptarët që jetuan kohën e komunizmit rezultoi të ishte e paarritshme në vendlindje.

Cila është gjyshja për Ju, që tregohej me gisht në diktaturë si gruaja e burrit dhe nëna e djemve "armiq të popullit"?

Unë nuk e njoha gjyshen, për fat të keq. Ajo ndërroi jetë pak kohë përpara se të lindja. Do të kisha shumë dëshirë ta njihja. Të kisha provuar dashurinë e dyfishtë të gjyshes. Sa pyetje që do të kisha për të. Sa shumë gjëra do të zbardhte ajo, për historikun e familjes sonë. Për fëmijërinë e tim eti, prapësitë e tija. Për vendlindjen e tij, për Maqëllarën, për njerëzit e saj. Për atë Shqipëri tjetër, në zhvillim e sipër me të gjitha shtresat e një shoqërie të lirë për të cilën unë vetëm kisha dëgjuar nga kujtimet e pakta të atyre që e kishin jetuar në moshën fëminore ose shumë të re. Nga pikëpamja e një gruaje, e një nëne, jashtë çdo kornize politike. Megjithatë e kam ndjerë prezencën dhe ndikimin e saj në familjen tonë nëpërmjet babait dhe nënës, e cila e ka dashur dhe respektuar shumë. Po ashtu edhe nga kujtimet e vëllezërve më të mëdhenj. Mësova se ishte grua e fortë, e rreptë, por e drejtë, të cilës nuk i binte fjala në tokë. Po ashtu e dashur, bujare dhe e butë me fëmijët.

Ju jeni shumë aktiv me statuset tuaja në rrjetet sociale për zhvillimet në Shqipëri. Mos ka të bëj me gjenin familjar?

Është e vërtetë që kam qenë aktiv në rrjetet sociale për disa vite. Unë ndjej një përgjegjësi për të treguar atë që jetova dhe pash me sytë e mi gjatë diktaturës komuniste. Sidomos kur shikoj sa shumë pak njohuri ka për atë kohë.

Ne u lindëm dhe u rritëm në një mjedis armiqësor të mirëfilltë. Njerëzit keqdashës ishin kudo, i përkisnin të gjitha moshave dhe shtresave të ndryshme të shoqërisë. Duke filluar që nga moshatarët tanë, mësuesit, qytetarët e thjeshtë të indoktrinuar me doktrinën përçarëse enveriste, administratorët e fermës ku jetonim, të qytetit e deri tek byroja politike në kryeqytet. Ne ishim në shënjestër. Mjaftonte shkaku më i vogël për të cënuar të pambrojturit, siç ishim edhe ne, klasa e të "deklasuarve". Kështu na kishte etiketuar shteti komunist. Rastet e përbuzjeve, e konflikteve dhe përpjekjet e disa bashkëpunëtorëve të regjimit komunist për të na bërë keq ishin të panumërta. Ishte një luftë psikologjike e gjithanshme, një persekutim që vinte nga kushdo dhe në çdo kohë. Unë kam një rast konkret, që më ndodhi kur isha në shkollë tetëvjeçare, në Ngurrëz të Lushnjes. Mësuesja e frëngjishtes një ditë më nxori përpara klasës dhe u tha fëmijëve të klasës "kjo është fytyra e shëmtuar e armikut" dhe më qëlloi me grusht në bark! Shkaku ishte ndonjë prapësi fëminore ose mos bërja e detyrave ashtu siç duhej. Më kujtohet edhe një rast tjetër. Nëndrejtori i shkollës më nxori mua dhe gocën e xhaxhait përpara gjithë nxënësve të shkollës, tetëvjeçare dhe të mesme. Filloi të tallej në mënyrën më cinike me rrobat që ne kishim veshur. Ishin rroba të ardhura nga Amerika, diçka që për "ta" ishte halë në sy. Kishin një dëshirë të zezë për të na parë dhe për të na bërë sa më shumë keq!

Cila është Muza Juaj në albumin "The Cries of the Eagle" dhe kënga e fundit?

"The Cries of The Eagle" është një projekt muzikor, një album muzike në gjuhën angleze. Jam akoma në punë e sipër. Po mundohem që të dalë sa më mirë dhe shpresoj që t'a përfundoj së shpejti. "The Cries of the Eagle" në shqip përkthehet "Klithmat e Shqiponjës". Kjo këngë ekziston në dy versione, shqip dhe anglisht, u shkruajt dhe u kompozua në gjuhën shqipe me titullin "Ndryshk". Një nga arsyet kryesore për krijimin e kësaj kënge është tundimi që viktima ka për të denoncuar krimin që i është bërë. Sidomos kur organet shtetërore, bëjnë shurdhin dhe qorrin.

Frymëzimi i këngës në versionin shqip ishte kalvari i vuajtjeve pafund i familjes, fisit tim, i shokëve dhe miqve të tyre,që jetuan në bërthamën e terrorit komunist. Për fat të keq ky qe edhe fati i shumë familjeve të tjera në Shqipëri. Jam munduar të përmbledh një hark kohor 74 vjeçar brenda formatit të një kënge. Ndodhën shumë tragjedi në Shqipëri brenda këtij harku kohor. Vëllavrasja gjatë luftës së dytë botërore, e cila zgjati deri në rënien e komunizmit dhe kulminoi me ngjarjet e vitit famëkeqe të 97-ës. Kohën e së ashtuquajtur 'tranzicioni' që nuk paska mbarim. Një kohë jo pak e shkurtër, pothuajse tre dekada, që prodhoi një sistem hibrid, as demokrat, as socialist, as kapitalist, që inkurajoi aventurierë dhe oportunistë, të cilët luajtën rolin e politikanit e të patriotit. Vunë partitë dhe karrierën e tyre politike mbi interesat e kombit. Shpërdoruan shpresat, ëndrrat dhe besimin e një populli të sfilitur nga skamja dhe padrejtësitë e panumërta.

Versioni anglisht tejkalon kohën dhe hapësirën e periudhës komuniste, përpara dhe pas. Ka të bëjë më shumë me përpjekjet e kombit tonë për të mbijetuar. Luftërat e shumta kundër pushtuesve të njëpasnjëshëm. Duke filluar që nga periudha e pushtimit Osman, lufta për pavarësi, ajo Ballkanike, qëndresa kundër pushtimit italian dhe gjerman, genocidi ndaj Çamërisë. Lufta për pavarësinë e Kosovës dhe përpjekjet e shqiptarëve të Maqedonisë për të jetuar të lirë dhe të barabartë me etnitë e tjera që përbëjnë atë shtet. Jam munduar të përfshi të gjitha këto peripeci të shqiptarëve për një audience të huaj në teksin e një kënge të titulluar 'The Cries of The Eagle (echoed)/ Klithmat e Shiponjës...(ushtuan).

intervistë

Poezi



Gjimnazi Maqellarë me kërkesë të znj.Esmeralda Beça- drejtore Ekzekutive e ATOM ALBANIA dhe ish-nxënëse e Gjimnazit si dhe vendimit të Këshillit Bashkiak Dibër mori emrin Gjimnazi "FIQIRI DINE" në prag të Festës së Flamurit. Ju jeni trashëgimtar dhe keni një kontakt shpirtëror ndër vite me Gjyshin Tuaj. Si e pritët këtë lajm dhe do t'iu kemi në Ceremoninë e Përurimit si dhe 50-Vjetorit të Gjimnazit?

Meqë ra fjala, dua të shfrytëzojë rastin për të falënderuar përzemërsisht të gjitha ata njerëz që morën pjesë në këtë projekt dhe ideatorët e tij. Ky është një nderim i veçantë që i bëhet Gjyshit tim, familjes së tij të madhe, fisit, miqve dhe shokëve të tij të idealit.

Dua të përmend një thënie Gjyshit tim, Fiqiriut, të cilën unë e aplikoj në jetën time të përditshme. "Në rrethana kritike, si individi ashtu edhe një popull tregojnë forcën e tyne morale!" Dua t'i bëjë një paralelizëm kësaj thënieje me një thënie tjetër të famshme. Ajo e presidentit Amerikan, John Kennedy "Mos prit të bëj vendi yt për ty, bëj atë që mundesh ti për vendin tënd!" Të gjithë ata njerëz që vepruan në ditët dhe kohët më të vështira të vendit, për të mirën e përgjithshme duhet të vlerësohen.

Së pari për kontributin që dhanë, për sakrificat personale dhe familjare që bënë për të mirën e atdheut.

Së dyti për aktet shembullore të tyre, që të frymëzojnë brezat e ardhshëm.

Të gjitha gjeneratat e të gjitha kohërave kanë nevojë për shembuj të mirë, modele të qytetërimit dhe të patriotizmit. Shpresoj dhe i uroj gjimnazit që tashmë mban emrin e Gjyshit tonë, sa më shumë suksese. Uroj të prodhojë sa më shumë mëndje të ndritura që t'i shërbejnë qytetit, ku lindën, njerëzve që i edukuan dhe i formuan sa më mirë, po ashtu edhe atdheut, kur është nevoja! Pse jo edhe një njeri që do të arrinte të realizonte bashkimin e trojeve shqiptare etnike?! Kjo do të ishte qershia mbi tortë.

Të gjitha gjeneratat e të gjitha kohërave kanë nevojë për shembuj të mirë, modele të qytetërimit dhe të patriotizmit. Shpresoj dhe i uroj gjimnazit që tashmë mban emrin e Gjyshit tonë, sa më shumë suksese. Uroj të prodhojë sa më shumë mëndje të ndritura që t'i shërbejnë qytetit, ku lindën, njerëzve që i edukuan dhe i formuan sa më mirë, po ashtu edhe atdheut, kur është nevoja!

Të them të drejtën jo vetëm mua por, edhe pjesëtarëve të tjerë të familjeve tona na befasoi lajmi. Kemi ndjekur shumë debate dhe replika midis historianëve dhe analistëve në kanale të ndryshme në televizionet shqiptare për disa vite. Krijuam një bindje të fortë se në Shqipëri ruhet akoma një pjesë e mirë e versionit të historisë, që u shkruajt në kohën e komunizmit. Besonim se në një të ardhme, ndoshta jo shumë të afërt, veprimtaria atdhetare e gjyshit do të vlerësohej, por jo kaq shpejt dhe jo në këtë mënyrë.

Qe një surprizë e bukur dhe shumë e mirëpritur.

Dibra tregoi se ajo diti të vlerësojë dhe të nderojë bijtë e saj më të mirë. Për familjen dhe fisin tonë është një nderim i veçantë. Jemi shumë mirënjohës sepse jo të gjithë njerëzit që kontribuojnë në çështjen kombëtare nderohen në këtë mënyrë!

Eshtrat e Mbretit Ahmet Zogu, Dom Nikoll Kaçorrit dhe Mid'hat Frashërit prehen në tokën amë. Mendoni që projekti Juaj i ardhshëm është që eshtrat e z. Fiqiri Dine do të prehen në Shqipëri për të marrë vendin që i takon në altarin e historisë, Ai që Atdheun e vu mbi gjithshka?

Ç'është e vërteta më është bër qejfi shumë kur pash kthimin e eshtrave të Mid'hat Frashërit. Po ashtu edhe ato të Ahmet Zogut dhe të Dom Nikoll Kaçorit, vite më parë. Ata kanë një vend të veçantë në historinë tonë për faktin se ishin firmëtarë ose pjesëmarrës të pavarësisë dhe për kontributin që dhanë për krijimin e shtetit të parë shqiptarë. Të gjithë pinjolla të familjeve patriotike që kanë dhënë gjithçka për atdheun. Kanë vepruar në kohë dhe rrethana të paimagjinueshme për shumë nga ne që jetojmë sot. Nëse marrim parasysh të gjitha dritë hijet, personalitetet e tyre komplekse, bindjet e ndryshme politike, dhe idetë opozitare për mënyrën udhëheqjes së vendit ishin dhe duhet të mbeten figura të shquara të historisë sonë. Pikësynimi i tyre ishte i njëjtë: Ndërtimi i një Shqipërie moderne sipas modelit demokratik perëndimor!

Edhe Fiqiri Dine ka vendin e tij në historinë e Shqipërisë si një njeri që vazhdoi në hapat e të parëve të tij, të cilët dhanë kontribut për çështjen shqiptare në periudha të ndryshme të historisë. Njëra prej tyre ishte lufta Dibrane e 1911-ës, një nga kryengritjet e para të luftës për pavarësi. Babai i tij do të merrte pjesë në Kongresin e Lushnjës si një nga delegatët e Maqellarës. Më vonë Fiqiriu do të përfshihej në ngjarjet më të rëndësishme, më të bujshme duke filluar që nga koha e Zogut deri në përfundim të luftës së dytë botërore. Në fakt Fiqiriu nuk u largua nga Shqipëria deri në vitin '46, pra dy vjet pas mbarimit të luftës. Ai qëndroi në malet e Shqipërisë për dy vjet. Gjatë kësaj kohe u strehua dhe u ndihmua nga miqtë e familjes, por dhe nga popullsia e Dibrës, të cilët rrezikuan jo pak, sepse ai kërkohej nga ushtria terroriste e qeverisë komuniste, e cila e kishte dënuar me vdekje. Gjatë kësaj kohe ai u përpoq të bënte çmos për largimin e pushtetit kriminel anti-shqiptar komunist me në krye enver hoxhën, emrin e të cilit refuzoj t'a shkruaj si gjithë emrat e njerëzve të tjerë.

Kthimi i eshtrave të Fiqiriut dhe shumë patriotëve të tjerë në tokën amë për të cilën ata dhanë gjithçka është detyrë morale e pasardhësve të tyre, por edhe e organeve përkatëse të shtetit shqiptar. Shpresoj që përmbushja e kësaj detyre është vetëm çështje kohe.

"Pra, mallkue njai bir Shqyptari, Qi ketë gjuhë të Perëndisë, trashigim që na la i Pari, trashigim , si'ia len ai fmis.." Sa e keni përcjell këtë mesazh te vajza juaj Arianna që të flasë dhe lexojë shqip?

Kjo thënie e famshme dhe tepër domethënëse, e At Gjergj Fishtës, një nga bijtë e "Shqypnisë" me vlerat e mbinjeriut dhe të patriotit të klasit të parë, besoj se ka munduar shumë shqiptarë të emigruar, të cilët për një arsye apo tjetër nuk ia kanë mësuar gjuhën shqipe fëmijëve. Kjo thënie ose amanet i tij, troket në ndërgjegjen time shpesh herë si sqepi i qukapikut mbi trungun e pemës. Jehona që ajo lë në shpirtin tim të përgjysmuar midis vendlindjes dhe vendit ku jetoj, sidomos gjatë ditëve me mall për vendlindjen dhe për njerëzit e dashur që lashë atje, vazhdon për disa ditë. Unë dhe të gjithë pjesëtarët e familjeve tona të mërguara larg vendlindjes do të mundohemi të kalojmë cilësitë tona dhe të familjes shqiptare më të mira tek fëmijët tanë. Kur ata të jenë në moshën e arsyes do t'iu mësojmë gjithçka rreth historikut të familjes dhe të vendlindjes tonë. Unë jam në përpunim e sipër të një serenate shqiptare që ia kam mësuar vajzës, e cila këtë muaj mbush 6 vjeçe. Është një duet që e kam dëshiruar për disa vite dhe besoj, se tani është koha e duhur për ta realizuar. Shpresoj dhe besoj se do t'a publikoj te faqja ime personale në YouTube, përpara fundit të vitit.

Ju jeni mes Fiqiri Dine dhe Fiqiri Dine (i ri). Do t'iu kemi mes Amerikës dhe Maqellarës tani?

Unë, dhe të gjithë pasardhësit e kësaj familje të madhe, nipa dhe mbesa të Fiqiriut, që jetojmë në Amerikë, por jo vetëm, do të mbetemi midis vendit, ku jetojmë, Shqipërisë dhe Maqellarës. Me një sy dhe një vesh të drejtuar drejt vendlindjes. Njësoj si paraardhësit tanë, që u detyruan të jetonin jashtë atdheut dhe familjarëve të tyre. Disa nga ne do të kemi një lidhje shpirtërore me vendlindjen për faktin se u lindëm dhe u rritëm atje, po ashtu edhe nga ndikimi prindëror për të dashur atdheun, sepse të duash atdheun do të thotë të duash veten, prindërit dhe të parët e tu. Dhe përsa kohë njeriu ndjen dashuri për atdheun nuk mbetet kurrë rrugëve, sado larg tij të jetë.

Tani dua t'iu falënderoj juve,personalisht për intervistën, për mundësinë që më dhe mua dhe familjes sonë të madhe për t'u dëgjuar. Jemi po ashtu mirënjohës për kontributin tuaj, për energjitë dhe kohën që i kushtuat kësaj ngjarjeje!

Faleminderit nga zemra!

**Autorja është nxënëse në Gjimnazin "Fiqiri Dine", Maqellarë. Kjo intervistë është marrë në kuadrin e projekteve që nxënësit realizojnë gjatë procesit mësimor. Edhe në të ardhmen, redaksia mbetet e hapur për të botuar materiale, kërkime e intervista të nxënësve që përcjellin mesazhe më shumë se sa një detyrë shtëpie.*

Poezi nga Xhoana Tafçiu Nxënëse e vitit të tretë në gjimnazin e Maqellarës.

PO NDJEJ TE FTOHTE

Po ndjej të ftohtë,
Këtu për rreth, gjithçka e akullt,
Po ndjej të ftohtë.
Përse vallë?
Askush nuk ma thotë arsyen,
Pse ndjej të ftohtë.
Në këtë ditë të nxehtë vere,
Po ndjej të ftohtë.
Sa shumë e akullt qenka kjo botë!
Unë i afrohem e ajo largohet,
Unë i buzëqesh e ajo tërbohet,
Kur rri e mërzitur, ajo gëzohet,
Unë i jap dorën, ajo më shtyn,
Harron se fytyrën e vet po pështyn.
Përse kaq e akullt?
Përse kaq e ngurtë?
Përse iku dita, kur ajo sillej butë?

Ja, përsëri po ndjej të ftohtë,
Ndjej që po vjen një stuhi.
Ah, po...ajo është e nesërmja.
Bashkë me të vjen dhe shpresa.
Nuk ndjej më të ftohtë.

KURRË MOS THUAJ "SIKUR"

Një sy i përlotur,
një zemër e copëtuar,
një shpirt i përvëluar,
gjithmonë thotë "sikur".
Një fëmijë jetim,
një fëmijë i varfër,
një fëmijë i shtypur,
gjithmonë thotë sikur.
Kjo fjalë na kthen pas,
na i merr ëndrrat,
na i mbyll sytë,
Deri kur do zgjasë?
Deri kur do themi "sikur"?
Deri kur shpirtin do trazojmë?
A do ketë një fund kjo fjalë helmuese?
A do jetë e lidhur pas nesh
gjithmonë?
Përse thua sikur për atë që shkoi?
Përse thua sikur për atë që se ke?
Ngrihu e lufto, zgjohu o njeri!
Mposhte këtë fjalë e hidhe tej!
Leri ndonjëherë ndjenjat mënjanë,
Se jetojmë në një botë të padrejtë.
Kurrë mos thuaj më "sikur"
Zhduke këtë fjalë nga ky realitet!

ZEMRA NE UDHETIM

Po prekja tokën e xhenetit
Po ndjeja aromën e mirësisë,
Po jetoja ëndrrën e Ahiretit,
Ecja pa frikë.
Ecja, vrapoja...aromën e xhenetit shijoja.
Kisha lulëzuar...
Kishte ardhur pranvera,
Malet, detet, dielli dhe hëna,
Po festonin me mua.
Tani, thashë, nuk do të ketë më vdekje,
Nuk do të ketë më një fund,
Nuk dëgjojmë atë që na vret veshët,
Nuk shikojmë atë që na vret sytë.
Nuk durojmë më padrejtësi në heshtje,
Sepse nuk ka më padrejtësi.
...
Eh, kështu isha zhytur në mendime,
Zemra udhëtonte, mendja ëndërronte,
Po arrija të bindja veten time,
Se isha përhumbur...
në botën e përjetësisë,
aq larg...
në botën e mirësisë.
Ah, tani u ktheva në realitet,
Nuk kam më kohë të zhytem në mendime,
Po ik të gjej rrugën e drejtë,
Për të fituar xhenetin, ëndrrën time.

Krahas investimeve në teknologjinë e përpunimit të mermerit, po investon edhe në vendlindje në frutikulturë dhe agroturizëm

Ilmi Murati

themeluesi i kompanisë "Riu-Mermer", që po konkurron denjësisht në tregun europian



Nga **Shaqir SKARRA**

Sa herë që nis e shkruaj për vendlindjen time, qoftë edhe pak radhë, më kaplon një ndjenjë e ligjëshme malli e nisin e trazohen kujtimet mia të cilat rrjedhin si valët e Drinit plak. E ky prag viti më përplasi pikërisht në Shumbat, tek ata njerëz të mirë, fisnik e bujar, puntor e të besës. Gjithmonë kam patur pranë vetes miq e dashamirë të mirë, kam kërkuar që të bëj zgjedhjen më të mirë dhe deri tani nuk kam qenë i gabuar . Këtë radhë dua të veçoj një nga djemtë më të mirë të Shumbatit tim, Ilmi Muratin.

I dalë nga një familje e njohur atdhetare, puntore e mjaft bujare, u rrit dhe brumos me vyrtytet më të mira njerëzore. Ilmiu, si merakli i madh e mjaft i përmalluar për vendlindjen dhe shokët e moshës së tij, mbetet një shans që nuk përsëritet dy herë. Shpluhurimi i kujtesë time sot nuk vijnë si fakte për tu kapardisur por si një realitet i ndjeshëm, dëshmim e zgjim burimesh fuqi dhënëse. Eh ç'mi ndeze edhe njëherë urët e mallit o djalë i Shumbatit?

Sa kafe e duhan, sa ujë e bukë, sa muhabet Dibre është bërë në atë konakun e Fiqiri Muratit në Shumbat, në atë kullë të madhe e me gurë të gdhendur? Dera e avllisë rrinte e çelë e dritat nuk fikeshin, se konaku priste e përcillte mysafirë, të njohur e pa njohur. Ishte dhe mbeti shtëpi bujare Fiqiri Murati.

E sot udhëtimi i kujtimeve të mia për shokun, mikun dhe bashkëfshatarin Ilmi Murati sikur të merr rrjedha e kujtimeve para e të shpie atje ku ka lindur, në atë vatër që mban të ndezur ende zjarrin e mirësisë, bujarisë e atdhedashurisë, në Shumbatin e bukur që me të drejtë e quajnë si kurora ma e bukur e të gjithë Ujë e m'Ujës.

Ilmiu u lind në Shumbat më 29 tetor 1976 në një familje me taban patriotik e atdhetar ku puna dhe bujaria ishin karakteristika të veçanta të kësaj familje të njohur jo vetëm në Shumbat por edhe jashtë sinorit të fshatit. Shkollën fillore e tetëvjeçare i mbaroi në Shumbat. Shkollën e mesme e përfundon në Sllovë.

Dalja në jetë dhe shkollimi periferik, shpalosi tek Ilmiu botëkuptimin e ri për të hedhur themelet e vetë jetës. Në mendimet e tij filloi të rrjedhë e zërë vend gjykimi gjithmonë e më racional. Sa herë që e çonte mendimin në vitet që linte pas, befas diçka e ngacmonte. Ishte vetë jeta, duhej projektuar e ardhmja. Rrinte e mendonte mbrëmjeve të gjata, pastaj gjumi bënte të veten. E kjo po kthehej gati në ritual të vazhdueshëm. Ajo që e mundonte më së shumti ishte kalimi nëpër mend se çfarë kishte bërë.Analizonte e ballafaqonte veprimtarinë e ditës, të pëlqyeshmet me të diskutueshmet, çfarë kishte bërë dhe çfarë kishte mbetur ende pa bërë. Çfarë duhej korigjuar e çfarë duhej bërë më mirë.

Mendimet rridhnin si uji i rrëmbyeshëm i Drinit me gurgullimën magjike të vetë ëndrave të tij. Ky leitmotiv që kërkonte nga vetja, në një kohë që ende ishte një djalosh i ri por merrte vazhdimisht përsipër obligime dhe përgjegjësitë rriteshin vazhdimisht, përbënte thelbin e meditimeve të tij. Dhe e kishte një ide të ngulitur në mendje, se kur njeriu vret mendjen nuk vret veten. Si hije e ndiqte nga pas gjithmonë novatorizmi shpirtëror. Objektivi i tij ishte: i mirë dhe i zoti për vete e familjen, i zoti dhe i vlerësuar e nderuar nga të tjerët.

Ilmi Murati përfitoi shumë, përfitoi shumë nga tradita dhe vyrtytet e prindërve, e babait të tij, Fiqiriut , ndaj duke e parë se ambiciet e dëshirat e tij ishin të mëdha, Shumbati i dukej i vogël për hapësira dhe ide që bluante që herët në kokë, ndaj nga fshati u largua herët, u largua në fillimet e para të viteve nëntëdhjetë dhe iu ngjit pas karvanit të madh njerëzor që kaluan kufirin pasi telat me gjemba ishin këputur për një jetë më të mirë, për të krijuar sado pak të ardhura për familjet, për të zbutur varfërinë e tejskajshme të atyre viteve që ishte ulur këmbëkryq në familjet shqiptare.



KTHIMI NGA EMIGRIMI ME IDE PËR INVESTIME


Ashtu si për shumicën e shqiptarëve stacioni i parë ishte Greqia, por Ilmiu nuk u largua që këtu. Vajti në Greqi në vitin 1991 dhe u largua që andej në vitin 2005. Punoi shumë, përfitoi shumë edhe nga ana profesionale. Greqia për Ilmiun u bë një shkollë e dytë. Duke punuar çdo ditë në një fabrikë mermeri përfitoi edhe profesionin e përpunimin e mermerit. Dhe kur iu mbush mendja se tani mund të kishte mundësi për të punuar dhe investuar në vendin e tij u kthye në Shqipëri. Gjatë kësaj kohe së bashku me vëllezërit e kishte blerë tokën në Tiranë por ende nuk ishte larguar nga fshati. Babai i tij, Fiqiriu si një bujk i mirë që ishte e kishte shumë të vështirë të largohej nga fshati, ta braktiste tokën, ta linte shtëpinë e tij të bukur dy katëshe në fshat e të banonte në Tiranë. Ilmiu lëvizi drejt Tiranës vetëm në

Ilmi Murati përfitoi shumë, përfitoi shumë nga tradita dhe vyrtytet e prindërve, e babait të tij, Fiqiriut, ndaj duke e parë se ambiciet e dëshirat e tij ishin të mëdha, Shumbati i dukej i vogël për hapësira dhe ide që bluante që herët në kokë, ndaj nga fshati u largua herët...

vitin vitin 2001 kur ndërroi jetë edhe babai i tij Fiqiriu.

Së bashku me ndërtimin e shtëpisë mendoi edhe për ngritjen e një linje, si fillim të vogël për përpunimin e mermerit në vend. Në ato vite ishin hapur mjaft linja të tilla por Ilmiu u fut shpejt në treg, u bë i njohur dhe filloi të konkuronte me shumë firma e kompani mermeri.

Nga ajo linjë e thjeshtë, me makineri tepër modeste sot "Riu-mermer" me administrator Ilmi Muratin është bërë një nga firmat më të njohur brenda e jashtë vendit. Vetë Dhoma e Tregtisë Amerikane duke



vlerësuar punën, cilësinë dhe seriozitetin i ka dhënë çertefikatë mirënjoje si dhe vizë afat gjatë për të vizituar kompani prestigjioze mermeri dhe për të qenë i pranishëm në seminare e panaire të ndryshme që zhvillohen në botë.

Ilmiu është shumë njerëzor, natyra dhe formimi i ka dhuruar thjeshtësinë e njeriut model. Dëgjon e respekton më shumë se sa sugjeron. Më shumë kërkon të blejë se sa të rrëfejë vetë. Mbase kjo ia ka plotësuar atë boshllëk që i la mangut mungesa e shkollës. Ai është i lindur nga natyra të jetë i prekshëm dhe i ndjeshëm ndaj pa drejtësive dhe fenomeneve sociale e shoqërore. I dhemb në shpirt kur shikon se sa shumë vuajnë të tjerët, përpiqet me të gjitha mënyrat t'ju vijë në ndihmë, sakrifkon nga ekonomia e tij për të tjerët dhe kërkon nga të gjithë që problemet sociale tepër të theksuar të zbuten sa do pak në vendin tonë.

Dhe ajo që e bën Ilmiun të jetë ndryshe, krejt ndryshe me të tjerët është pa dyshim lidhja e tij e ngushtë me nënën. Në fakt të gjithë janë të lidhur me nënën, të gjithë e pyesin dhe marrin këshilla prej saj, të gjithë e duan dhe e respektojnë shumë. Ilmiu ndryshon, ndryshon nga të gjithë se pas vdekjes së babait nëna e tij është gjithçka. Dhe siç shprehet edhe vetë: "Që në momentin e parë që unë u gjenda në këtë botë, që në frymëmarrjen time të parë, që në përpëlitjet e para të syve të mi, unë u gjenda në krahët e njeriut që e kam dashur dhe e dua më shumë se askënd tjetër. Çdo herë që qeshja, komikja ishte përsëri ajo. Sa herë që rrëzohesha, nëna vraponte e frikësuar për të më ngritur, sa herë që sëmuresha, nëna ime ishte e gatshme të sakrifikohej për mua. E pse të mos e dua unë një njeri të tillë, njeriun më të rëndësishmë për mua. Kur unë gjithë jetën e kam parë me sy admirimi, kur unë gjithë jetën jam përpjekur ti ngjaj sado pak, jam përpjekur të ec me hapat e saj. Nëna ime është njeri i thjeshtë por me karakter të fortë, herë herë autoritare dhe shpesh herë zemër butë, ashtu siç janë në të vërtetë të gjitha nënat. Ajo në pamje të parë të le përshtypjen e një njeriu me karakter të ashpër, por në të vërtetë është krejt e kundërta. Kjo ndoshta është edhe arsya e rrudhave që i janë krijuar në pjesën



Ilmi Murati, ky djalë Shumbati që sot na vërviti larg e larg me kujtime të bukura ishte "pronar" i denjë i vyrtyteve më të bukura njerëzore, i atyre vyrtyteve që i thamë dhe më lart, i merituar plotësiht për të bërë vetëm punë të mira.

e syve dhe faqeve por thinjat tashmë sikur e zbukurojnë edhe më shumë, thinjat e shumta që i kanë dalë nga vitet që mbart por edhe nga hallet e problemet e shumta që i kanë dalë gjatë jetës së saj. Për mua nuk ka fare rëndësi se sa kohë do të kalojmë,sa rrudha ka nëna, sa thinja i kanë dalë dhe do të vazhdojnë ti dalin. Rëndësi për mua ka që më ka lindur, rritur dhe edukuar një nënë e përkryer ndaj po flas me fjalët më të mira".

Ekonomia e tregut të krijon mundësitë, të hap oreksin për të ndërmarrë biznese të tjera. Dhe Ilmiu nuk mjaftoi vetëm me "Riu Mermer" që në saj të punës së madhe të administratorit Ilmi Murati është bërë një ndër firmat më prestigjioze në vend. Tregu kryesor që furnizohet është perëndimi dhe më së shumti Italia, ndaj cilësia dhe korrektesa ndaj klientëve ka bërë "Riu Mermer" të konkurojë me mjaft kompani të mëdha në vend. Dhe ambiciet e Ilmiut janë të mëdha pasi ai shikon larg. Para dy vitesh ndërton një ndërtesë të madhe katër katëshe, me një fasadë të bukur xhami për fabrikën e re të mermerit, për të futur edhe gatrin e madh me të gjithë aksesorët e nevojshëm, por duke qenë arsim dashës si fillim e dha ndërtesën me qera për një shkollë, e cila vazhdon edhe sot të funksionojë si shkollë, por Ilmiu kurrë nuk tërhiqet nga ideja për të ndërtuar dhe montuar fabrikën e re të mermerit.

INVESTIMET NË VENDLINDJE: VËSHTRIM NGA E ARDHMJA

Edhe pse kanë kaluar mbi 15 vite që atëherë kur u nda nga jeta babai i tij Fiqiriu, amanetin e tij që ua la para se të vdiste për të mos e braktisur kurrë tokën, vendlindjen e tyre të dashur, Ilmiu u kthye në Shumbat, u kthye por me projekte afat mesme dhe afat gjata.

Është një sipërfaqe më shumë se një hektar e e gjysmë që Ilmiu e ka mbjellë pemtore, duke iu kthyer edhe njëherë traditës së shumbatasve. Ka mbjellë pemë nga më të ndryshme si: kumbull të varieteteve të ndryshme, dardhë, mollë e lajthi. E gjithë kjo sipërfaqe e madhe e mbjellë është e rrethuar bukur, është bllok i madhe dhe i pa ndarë dhe të krijon përshtypjen e një miniferme nga larg. Të gjitha janë në prodhim por askush nuk pengohet të marrë kumbull, mollë, dardhë e lajthi për të ngrënë, qoftë nga fshati, qoftë edhe rrugëtar. Jo, kjo ka qenë ideja e Ilmiut që kur i mbolli dhe të gjithë fidanat që janë mbjellur anës rrugës, asnjëherë nuk i vjel Ilmiu për tregti por i ka lënë gjithmonë për konsum të udhëtarëve të ndryshëm.

Jo vetëm kaq por në projektet afat mesëm dhe afat gjatë të Ilmiut është edhe agro turizmi në Shumbat. Kërkon edhe nga djem të tjerë të Shumbatit që ta kthejnë fshatin në një nga mrekullitë e gjithë Dibrës, sidomos tani që po zgjatet dita ditës traseja e rrugës së Arbërit. Dëshira e tij është që pse jo në mes të parcelës, aty ku pemtorja e tij tashmë është rritur dhe zbukuruar të ngrejë e dhe shtëpiza të vogla prej druri, të vijnë edhe turistë të huaj e vendas, të shikojnë nga afër resurset e rralla të Shumbatit ku jo vetëm klima por edhe frutat, perimet, bulmeti të gjitha janë bio.

Gjithë qenja e tij njerëzore lëshon vetëm mirësi e asnjëherë ligësi. Shihemi kur takohemi drejt në sy, në fytyrë mirësi rrezaton, vetëm çiltërsi ka në shpirt. i tillë është brumosur qysh fëmijë dhe kështu është ende sot që është bërë vetë prind. Kur rri dhe bisedon nga afër me Ilmi Muratin , ai flet qetë, me zë të ulët, me fjalë të kursyera, por me vend. Fjala e tij peshon por ja që nuk e thotë shpesh, e kursen. Është e gjitha kjo në natyrën e tij që shumë kush e kërkon këtë vyrtyt të bukur njerëzor por nuk e kanë, sidomos në kafen e mëngjesit kur e rrufit qetë qetë e biseda rrjedh vetë dashje pa dashje edhe tek politika që në fakt është bërë më se e zakonshme kohët e fundit. Ilmiu të dëgjon me vëmëndje, nuk të ndërpret kurrë e kur shikon se biseda merr rrjedhë krejt ndryshe ul kokën mendueshëm e hesht. Hesht aq shumë sa edhe ti që e ke përballë e kupton fare qartë se tashmë e ke shkelur disi në bisedë. Ai e ka qëmtuar fjalën si mendim, në jetë, e ka përkëdhelur atë dhe e ka vendosur në funksion të shprehjes së mendimit, të botës emocionale e shpirtërore që ka.

Sa më shumë inteligjent e largpamës të jesh, aq më shumë duhet të mësosh dhe lexosh. E për Ilmiun të arsimohesh do të thotë të jesh i aftë për të kuptuar jetën, për të qenë i gatshëm në përballjen me sfidat që ajo të afron, në rrugët nga do të ecësh që shpesh nuk kanë vetëm lule por kanë edhe gjemba.

Në këtë kuptim hapi i parë për të arritur gjërat që dëshiron në jetë është që njeriu duhet të vendos vetë se çfarë do e kërkon. Vlera që merr diçka që ke fituar, nuk ka të bëjë vetëm me atë që ju afron, por dhe me çfarë është sakrifikuar për të arritur atë. E Ilmiu duke e ndjerë veten të pa arsimuar mirë por që kishte një përvojë të gjatë nga vetë shkolla e jetës dhe e do shumë arsimin punoi e mendoi mjaft në arsimimin e fëmijëve. Vajza e tij Suela vazhdon studimet e larta në degën e stomatologjisë . Djali Azemi vazhdon në degën e bukur të informatikës, kurse i vogli që mban emrin e gjyshit, Fiqiriu është në shkollën nëntë vjeçare.

E Ilmiu e ka të qartë se sot është gati e pa mundur që të kryesh mirë ashtu si duhet, që të jesh plotësisht i sukseshëm, të kapësh më të mirën pa qenë i mençur, i ndershëm dhe i drejtë. Suksesin në biznes, në jetë dhe kudo Ilmiu e ndan së bashku me bashkëshorten e tij, Ismeten se ashtu siç shprehet dhe vetë: "pa ndihmën e përkushtimin maksimal të saj, ndoshta nuk do të kisha arritur deri këtu".

Ilmi Murati, ky djalë Shumbati që sot na vërviti larg e larg me kujtime të bukura ishte "pronar" i denjë i vyrtyteve më të bukura njerëzore, i atyre vyrtyteve që i thamë dhe më lart, i merituar plotësiht për të bërë vetëm punë të mira. I lumtur është ai njeri që gjatë gjithë jetës së tij bën më të mirën e mundëshme dhe mbetet gjithmonë i nderuar dhe respektuar ata që njohin.

OPINION

A do të vijë Meta në takim me arvanitët, rrënjë të Skënderbeut në 550 vjetor?

Nga Abdurahim Ashiku

Presidenti Meta ka ndërmarrë një udhëtim të gjatë në troje ku shqiptarët e Skënderbeut, për ti shpëtuar kuçedrës së Anadollit, mërguan, bënë themele, ruajtën gjuhën, veshjet, zakonet. Ai u pa në dritaret e ekraneve të vegjël vendorë e satelitorë, midis Arbëreshëve të Italisë, në gëzimin dhe krenarinë e ligjshme të pritjes së një Presidenti dhe vlerësimin e disa personaliteteve të larta arbëreshe me dekorata të larta. Diaspora shqiptare, shpërndarë në shekuj si farat që i merr era, ka nevojë për dorën dhe fjalën e ngrohtë që vjen nga rrënjët e hershme të saj, nga vendi mëmë, gjyshe, stërgjyshe...nga mesazhet njerëzore që e lidhin më shumë me rrënjët e të parëve. Falë hapësirës historike që Italia u ka krijuar arbëreshëve në mbajtjen gjallë, madje edhe në kultivimin e gjuhës, zakoneve, këngëve, valleve, hapjes së shkollave, studimit të gjuhës shqipe deri në shkallë universitetesh, rrënjët e diasporës shqiptare në Itali kanë gjetur tokë pjellore e vazhdojnë të nxjerrin filiza, të rriten e të japin fryte. Me radhët e mësipërme nuk kam ndërmend tu hyjë në pjesë studiuesve të çështjes arbëreshe, por në krahëhapje me ta, dua të ndalem paksa në një degëzim paraardhësish të tyre, degëzim që nis me vargjet e një kënge masivisht të njohur...

Moj e bukura More
Ku të lamë e ku më je?...

Fjala është për Arvanitët, për "harresën" zyrtare shtetërore që u është bërë dhe u bëhet tash e më shumë se një shekull shteti të formuar shqiptar, për harresën dje, por veçanërisht për HARRESËN sot. Arvanitët, një popullsi që flet shqip, që ka zakone, këngë, valle, kostume shqiptare, që ka mall e dashuri për të parët e vet, që ka dhënë një ndihmesë të jashtëzakonshme në Revolucionin Grek 1821-1828 për Pavarësinë e Greqisë nga Perandoria Otomane, që i kanë dhënë Greqisë personalitete të larta të politikës, shkencës, kulturës, artit deri në nivelet më të larta të shtetit...janë pranuar zyrtarisht se janë me origjinë shqiptare.

Ish Ambasadori Grek në Republikën e Shqipërisë LeonidhaRokanas i pranishëm në Konferencën Ndërkombëtare të Studimeve Shqiptaro-Greke, ka folur për fenomenin Arvanitas, një fenomen që, sipas tij, nuk tregon vetëm që të dy popujt tanë mund të bashkekzistojnë, por edhe që mund të bëhen një, të pandashëm nga njëri-tjetri.

Ai deklaroi:'

"Në historinë tonë të përbashkët kemi një fenomen që njihet si ai i arvanitasve. Të gjithë në Greqi njohim arvanitët dhe gjuhën e tyre, që është gjuha e folur prej fiseve shqiptare në Greqi, një dialekt i gjuhës shqipe. Një gjuhë që flitet shumë në vendin tim, madje shumë i flasin të dy gjuhët. Disa prej tyre e përdorin edhe sot këtë gjuhë. Fenomeni arvanitas nuk tregon vetëm që të dy popujt tanë mund të bashkekzistojnë, por edhe që mund të bëhen një, të pandashëm nga njëri-tjetri".

Thedhoros Pangallos, personalitet i lartë i shtetit grek deklaronte:

Nuk jam historian që të sjell një mendim të bazuar historik, por jam Arvanitas dhe di historinë e familjes time ashtu siç e dinë edhe shumë arvanitas të Athinës. Le të mos harrojnë lexuesit se në kundërshtim me Athinën, periferia e Athinës zotërohej deri vonë dhe në shumë raste vazhdon të zotërohet nga fshatra që rrënjët e tyre shkojnë shumë mbrapa dhe thellë atje ku vetë familjet njihen mirë mes tyre. Babai im JanaqMeleti (Haxhimeletis) kishte nderin të gjendej në krah të Karaiskaqit si nënkomandant i tij. Për çdo njeri që merr mundin të pyesë do të mësojë shumë histori nga të gjitha fshatrat arvanitase për kapedanët vendorë dhe trimat që luftuan për lirinë e atdheut të tyre. Arbërishtja ishte gjuha që fliste Kundurioti, Kryeministër i Greqisë, Bubulina, Boçari, Suliotët dhe shumë të tjerë. Ishte gjuha që kuptonte dhe dinte Karaiskaqi, Andruçoja e shumë të tjerë luftëtarë të revolucionit për pavarësi. Në fushatën e Azisë së Vogël në vitet 1919-1922 arvanitasit nga Liosia luftonin me bajrakun e tyre. Nuk bënë as një hap mbrapa dhe ranë deri në të fundit. Vetëm kur të kuptojmë këtë do të kuptojmë edhe atë shikimin e arvanitasve të Athinës që përshkruan TitoAthanasiadhi në "Fëmijët e Njovit". Katalogu i heronjve arvanitas të vrarë në 1922 është më i madh se të vrarët e të gjitha fshatrave të Greqisë së mara së bashku. Sigurisht që arvanitasit nuk kanë prezencë të rëndësishme vetëm në librin e madh të të vrarëve të nderuar të kombit grek. Ata kanë prezencë të rëndësishme në botën e letrave, në shkencë dhe në institucionet e shtetit të ri veçanërisht duke marrë detyra shumë të larta ushtarake por edhe poste politike..."

Mund të citoj shumë, madje mund t'ju sjell edhe arvanitas të gjallë në bisedat që kam bërë me ta në zonën e Thivas dhe në zona të tjera të Greqisë. Mund t'ju sjell edhe lotin mbi rrudhat e një arvanitasi që kur e takova për herë të parë më tha "Jam njiqind pa tre vjet" dhe kur e takova për herë të fundit më tha: "Jam njiqind edhe katër vjet", momentin kur i dhashë një libër me intervistën e parë me Të, çastin kur me sy të përqendruar mbi shkrimin dhe fotografinë e tij me duar që i dridheshin më tha: "Po unë nuku di të lexoj!". Arvanitasit mund të them se janë në skaj të kujdesit dhe harresës së shtetit shqiptar, dje, por veçanërisht sot kur falë pranisë së mërgimtarëve nga Shqipëria është zgjuar si asnjëherë "Kushtrimi i të parëve", dëshira për të folur shqip, madje edhe dëshira për ta shkruar shqipen e tyre që ka kaluar gojë më gojë e i ka rezistuar si në asnjë vend tjetër asimilimit. Kam pas fatin të njihem me arvanitas të mëdhenj si Aristidh Kola që "edhe në gojë të ujkut" u ngrit kundër serbëve të Millosheviçit, në përkrahje dhe në debate të mëdha televizive për mbështetjen e kosovarëve në betejën e tyre finale për Kosovën e Pavarur.

vijon në faqen 14


Rruga e Arbërit nr. 152

sport

Për herë të parë në historinë e sportit shqiptarë, brenda një viti kemi tre kampion të niveleve ndërkombëtare në boks dhe kikboks.


Kampionët tanë të botës!

Krenarë për djem të tillë, që nderojnë Bulqizën, Dibrën dhe Shqipërinë, me titujt e tyre kampion dhe gjurmët e mëdha që lënë pas...



Viti 2018 shënoi disa kulme sportive, për djemtë tanë sportist cilësorë, që arritën të fitojnë tre tituj kampion bote në boks dhe në kikboks, brenda pak muajve. Konkretisht Gjetan Keta, u bë fitues i titullit kampion bote në boks, Ferit Keta në kikboks dhe Adriatik Cami në kikboks. Sinjali i suksesve të tilla e pati zanafillën nga Dibra e Madhe, aty ku vëllezërit Keta organizuan për herë të parë një event me përmasa të tilla botërore në boks dhe kikboks, që tërhoqi vëmendjen e mijra njerëzve që mbushën pallatin e sportit në atë qytet shqiptar që për fat të keq ka mbetur përtej kufijve fizik të Shqipërisë dhe ndodhet në Maqedoni.

DIBËR E MADHE, 8 SHTATOR 2018



Gjetan Keta do të ndeshej më 8 shtator përballë sebro-boshnjakut Sladan Janjanin i cili ishte një sportist i niveleve të larta. Mijra njerëz vërshuan nga Dibra, Bulqiza, por të gjitha trojet shqiptare, në mbështetje të djemve tanë, të cilët nën drejtimin e trajnerit të madh, tre here kampion bote ne kikboks Ismail Keta, treguan se janë të pathyeshëm dhe ia dalin mbanë.

Ajo mbrëmje, ishte nga më të bukurat dhe historiket e sportist shqiptar, por edhe historisë dhe kulturës dibrane dhe shqiptare, sepse live nga ringu, këngëtarja big Aurela Gaçe, na solli shumë emocione me këngën e Hajredin Pashës, duke ngritur në këmbë gjithë publikun prej 4000 mijë vetash dhe duke kënduar edhe ai bashkë me Aurelën. Fillimisht në boks u ndesh FERIT Keta përballë turkut Fatih Karakus, por boksieri ynë Keta, tregoi epërsi dhe e detyroi kundërshtarin të tërhiqej. Fitorja e Feritit vlente shumë, por jo për titull, sepse mbrëmja kulm do të kishte boksierin Gjetan Keta, që luante ndeshjen e 26 në karrierën e tij, ku kish fituar 22 e humbur vetëm 4. Ndërkaq qe ky moment vërtet dhuroi emocione të pafund, kur me muzikën e filmit të Skënderbeut, në ring do të ngjitej ai që ndryshe quhet Tajson i bardhë, boksieri triumfues me këmbë dhe duar si prej kromi, Gjetan Keta. Sulmet e fuqishme të tij, detyruan kundërshtarin trë mos rezistonte dot më por të thyhej dhe të ndalonte në raundin e pestë. Ovacionet e fitores s'kishin të sosur dhe Gjetan Keta do të bënte për vete titullin e nje kampioni të ri në boks, pasi i kish provuar tre tituj të tillë si kampion Europe. Dibra e Madhe foli me gjuhën e triumfit dhe prej aty, buroi një titull i ri në boks, që fitohet nga një djalë bulqizak, që ndjek gjurmët e vëllait të tij Ismail Keta. Lajmi i fitores mori dhenë dhe gëzimi u përhap jo vetëm në këto anë, por anë e mbanë botës, kudo ku ka shqiptarë dhe që i gëzohen arritjeve të tilla, ku ngrihet flamuri dhe këndohet himni më i bukur në botë.

MYNIH, 8 DHJETOR 2018



Tashmë një kapitull ish mbyllur, por gara mbeti e hapur për dinastinë Keta. Kundërshtari i Feritit, nuk u ngop me kaq, por kërkoi revanshin. Mediat truke vijuan prej ditësh dhe muajsh, të kërkonin revanshin e Fatih Karakus ndaj Ferit Ketës, madje kundërshtari ofronte dy titujt e fituar si kampion bote në kikboks. Dhe promotori, njëherësh trajneri i tij Ismail Keta e ka pranuar sfidën.

Kësisoj ky vit, mund të konsiderohet si majë e arritjeve të sportistëve dibranë në nivelet ndërkombëtare, me tre tituj bote të fituar në boks dhe kikboks.

Tashmë në Mynih në muajin dhjetor, do të kishim betejën e vërtetë të kthimit. Përgjegjësia ishte rritur, sepse edhe vëmendja e medias ishte e përqendruar te kjo ndeshje. Feriti edhe këtu luftoi si luan dhe ia doli, duke e mbyllur me pike në favor të tij ndeshjen dhe duke bërë për vete dy titujt e botës ne dy federata të ndryshme në kikboks. Vërtet një tjetër mrekulli, një tjetër sukses shumë i madh, që ka të njëjtët autorë dhe promotorë, vëllezërit Keta dhe Ismail Ketën si kryefjalë. Suksesi i Feritit, merr akoma më shumë vlerë, kur mendon që ky boksier në 30 ndeshje të zhvilluara në boks dhe kikboks, nuk njeh deri më tani asnjë humbje...

Edhe ky event u transmetua si zakonisht në ekranin e RTSH sport, që mbetet një promovues në vite i këtyre djemve kampionë jo vetëm në Gjermani ku jetojnë prej më shumë se 20 vitesh, por kudo në botë.

TIRANË, 22 DHJETOR 2018



Në skenë tashmë shfaqet një tjetër sportist, që deri më tani kish provuar një titull europe, por jo bote. Bëhej fjalë për djaloshin nga Tërbaçi Adriatik Cami, që jeton prej 20 vitesh në Athinë. Dëshira për të fituar një titull të lartë në Shqipëri, mundësoi idenë e tij, që federata ËKF, ia bëri realitet. Në sallën sportive Feti Borova, u zhvilluan disa ndeshje, por kulmi ishte përballja e Camit me marokenin Zaruali. Fillimisht kikboksieri ynë e nisi keq ndeshjen në raundin e parë, por i dyti foli vetëm për kikboksierin dibranë që arriti të mposht me KO kundërshtarin, duke ngjallur shumë entuziazëm dhe kënaqësi tek të pranishmit e shumtë. Kësisoj fitorja u shoqërua me titujt kampion në dy federatat përkatëse, ËKF dhe KING OF DHE RING. Me këtë fitore dhe dy titujt e fituar, Adriatik Cami bëri mbylljen e karrierës së tij, duke premtuar se tashmë do të ishte një trajner në këtë sport dhe promovues i kikboksit në Greqi dhe Shqipëri.

Kësisoj ky vit, mund të konsiderohet si majë e arritjeve të sportistëve dibranë në nivelet ndërkombëtare, me tre tituj bote të fituar në boks dhe kikboks.

cyan magenta yelloë black

Cubat e Dibrës

"Ti mor kros i Korkonikës,
A s'i ke njohun cubat e Dibrës"?
Ta çojnë mallin për grikë t'Radikës.
Për grikë t'Radikës e Llokopojë,
Na lshoi zoti veri e vdorë,
Nuk e pamë shoqi shojnë.
Tridhet vetë çi patëm shkue,
Për haber tre vetë kan' pshtue.
Ene di, n'at' Gramë na mbetën,
As xhenazet nuk ua xhetëm,
Vjen Elezi, çiçe vetëm.



Elezi, kur ua pat tregue ngjarjen katundarëve, u pat thanë se secili prej shokëve të tij, pjesën e parave e ka pasë me vete, por mbi të ranë dyshime të mëdha. Vetë puna i bani katundarët me besue se të hollat nuk kanë qenë nda rrugës. Ato i kanë mbajtë me radhë dhe ma në fund i ka marrë Elezi, si ma i fortë, sepse Elezi, përnjiherë u ba pasanik i madh. Ai bleu shumë tokë buke në Lisiva dhe ndërtoi një shtëpi të madhe aty. Pastaj, bleu tokë në Sllovë prej shehlerëve dhe ndërtoi edhe atje nji shtëpi. Bleu lopë dhe kuaj. Elezi u ba bash aga. Të gjitha këto nuk mbaroheshin me 50 napolonat e pjesës së tij. Ai u nda me vllazni, të cilët i la në Lisivadhe dhe vetë duel me banue në Sllovë. Në Sllovë, Elezit nuk i qitën pengesa, se ishte dibran e jo lumjan, edhe sepse ishte i fortë e deshën ta përdorin kundër Dacajve. Edhe Elezi, që kishte ardhë rishtas në atë katund për të përfitue sa ma shumë e me qëllim që katundarët ta bajnë pjesëtar në kullota, në pyje, në bjeshkë, nuk ngurroi të dalë kundër Dacit, aq ma tepër që parësinë n'atë krahinë deshte ta ketë për vete. Dhe me të vërtetë, nuk vonoi t'i vijë grada çaush. Rinia e Elezit në këtë fillim nuk qe hiç e rregullt. Ai sillej keq me katundarët.

Nji ditë, bashkëfshatarit të tij Can Mehmetit, i lypi cucën për nji djalë në katundin Venishtë, të cilin e mbante sejmen me vete. Mbas shumë bisedimesh, Can Mehmeti i tha:

- Unë nuk e jap!

- Ti nuk e jep, po unë e kam dhanë! - iu përgjigj Elezi dhe u ngrit e doli prej shtëpisë së tij.

Cana, për t'u mbrojtë prej Elezit, muer cucën dhe iku te Dullë Ahmeti, në Zall- Kalisë, por ky nuk e mbajti ndore, duke i thanë:

- Or Canë, unë për të marrue e shoh se marrohem tue mos të mbajtë ndore, por Elezit nuk ia kam takatin.

Atëherë Can Mehmeti shkon po atë natë ke Murat Daci e ky e mbajti, por me kusht, derisa të vinte vëllai i tij Cena nga Prizreni. Kur erdhi, Cena i tha të vëllait se do të kishte qenë nji gja ma e lehtë ta kishte përzanë që në fillim, siç bani Dull Ahmeti. Tani, ky ka bujtë në shtëpi tonë. Këtë e din gjithë bota. Pra, mbasi e mbajte, mos e lësho, veç ta dish se kjo punë ka me na qitë telashe, se Elezi asht beter.

Elezi, si e mori vesh se ku asht Cana, i çoi fjalë Cen Dacit me ia dorëzue me gjithë cucë. Ky i tha lajmëtarit:

- Shko e thuej Elezit se na ka rritë bashkë nji nanë. Unë nuk e thirra Can Mehmetin të më vijë ndore, por ai erdhi vetë. Tash për mue, asht turp me ta dhanë. Kur ishim të vegjël, hanim përshesh me nji tas e nuk ziheshim. Tash, si të duesh me u zanë, nisja. Unë të lutem me e falë!

Elezi e fali. Can Mehmeti shkoi në shtëpi të vet. Can Mehmeti ishte prej lagjes Ratke. Cena i dha shtëpi e tokë në Ceren.

Por, nji ditë, Elezi po shkonte për në Sllatinë. Ai kishte me vete Sufë Xhelilin dhe atë djalin prej Venishte. Rasti e solli që në anën e kundërt po vinte Can Mehmeti. Elezi i thotë venishtasit:

- Q'ai, asht babaxhishi it! Vrae, ne merri cucën!

Venishtasi shtiu në Can Mehmetin, por nuk e kapi. Ky shtiu nji herë në ta, plagosi Sufë Xhelilin dhe iku zabeleve. Muer familjen e iku vrap ke Cen Daci. Elezi i çon fjalë Cen Dacit:

- O çomë Hasanin, o mëshihu se kemi pushkë!

Cena iu përgjigj:

- Unë t'u luta me ma falë. Ti na preve në besë. Tash je i lirë, si të duesh!

Të nesërmen, Elezi rrëmbeu 13 krenë lopë të Cenës tue kullotë në fushë dhe i preu të gjitha në oborr që ta shohin bota. Cena nji ditë mbas, mblodhi miq e shokë dhe i rrëmbeu Elezit 150 dhi e 60 krenë lopë nga nji stan që e kishte në Gramë. Elezi u doli në pritë, por as nuk mundi me vra njeri, as nuk mundi me mbrojtë gjanë e tij. Cena mbajti 13 lopë, sa i kishte marrë Elezi dhe gjithë bagëtinë tjetër, ua fali lumjanëve të tij. Meqë Cenën filluen me e ndihmue lumjanët, Elezin filluen me e ndihmue Reçi e Dardha dhe gjithë ata dibranë që i urrenin Dacajt. Kështu u ndez zjarr gjithë krahina. Nuk shtihej pushkë vetëm në njerëz, po edhe në lopë e në qe. Kjo erdhi ngaqë shamata filloi me vjedhje bagëtish e Elezi kishte mbetë i damtuem. Gjithashtu, prisheshin të mbjellat e njenit e të tjetrit. I zemëruem nga këto gjana, Murat Daci hapi nji llogor në nji kodër buzë Drinit, karshi Reçit e Dardhës dhe nuk linte njeri me nxjerrë kokën jashtë n'ato dy katunde e jo ma me mbjellë. Kështu, u mbyll nëpër kulla nji krahinë e tanë.

Dacajve u ndodhi nji fatkeqësi. Nji ditë Murati, duke gjujtë, plagosi nji lepur, i cili shkon e ngordh në bahçe të Mustafë Litës, në katundin Ploshtan. Ky e merr, e rrjep shpejt e shpejt dhe e fut në kusi. Çapat, duke kërkue, mbas ere, e çojnë Muratin drejt e në dhomë të Mustafë Litës. Ai e rrëmben lepurin nga kusia dhe ikën. Prej këtij inati, Mustafa e ban mik Elezin tue fejue djalin e vet me nji cucë të tij. Mustafa, nxjerr njerëz në Ceren dhe e vret Murat Dacin. Mustafa e vrau Muratin në Ceren, me dorë të Ibish Litës. Kjo solli si rrjedhojë që një pjesë e lumjanëve të cilët shkonin pas Mustafë Litës, të largohen prej Dacajve. Cen Daci ra ngushtë. Ai, siç thamë, ishte oficer në Prizren. Tash i duhej me u largue nga nëpunësia dhe të vinte në shtëpi për të udhëheqë luftën kundër Elezit, i cili e kanoste me shfarosje familjen e tij. Mirëpo këtë punë nuk mund ta bante, sepse balanconte Elezin, i cili gjithashtu ishte çaush, d.m.th., ia priste rrugën Elezit me përdorë qeverinë kundra Dacajve.

Lufta kundër Elezit mbeti në dorë të djalit të Cenës, Mahmut Dacit II. Megjithëse Cen Daci nuk i linte djemt' e vet me ba pushkë e u thoshte se këto punë do t'i zgjidhim me qeveri, ky, ishte nji djalë 16 vjeçar, shumë nopran. Sa u vra Murati, filloi menjëherë nga veprimet. Nji natë, i hyni Elezit në grazhd të lopëve dhe ia muer kaun që e ruante për pastërma për dimën. Nji herë tjetër, ia rrëmbeu qetë e mëdhenj në stan dhe i solli në shtëpi. Nji ditë, i hyni në avlli mbrenda dhe u fsheh në turën e druve. Ishte ramazan. Ai qëndroi aty, gjithë ditën, i fshehun. Priste të vijë akshami e të çelin iftar e t'i vrasë të gjithë në sofër duke ngranë bukë. Kur u afrue koha e ramjes së daulles për çeljen e iftarit, u hap porta dhe doli mbi shkallët, shehu i Vleshës i cili filloi të thërrasë ezanin e faljes së akshamit. Tue rrotullue kokën sa andej këndej, ai e sheh Mahmutin që kishte pasë nxjerrë jashtë gjysmën e trupit dhe tash përpiqej me u strukë prapë në vend. Shehu e mbaroi ezanin duke u dridhë nga frika dhe filloi me e përbetue Mahmutin:

- Pash' Zotin! Për hatër të teqeve, për hatër të vorreve të mira, mos ban gja sonte!

- Or sheh, nuk bane mirë që ma bane këtë rixha, - u përgjigj Mahmuti, por na nuk e kemi ba zakon me ua prishë teqeve. Sonte t'i fala, por mos u kallxo se kam qenë unë këtu, se, po u kallxove, do të vras edhe pse je sheh, do të vras!

Ai po bahej gati me ikë, por porta u hap përsëri. Ismeqari nxori në krye të shkallëve nji tepsi të madhe me byrek për t'u ftohë, se ishte aq e nxehtë sa nuk mund të vihej në sofër, ndërsa agjënimtarët, nuk mundeshin me durue gjatë pa ngranë. Si e vendosi tepsinë përdhe, shehu i vu dorën në gjoks ismeqarit dhe e futi mbrenda:

- Mos dilni asnji jashtë, - u tha, - se e keni Mahmutin në turrë të druve!

Mahmuti, rrëmbeu tepsinë e byrekut dhe iku.

Kur shkoi në familje të vet, e vu në sofër e u tha:

- Hani, u baftë mirë byreku i Elezit!

- Mos fol ashtu, magjar, - ia priti Ahmet Daci, - se këtu kemi miç jabanxhi e kujtojnë se për njimend!

- Në mos besofshi, pritni nesër haberin, - u tha Mahmuti.

Nji ditë tjetër, Mahmuti ishte fshehë mbas do shkurreve, në nji kodër dhe ia kishte ngulë sytë kullës së Elezit. Ishte shumë larg, por ishte nishantar i mirë. Priste mos lëvizte njeri, andej, në sharishan të kullës. Në nji frengi të ngushtë i duket sikur lëviz nji hije. E ven pushkën në sy dhe e shpërthen. Nuk vonoi dhe u ndigjuen britmat e grave. Kishte vra djalin e Elezit, Ibrahimin. Kështu, çunaku e pagoi mixhën e vet, Muratin dhe ia thurën kangën:

MAHMUT DACI II
(Kanga e parë)

Çai Cen Daci, nji burr i zi,
Elez Ndreun po e kërkon n'xhixh.
- Unë n'xhixh sun jom tuj t'ardhë,
Se ke nisë bidat nëpër arë.
- T'asht mbushë mendja se je zengin,
Hallin tim or Elez, s'ma din!
Për në paça gjal' me armë,
Këtë punë do ta çojm' kadalë.
Mahmut Daci nji gjalë drague,
Muer manxerkën termal tue shkue.
Po shkon rrugës tuj menue:
"I lutet zotit me e pagjue,
Të tana dertet me ja mbarue".
Çfar' i dojke zemra, ia dhanke zoti,
Elez Agës iu vrake voci.
N'kullë të gjatë, ke s'i din hall topi,
N'kullë të gjatë, kat e m'kat,
Sharapulli u mbush me xhak,
Kanë dalë gratë tue rrafë shuplakat
Po i thonë miçt: - Ka qenë taksirat!
- Taksirati, si m'hini n'kullë?
- Sojt po t'vjen, or Elez, Daci n'udhë!
- Unë n'udhë Dacit sun i vete,
Se Mahmuti m'vret opete.
Him Elezi kishte thanë:
- Kam lan babë e kam lan nanë,
M'a ban xhakun elb e tërshanë!
Ahmet Daci nji burrë i xhanë:
- Thuej Elezit, sun më more nëpër kamë,
Nëpër kamë sun më more,
Can Mehmeti m'ka ra ndore.
Kollaj qenka me u ngatërrue,
Zor na qenka me u shkatërrue!

Që nga fillimi, deri në pajtim, kjo shamatë kushtoi 36 xhenaze. Nga Dacet u vra Murat Daci dhe u plagos i biri i tij Shaqiri, që asht gjallë edhe sot.

Populli do të përjetësojë në këngë edhe shumë ngjarje të tjera të kësaj periudhe...

Për më shumë, lexoni në librin
"Rrëfime dhe këngë popullore"

RRËFIME DHE KËNGË POPULLORE
MUNIR SHEHU
Botimet M&B, 2018

ISBN 978-9928-256-58-4
Faqe 272
Çmimi: 1000 lekë

Rruga e Arbërit nr. 152

opinion

Dhe dy letra nga dy mësues të mi që adoleshencën e tyre e kaluan si mësues shumë larg vendlindjes...

A duhet t'i pyesin studentët prindërit apo gjyshërit si u shkolluan ata?

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Jam në krah të studentëve, madje i kam zili për freskinë që i sjellin kohës, në pamje fizike, por edhe në mendimin plot bukë. Thashë se "i kam zili" sepse brezi im, tash gjyshër, lindur e rritur në tjetër kohë, nuk e kishte gojën të mbushur që të dilte e protestonte si ata protestojnë sot. Jetonte kohën më të vështirë pas një lufte shkatërrimtare në qelizë të jetës. Linda në kohë lufte dhe klasën e parë e fillova atëherë kur në gazeta, libra, bile edhe faqe kodrave shkruhej "Bukë dhe kulturë për popullin"!

Do kohë nuk kishim fletore e lapsa dhe, edhe librat na i përcillnin apo i përcillnim brezave që vinin pas. Nuk e di se si por në klasë të parë në vend të fletoreve na sollën pllaka guri, pllaka të zeza futur si fotografitë në kornizë, dhe lapsa guri. Pllakat në njërën anë ishin të vizuara për bukurshkrim e në anën tjetër për aritmetikë. Shkruanim mbi pllakë ushtrimet matematikore detyra shtëpie, shkruanim edhe alfabetin si detyrë bukurshkrimi. Mësuesi i vlerësonte, vinte notën mbi pllakën e gurtë e më tej në regjistër e ne, me një fshirëse të sajuar si zar, i shuanim për të marrë detyra për ditën tjetër. E mendoja se kjo gjë ndodhte vetëm në fshatin tim luginës së Drinit të Zi dhe nuk e publikoja se druhesha se do më qeshnin, por kur këtë ma pohoi në një bisedë edhe një personalitet i sotëm i shkencës për fshatin e tij në Lumin e Vlorës e besova se ishte kudo.

Mësuesit një "pëllëmbë vite" ishin më të mëdhenj se ne por atë që na jepnin e thithnim me forcë e kishin në përmasat e një universitari. Vonë, kur bëra një shkrim me titull "Mësuesit më të përkushtuarit e më të harruarit" më erdhi dy letra. Njërën ma shkruante mësuesja ime e klasës së tretë që më dha mësim në vitin 1951 e tjetrën mësuesi i klasës së dytë.

Po shkëpus dy fragmente...

"Akoma pa mbushur 16 vjeç, pas një kursi metodik pedagogjik, lash Beratin dhe erdha në Peshkopi, fillimisht në fshatin Brezhdan, i cili më ka lënë mbresa të paharruara në kujtesë dhe pastaj në kufi, në fshatin malor të Cerjanit ku e ndjeva veten në shtëpinë time. Pra për herë të parë hyra në jetë, në punë si arsimtare për tu dhënë njohuritë e para të gjuhës sonë të bukur shqipe vocërrakëve aq të etur për dije. Në këtë kohë aq të vështirë për të jetuar ku përveç varfërisë qemë të detyruar të përballemi edhe me kërcënimet dhe ofendimet e disa skeptikëve apo keqdashësve që e shihnin si luks duke ndikuar që fëmijët e sidomos vajzat të mos ndiqnin shkollën. Pra ne arsimtarëve të atij brezi na duhej jo vetëm të jepnim mësime në shkollën fillore por edhe të shkonim në çdo familje, shtëpi më shtëpi për tu mbushur mendjen disa prindërve që hezitonin të dërgonin fëmijët në shkollë si dhe për të grumbulluar të gjithë analfabetët në kurset e luftës kundër analfabetizmit që i zhvillonim mbrëmjeve pas pune. Për mungesë të klasave dhe numrit të domosdoshëm të arsimtarëve na duhej të jepnim mësim në klasa kolektive. Puna kaq e ngarkuar na detyronte të përgatisnim planet e punës për dy klasa dhe kurset e analfabetizmit deri natën vonë. Por kjo punë, megjithëse e lodhshme nuk na demoralizonte, përkundrazi ndjenim sadisfaksion. Ne e bënim këtë sepse e quanim për detyrë ndaj brezave, e quanim të domosdoshme dhe në asnjë mënyrë nuk na shkonte mendja se të kesh dhënë apo të japish mësim në fshat është ofendim apo ke qenë dhe je i persekutuar. Një mendim i tillë është ofezë për çdo patriot, ofezë për rilindësit që kthenin shtëpitë e tyre në shkolla dhe nën kërcënimin otoman apo të shovinistëve grekë, serb apo maqedonas, u jepnin dritë, pra u jepnin arsim fëmijëve shqiptarë të lënë në errësirë duke sakrifikuar edhe jetën. E pra, këta, qenë frymëzimi për ne dhe e quanim për nder të mësonim fëmijët e malësorëve të lënë në errësirë e injorancë pa shkrim e lexim. Sa kënaqësi është për ne kur shihnim që fëmijët e këtyre malësorëve të zgjuar, me gjithë që në kondita shumë të vështira, mësonin me vëmendje. E ndjeva veten krenare kur pashë nxënës të mi nga Brezhdani e Cerjani i Peshkopisë, nga Kukësi në Veri, nga fshati malor i Bogdanit në Berat apo nga Saranda në Jug të Shqipërisë, etj. ku unë kam punuar si arsimtare të jenë bërë me arsim të lartë e të mesëm pedagogjik, mjekësor, agronomi etj. Pavarësisht nga trajtimi material, i cili edhe sot është tepër diskriminues për arsimtarin dhe le për të dëshiruar, gjithashtu pavarësisht nga mohimi që iu bë personit tim kur erdha në Tiranë për të vazhduar punën e dashur të arsimtares, me gjithë arsimin pedagogjik që kisha, ndjehem krenare dhe aspak e penduar, mbasi gëzoj simpatinë e ish nxënësve të mi kudo që janë. Le tu rëndojë në ndërgjegjen e tyre ajo padrejtësi, atyre që e bënë. Ju falënderoj për kujtimet që më zgjuat, kujtime të cilat i ruaj edhe në marrëdhënie me shumë familje të nxënësve të mi, kudo që kam qenë.

Ju përshëndes
Nigjare Didi (Velçani)
Tiranë 7.7.1993

Në të njëjtën kohë një tjetër letër, tash nga një mësuesi im i klasës së dytë nga Përmeti shoqëruar me një fotokopje të borderosë së mësuesve të Dibrës 16-31 janar 1951...

Mësuesi im më shkruante...

"Lexova me vëmendje artikullin e datës 20 qershor 1993 "Mësuesit – më të përkushtuarit dhe më të harruarit" të shkruar nga ju Abdurahim Ashiku.

Përmbajtja e shkrimit kujton një të kaluar reale, por i bën thirrje edhe një realiteti të sotëm. Më emocionoi por edhe më entuziazmoi mendimi juaj që jepni për disa mësues, të ardhur aty në Brezhdan të Peshkopisë dhe veçanërisht për mua, më të riun, në moshën 18 vjeçare, i ardhur nga jugu i Shqipërisë, nga Përmeti (Fshati). Unë dhe të tjerët erdhëm me dëshirën e madhe për të shkolluar vëllezërit dhe motrat tona, fëmijët e vegjël, por edhe për të zhdukur një plagë të trashëguar nga shekujt e kaluar, analfabetizmin e prindërve tanë. Për këtë nuk morëm parasysh as largësinë, as rrogën e vogël e sa e sa vështirësi të tjera të atyre viteve, punuam para dhe pas dite me përkushtim atdhetar sepse për ne qe e qartë që i shërbenim atdheut, i shërbenim Shqipërisë dhe vetëm Shqipërisë.

Mbi çdo gjë për ne qe dashuria për fëmijët e vegjël, për tu mësuar atyre shkrim e këndim, dashurinë për atdheun dhe më vonë për të ecur me këmbët e tyre në shërbim të Shqipërisë, të familjes dhe të vetes.

Ne brezi i arsimtarëve krenohemi, që këtij qëllimi ia kemi arritur duke e bërë Shqipërinë të ketë një vend të merituar në botë, me një popull plotësisht të arsimuar dhe pa asnjë analfabet. Ne arsimtarët krenohemi kur takohemi ose na takojnë ish nxënësit tanë të vegjël, tash mësues, inxhinierë, ushtarakë, këngëtarë etj. Unë tash kam hyrë në vitin e 6-të të pensionit, por nuk mund të harroj mikpritjen e atij populli dibran, respektin dhe dashurinë që ata treguan për ne arsimtarët jabanxhinj. Shumë kujtime të pashlyera më janë fiksuar nga gjithë familjet e Brezhdanit. Mikpritja, bujaria, thjeshtësia, komunikimi reciprok na e lehtësonte detyrën tonë të vështirë por humane. Këtë respekt e provova atëherë, por që e rishfaqën duke e provuar edhe një herë në vitin 1968 kur u ndodha me shërbim në qytetin e Peshkopisë dhe ku brezhdanasit me të marrë vesh ardhjen time në qytet nuk më lanë asnjë natë të rrija në qytet. Puna e mësuesit i del para sysh gjithsecilit. Është e vetmja rrugë që e kalon gjithkush, është pjesa më e bukur e gjithsecilit. Në përfytyrim i del secilit mësuesi i tij i parë, pavarësisht se çfarë detyre kryen ai sot. Asgjë nuk duhet t'i mohohet mësuesit, sepse ata janë dhe do të ngelen më të përkushtuarit...

Me respekt
Gavril Kota
29.6.93.

Këto rreshta të shkruara me sinqeritetin më të lartë të mundshëm ndokujt nga brezi i sotëm i duken si fantazi.

Për mua janë të vërteta sepse ato çaste i kam jetuar, madje i kam në shpirt si kujtime të çmuara.

Pasi mbarova shkollën fillore mu desh që çdo ditë, vjeshtë me shi, dimër me akull e dëborë, pranverë me gjelbërim e lule, të bëja, mbathur jo me çizme por me opinga lope, gjashtë plus gjashtë kilometra rrugë nga Brezhdani në Peshkopi e kthim për të vazhduar shkollën shtatëvjeçare. Nga fshati im me "treqind shtëpi" para meje ishte një nxënës që iu desh ta ndërpriste mësimin në klasën e shtatë për tu thirrur si mësues asaj kohe kur "shtatëvjeçarja ishte universitet". Pas meje ishin dy të tjerë...

Ende në psikologjinë e fshatarit zotëronte mendimi më mirë një vezë sot se një pulë mot, më mirë me dele e me dhi se sa me shkollë. Për djemtë ishte fjala se sa për vajzat, pas fillores së detyruar mbylleshin jo rrugët por shtigjet.

Në vitin 1956 tek vazhdoja shkollën e mesme bujqësore në Fier për menu mëngjesi kishim çaj me bukë misri e marmelatë...

Ende vendi nuk i kishte ikur sistemit të triskëtimit...

Diçka do të ndryshonte vitet që erdhën por përsëri e jetonim jetën (tashmë studentore) si na vinte. Vitin e parë në Institutin e Lartë Shtetëror të Bujqësisë si e mori emrin në shtator 1961, dhjetëvjetorin e tij, flinim i tërë kursi, 120 vetë në një sallë të madhe në godinën e vjetër të Shkollës së Dakes në krevate druri dhe në dyshekë me kashtë... Një vit më vonë "fjetorja" u bë sallë studimi, madje me ngrohje qendrore çka na e hiqte të dridhurat fizike provimeve të dimrit.

Në fjetoren "e re" (dikur klasë e shkollës së Dakes) flinim 28 vetë, në krevat hekuri e në dyshekë pambuku... Dhe vetëm në vitin 1966, kur u ndërtua godina e parë e konviktit të Institutit një pjesë nga ne, në prag të diplomimit, u strehuam në dhoma 6 vendeshe, të ngrohta e me një hapësirë studimi edhe "në dhomë"... Bursa ishte modeste, 3000 lekë të kohës, 2400 prej të cilëve shkonim për ushqim, 100 për fjetje e 500 për ndonjë film apo teatër e opera. Për tu veshur bukur ferma e Kamzës dhe ajo e Laprakës i kishte dyert e hapura, kuptohet punë me bel e kazmë...

...Kur mbaruam Institutin shkuam atje ku na kish ra lotaria, fushave e maleve për të mbjellë e për të korrë... Kohët kanë ndryshuar, hapësira është zgjeruar aq shumë sa nuk ka "pashë njeriu" ta masë. Studentët që kanë mbushur bulevardet e protestojnë në të drejtën e kohës duhet t'i pyesin baballarët, nënat, gjyshërit dhe gjyshet e tyre që u ra barra e rëndë ta nxjerrin vendin nga analfabetizmi i tejskajshëm në shkollimin masiv tetëvjeçar e në shkollimin e mesëm në të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe edhe më maloret, që krijuan institutet e para dhe Universitetin e parë në Shqipëri 61 vjet më parë (çudi se sa të vonuar paskemi qenë në rrugën drejt dijes) si e jetuan kohën e tyre.

Në radhët e studentëve dëgjohet e njëjta parullë si në dhjetorin 1990... "E duam Shqipërinë si gjithë Evropa"!

Një thirrje që më ngjan me duart e shtrira në lutjet në kisha e xhami drejtuar Zotit. "A po ma fal Evropën Zot!"

Studentëve të dhjetorit 2018 do tu shkonte për bukuri parulla:

"TA BËJMË SHQIPËRINSI GJITHË EVROPA!"...

Dhe kjo bëhet duke i vënë shpatullat e jo duart...

12 dhjetor 2018

A do të vijë Meta në takim me arvanitët, rrënjë të Skënderbeut në 550 vjetor?

vijon nga faqja 11

Kam njohur, madje kam në bibliotekën time, libra të Tito Johallas ndër të tjerë një libër për Skënderbeun dhe një vepër voluminoze për arvanitasit e ishullit të Androsit, në analizë të fjalës së shqipes të banorëve të ishullit, një ndër ishujt e mëdhenj të Greqisë ku arvanitasit ishin shumicë. Për arvanitasit janë shkruar (dhe vazhdojnë të shkruhen) shumë libra jo thjesht publicistikë e folklorikë por shkencorë, historikë, albanologjikë, biografikë. Kësaj pasurie të mbledhur me përkushtim dhe kujdes profesional, në kushte aspak të favorshme, deri në kushte ilegaliteti, shteti dhe politika shqiptare i ka qëndruar dhe vazhdon t'i qëndrojë larg, në pozicionin pa sy për ta shikuar dhe pa veshë për ta dëgjuar. Për disa muaj do të mbush njëzet e tre vjet mërgimtar në Greqi. Në kujtesën time të fortë për shkak të profesionit të gazetarit që e kultivoj edhe këtu prej kaq kohe, nuk kam parë, nuk kam dëgjuar që ndonjë personalitet i lartë i shtetit shqiptar të ketë shkuar në ndonjë takim me arvanitas, në stere apo në ishuj. Kam një koleksion CD me këngë arvanitase, këngë me tekste të AristidhKolës dhe me muzikë të Moraitit, këngë që i dëgjoj me dëshirë dhe më japin informacion e mall për jetën e gjallë që përshkruhet në to. Këto këngë janë kënduar dhe këndohen me raste anë e kënd Greqisë, veçanërisht në trevat arvanite por, keq më vjen, nuk i kam parë apo dëgjuar në skenat e festivaleve shqiptare e në veçanti në Festivalin Kombëtar të Gjirokastrës. Presidenti ynë i nderuar, simbol i bashkimit të popullit shqiptar, ishte midis arbëreshëve të Italisë. Bisedoi me ta, këndoi e vallëzoi me ta, vlerësoi disa nga personalitetet e larta arbëreshe për ndihmesën që ata kanë dhënë dhe japin për rrënjët shekullore të tyre. E bashkë me të, si mikpritës ishin edhe personalitetet më të larta të shtetit italian. Presidenti Meta ishte edhe në Kroaci, në një nga oazet e shumtë të mërgatës së hershme shqiptare që ende e ruajnë shqipen e stërgjyshërve të tyre.

U ngroha në shpirt ashtu siç u ngroha kur doli në fotografi me fëmijët e Rozhajës të Malit të Zi, kur shkoi në Manastir në vatrën e artë të alfabetit të shqipes, në Prizren e ma do mendja do të shkojë edhe në Turqi ku thonë se janë ngujuar diku tek pesë milionë shqiptarë, ngujim i gjysmë shekullit të parë të njëzetë e që për mungesë të shkollave e shkollimit shqip janë asimiluar keq...

Më vjen mirë që presidenti i vendit tim, me paratë e taksapaguesve shqiptarë, udhëton në kërkim të rrënjëve të shqipes e të shqiptarëve. Do të thosha "hallall i pastë" sikur një ditë ta ndalë fluturimin në aeroportin e Athinës, aeroport çuditërisht i ndërtuar në trojet e arvanitasve, një komuniteti kompakt ngujuar atje në shekull. Do të desha që të takohej me arvanitasit për tu treguar se ka ardhur koha që ata ta flasin dhe shkruajnë gjuhën e tyre, atë të prindërve dhe të gjysh-stërgjyshërve që ende e mbajnë të gjallë e të freskët. Do të desha që në bisedimet midis dy vendeve të futet edhe çështja arvanite, e gjuhës dhe zakoneve të tyre, mbase edhe hapja e shkollave shqipe.

E kam kërkuar publikisht (edhe në letër në adresë të Presidentit e Kryeministrit) që në vitin jubilar të 550 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut tu kërkohej bashkive të Athinës dhe Selanikut një shesh ku të vendoset busti apo shtatorja e Gjergj Kastriotit...

Do të desha që në Kuvendin e Shqipërisë të votohej unanimisht një ligj për shkollimin shqip të fëmijëve në Greqi, për pagesën e mësuesve që edhe pas 17 vjetësh vazhdojnë të jenë vullnetarë, pa asnjë lloj page, pa asnjë lloj stimuli moral, që me një marrëveshje shtetërore shkollat greke të hapen në fundjavë... Do të desha...

Dua unë..

Por nuk donë Presidenti, Kryeministri...

Abdurahim Ashiku

Një biografi e Elez Isufi sipas kujtimeve
të bashkëkohësit të tij, Ismail Strazimiri

Elez Isufi, *dibrani që* u dekorua *nga mbreti i Austro-Hungarisë*

Nga **Ismail STRAZIMIRI**

Kujtoj se asht e tepërt me u zgjat në përshkrimin e gjendjes s'administratës, kur ishte Ahmet Zogu kryeministër e ministër i Punëve të Mbrendshme, mbasi të interesuemit e dinë fare mirë. Veprimet arbitrare dhe ilegale provokuen që të bahesh antentati kundër Ahmet Zogut në parlament. Ahmet Zogu shpëtoi me nji plagë të vogël në dorë. Por, përveç disa pak besnikëve të tij, gjithë populli dhe ushtria u çue kundër tij dhe banë Revolucionin e Qershorit, i cili përfundoj me fitimin e kryengritësve dhe me ikjen jashtë Atdheut të Ahmet Zogut me shokët e vet...

Elez Jusufi e çmonte delikatesën e gjendjes së turbullueme, prandaj herë pas here i shkruente dhe i tërhiqte vrejtjen ministrit të Mbrendshëm, Rexhep Shalës, ashtu dhe Bajram Currit. Nga fundi i telegrafoi Rexhep Shalës, tue i tregue se rreziku që i kërcënohet sot Dibrës, sigurisht, nesër do t'i kërcenohet Tiranës e gjithë Shqipërisë. Me këtë kuptim, i shkroi nji letër edhe z. Kristo Dako, ish-deputet i Dibrës, i cili ia dëftoi letrën Fan Nolit, kryeministër i qeverisë revolucionare. "E di, ishte përgjigjur Fan Noli, plaku nuk shkruan gënjeshtra dhe nuk gabohet, por, sigurisht, ka kalue koha për marrje masash".

...Pak ditë para se të pëlciste kryengritja, Ahmet Zogu, me anë të Dine Hoxhës e të Murat Kaloshit, i kishte propozue Elezit shuma të mëdha dhe zotime me i përmbush dëshirën, mbasi të rrëzonte regjimin e të merrte në dorë fronin e shtetit. Por, thotë Dine Hoxha, meqenëse Murat Kaloshi s'dinte me e paraqit çështjen në atë hollësi mendjeje që meritonte u zemërue Elezi dhe s'u bind. Të gjitha këto arsye, ashtu dhe thirrja zotnuese e ndërgjegjes kombëtare, e shtynë me mos shikue asgjë me u hedh në rrezik me pezmatim e dëshpërim të madh. Merr me vete nja njiqind vetë nga Reçi e nga Dardha dhe shkoi në Peshkopi, nji ditë përpara se të fillonte kryengritja.


...Krahina e Maqellarës përbahet prej 23-24 katundesh. Rruga që shkon nga qyteti i Dibrës së Madhe për në Peshkopi i ndan në dysh këto katunde. Për këtë shkak katundet e ndame në dy pjesë quhen "katundet mbi udhë" dhe 'katundet nën udhë". Katundet mbi udhë janë rreshtue rranzë malit që e ndan kufinin shqiptar me atë të Serbisë. Katundet nën udhë janë ndërtue gjatë buzës së Drinit. Nga të dy këto pjesë nji numër i madh i popullsisë ishin fut në qytet për tue u vu në shërbim të Ahmet Zogut.

Simbas planit të përgjithshëm, fuqitë e Ahmet Zogut në këtë mënyrë do të nisshin veprimin:

Fuqia e Aqif Lleshit, e Taf Kaziut dhe e Pëllumb Lleshit do të suleshin në anën që quhen "katundet nën udhë" dhe fuqia e Dine Demës dhe Dine Maqellarës do t'i mësynin "katundet mbi udhë". Fiqiri Dineja me nji fuqi tjetër do të krefte rranxën e malit dhe mandej do të pushtonte gurin e Erebarës që zotnon mbi Qenok. Major Gjilardi, Sul Shehu, Mustafa Bej Serdari dhe Sherif Tafa me nji fuqi të konsiderueshme do të dërgojshin nga maja e malit Skertec, në mënyrë që t'u mbajshin krahët fuqinave të përmenduna ma nalt dhe t'i pranojshin në rast nevoje Dine Hoxhën, Murat Kaloshin dhe Selim Nokën me fuqitë e tyne do të rraseshin në katundin Pollozhan dhe do t'i kërcënohesh Peshkopisë e kazermës së saj. Në të gjitha këto fuqi, përpos atyne që komandonte Dine Hoxha, Murat Kaloshi e Selim Nezha, kish oficera rusë, topa, mitralozë, kafshë të ngarkueme me municion e ushqime.

Elez Jusufi, tue e pa gjendjen kritike dhe tue e çmue se fuqija e tyne e vogël nuk ishe gjendje me i përballue fuqitë e mëdha të kundërshtarit, thuhet se i propozon Ali Riza Topallit që të tërhiqeshin në disa vende strategjike të malësisë, prej ku ta pengojshin Ahmet Zogun, në veprim e në marshim kundrejt Tiranës. Elezi dëshironte që të mos derdhej gjaku kot, ta zgjojë qeverinë e Tiranës dhe t'i sigurojë kohë kësaj për me marrë masa defensive. Por Ali RizaTopalli, për shkaqe të pazbulueme prej nesh, nuk e pranoi propozimin e Elezit.

Fuqitë kryengritëse, kur iu avitën Qenokut, ndeshën n'atë fuqi të vogël q'ishin zbrapsë nga Maqellara dhe kishin zanë vend aty. Krisi pushka. Meqenëse mbi gur t'Erebarës s'kishte



ndonji fuqi qeveritare, Fiqiri Dinja e pushtoi pa ndonji pengim dhe Qenoku ra në dorë të kundërshtarëve pa ndonjë vështirësi të madhe. Katër a pesë të vramë e të plagosur mbetën nga të dy palët.

Ushtria e rregullishme që ndodhesh në Llasen, nji vend nja njizet minuta larg Peshkopisë, luftonte me trimni të jashtëzakonshme dhe la nja 15 dëshmorë. Fuqia e major Gjilardit dhe e Sul Shehut që qe dërgue nga maja e Skertecit, e qëlloi ushtrinë nga krahu i majtë dhe në këtë mënyrë e lehtësoi sulmin që bajshin kryengritësit në ballë t'ushtrisë. Natyrisht, në fund, fituen kryengritësit.

Kur vazhdonte lufta në Llasen duel në Peshkopi Suf Xhelili. Mbasi e konstatoj gjendjen kritike u kthye e u tha Elezit e Ali Rizait e oficerave të tjerë se "po të qëndrojshin edhe ma në Peshkopi, do të bijshin rob në duart të kryengritsave ose do të vriteshin, mbasi situata ishte përtëkeq fare". Kur pyetet Ali Rizai sa municion ka në depo, ai përgjigjet se s'kishte veçse katër arka. Kjo përgjigje i tronditi dhe i trembi të gjithë, në çrregullim të plotë...

Elezi i imponoi burrnia e shtefnija që të mos largohet nga kazerma pa ardh dhe ajo ushtri që ndodhej në ballët e luftës dhe që ishte dhanë urdhni me u zmbraps. Prandaj, priti i mërzitun. Ndërkohë, zunë me ra si breshën plumbat e kundërshtarëve n'oborr të kazermës, atëherë u çue Suf Xhelili dhe duel jashtë kthinës.

Atë e ndoq mbasandej edhe Elez Jusufi. Suf Xhelili u vra tue zbrit nga nji mur i ulët i oborrit të kazermës, kurse Elez Jusufi u plagos n'oborr. Ali Riza Topalli me shokët e vet duel nga kthina për t'ikë, por tue e pamë Elezin që ishte rrëzue i plagosun, Ali Rizai e kapi kryet e vet me grushta dhe u kthye prapë me gjithë shokët e u mbyllën mrenda. Mbas nja pesë minutash u futën ngadhnjyes në kazerma Fiqiri Dinja, Hysni Dema, Sul Shehu dhe Aqif Lleshi; disa ditë më parë këta të fundit i kishte armatosur Ali Rizai. Kështu Ali Rizai bashkë me shokët e tij oficera ra rob në duert të kryengritsave dhe lufta mori fund.

Suf Xhelili u vra dhe vdiq në çast. Elez Jusufi, i plagosun me dy plumba nën kërthizë, ndërroi jetë natën e 29-30 dhjetor 1924. Vrasja e tyne s'qe aksidentale apo e rasës. Ishte përgatit nergut dhe u krye prej njerëzve të shenjuem. Ndërkohë u vra Murat Qerrja dhe u plagos Nesim Ahmeti, Osman Musai dhe Mehmet Kurti, të gjithë nga Dardha e besnikë t'Elezit...

Elezi leu në katundin Sllovë të krahinës Trojak në Dibër të Vogël. I kishte kalue të gjashtëdhjetë vjetët. Ishte trashaman e me shtat mesatar. S'kishte fuqi oratorike, as bukuri trupi e ligjërimi, fuqinë mendore e kishte të pasun e të fortë. Gjithë jetën e kishte shkue ndër male e në mes të malësorëve. Në kohën e Turqisë kishte takue e bisedue me njerëz të mëdhenj. Pak fliste e shumë dëgjonte. E kuptonte mendimin e folësit, por nuk e thoshte atë që mendonte. Mpreftësia e mendjes dhe hollësia e gjykimit t'Elezit i kishin habitë edhe diplomatët e huaj. Si në t'ecun, ashtu dhe në të folun e në punë ishte i randë e i plogët. Ishte kokëfortë dhe njeri me sedër. Sa qe gjallë kërkush s'mundi me e bamë vegël e dëshirave të veta.

Në kohën e Turqisë, simbas zakonit t'athershëm të malësorëve ishte bamë dalëzotësi i pasanikëve dhe i pashallarëve të mëdhenj të nënprefekturës së Rekës që kishin kope të mëdha delesh dhe i mbronte këta kundrejt të liqve dhe kusarëve. Për këtë shërbim merrte prej tyne nji shpërblim të caktuem dhe dhurata të mjafta. Kësilloj, në krahasim me shokët, qe bamë mjaft i pasun.

Qe bamë prijësi i popullit të Dardhës e të Reçit që shquhen në trimni. Shtëpija e tij ishte streha e tyne. Influenca e shkathtësia e Elezit jo vetëm në Reç e në Dardhë po shtohesh edhe në të gjithë krahinat e Dibrës.

Zotësia e influenca e Elezit në Dibër që dukej qysh në kohën e Turqisë kur ishte kapter i gjindarmërisë, detyrë kjo, gjatë kohës së ushtrimit të së cilës i pat bamë shumë shërbime qeverisë, tue i pre hovin cubnive, kusarive e ligësive të ndryshme që baheshin prej andej.

Imperatori i Austro-Hungarisë Franz Josefi e dekoroi me "Frans Jozef-Orden", me dekoracion lufte së bashku me dekretin përkatës, Z292 1917, më datën 2 Fruer 1917, kur shkoi në Vjenë për të marrë pjesë si delegat i Dibrës në festën e datëlindjes së tij.

Në Shqipni, në mënyra të ndryshme, Elezi bani shërbime të çmueshme. Në kohë të Turqisë, më 1912, kryengritja e madhe që u ba në Kosovë, ma së pari ka fillue me guximin e Elez Jusufit. Kur qytetarët e Dibrës së Madhe dolën në mal, me përkrahjen e Elez Jusufit e mbasi u bashkue ky burrë me ta, arrinë qëllimit që patën. Prapë në 1912, kur ushtria serbe marshoi për në Dibër nga ana e Prizerenit, në Qafën e Kolesjanit të Lumës Elezi bani nji luftë të rreptë kundra serbëve që vijshin si dhunuesa dhe iu shkaktoi dëme të mëdha.

Më 1915, kur ushtritë serbe, të thyeme prej fuqive austro-hungareze, po ikshin nëpër Lumë, Elezi i priti ndërmjet Kalasë së Dodës e Trojakut dhe në luftën e përgjakshme që u ba, lanë serbët përpara materialit luftarak të shumët, me mijëra të vramë, ndër të cilët dhe shumë oficera me grada të nalta. Më 1921, tre a katër muaj me radhë u qëndroj serbëve në malet e Lurës dhe nuk i la të rrasen brenda Shqipnisë. Me nji trimni e rezistencë të jashtëzakonshme dhe tue qendrue në shi e dëborë i përballoi serbët dhe nuk u hoq s'andejmi, deri sa u liruen kufijt e 1913-ës. Në këtë mënyrë Elezi i sherbeu Atdheut, për të cilin bani sakrifica të mëdha tue dhanë prova atdhedashunie.

Kur u vra Elezi bashkë me nipin, me të marrë këtë lajm, oficerët serbë që ndodheshin në qytetet të Dibrës së Madhe, për gëzim të kësaj, gostitën të gjithë ato që qenë prezent me çaj e ambëlsira etj. Shumë herë nga shqiptarë e të huaj i qenë propozue me mijëra napolona, por ai nuk ndërroi mendje, nuk e shiti ndërgjegjen dhe nuk e pezmatoi zemrën tue i vu vetes nji njollë të pashlyeshme. Deri në vdekje qendroi besnik i Atdheut e i idealit kombëtar.

Kur dergjesh i plagosun çova nji njeri për me e pyet mbi gjendjen shëndetësore. I thotë të birit, Cenit: "Falju me shëndet Ismail Strazimirit dhe thuej se afrimi i vdekjes e trubulloka njerin, por, në shpëtofsha kësaj radhe nga thonjtë e natyrës, nuk do të përzihem ma me njerëz, kam me u ba bari bagëtish".

Me këtë mënyrë më nepte me kuptue se vdekja që po i kërcënohej kësaj radhe e kishte shtye të mos marrë masa paraprake sikundër duhesh, mbasi ajo qenka urdhërue prej fatit. Veç kësaj, deshte me thanë: "Punova për Komb e Atdhe. Tue dasht që të mos i veçoj njerëzit në partizanë e në kundërshtarë u ndihmoi dhe ua mbrojti nderin dhe pasunin e tyne. Këta njerëz që unë u pata ba kaq nder me dhanë besën, por më tradhtuen. Prandaj, në shpëtofsha nuk do t'i baj ma kujt".

Edhe nipi i Elezit, Suf Xhelili, qe trim e i mençëm. Përmendesh për besën që kishte zakon me e mbajt. Dhe ky, si Elezi, ishte njeri me shtefni. Ky ishte i përvujt, gojambël, zemërbardhë, i pashëm dhe i hijshëm. Po të jetonte, ky mund të zinte vendin e Elezit.

***

Si hynë në Peshkopi fuqitë kryengritëse, Ahmet Zogu duel nga qyteti i Dibrës së Madhe dhe erdh në katundin Grevë, ku qendroi nji natë. Të nesërmen, don me thanë me 18 Tetuer 1924, erdh në Peshkopi, ku qendroi dy ditë.

Mbasi i plotësoi mungesat e nevojat dhe mbasi muer me vete edhe fuqinë e Kryeziut, që erdh nga Luma, u nisën për Mat, tue kalue nëpër katundin Selishtë. Në krye të javës që filloj kryengritja, Ahmet Zogu u fut në Tiranë.

Kur ishte Ahmet Zogu në Peshkopi shkova atje. Rrugës ndesha nja tridhjet a dyzet ushtarë të çveshun e të çarmatosun që kishin qenë në Peshkopi dhe tash me nga nji shkop në dorë po shkojshin nëpër shtëpijat e tyne.

Sosa në Peshkopi. Peshkopia ishte mbush plot me njerëz, dikujt i nepshin të holla dhe dikujt armë. Gjithë kjo përgatitje po bahesh për të rrëzue qeverinë që kishte pësue aq kobe. Kjo gja me bani përshtypje të madhe; më ngjau sikur i turren nji të sëmuri të mbushun me plagë.

Shkova për ngushullim ke djemtë e Elezit. Kur dola prej andej bante nji ftoftë i madh. Veç kësaj, nji mjegull e dendun dhe e zezë e kishte mbulue horizontin.

Ndërkohë, në rrugën e Trojakut pashë dy gra, nji plakë dhe nji e re që kishin hyp mbi kuaj dhe po udhëtojshin të pezmatueme e të trishtueme. Plaka ishte e ama e Riza Drinit, ish-nënprefekt i Lumës dhe tash i refugjuem n'Itali, e me e reja ishte bashkëshortja e tij fatkeqe që ishte martue me të dy muej ma parë. S'kishte marrë me vete veçse dy valixhe dhe kishin ikë të tmerrueme për me u struk në shtëpi t'Elez Jusufit, që të shpëtojshin shpirtin e nderin. Pamjet e Qenokut, e Peshkopisë dhe e Trojakut m'i rrënqethen edhe dejt' me t'imta të shpirtit e të zemrës dhe më plagosën randë.

Po të mos e kishte lanë Elez Jusufi punën në duer të prefektave, të komandantëve e të ministrave dhe po t'i hidhej në ballë, ashtu sikur kishte bamë edhe ma parë tue nisë nga veprimi i tij i zakonshëm; po të kishte ardhë me kohë në Lumë Bajram Curri; po të mos kishte tregue aq mizori e mahnitje Ali Riza Topalli; po të mos kishte tradhtue detyrën Qamil Kelqerja, Hamza Kuçi e Mujo Peja, në asnji mënyrë Ahmet Zogu nuk do mundesh të futesh në Shqipni nga ana e Dibrës. Sepse në këtë rast nuk do të mundesh me i tërheqë kah vetja gjithë ata dibranë që përbanë fuqinë e tij. Ose, po të sulmonte me përkrahjen e ushtrisë së rregullshme të Serbisë do të derdhesh gjak i madh dhe s'mund të kalonte në Dibër, por tue shkelë mbi kufomat e dibranëve që kishin me e bamë jetën fli.

Prandaj, me syrin tim, Elezi dënohet për paftësinë që tregoi prej dëshpërimit; Bajram Curri për plogështi që tregoi tue mos e çmue gjendjen; Ali Riza Topalli për qeverisjen e ligë e mizore dhe për mahnitjen e tij të pakufizueme q'arrinte deri në vdekje; Qamil Kelqerja, Hamza Kuçi e Mujo Peja për tradhtinë e naltë që banë tue abuzue detyrën e tue mos i qendrue besnikë të regjimit, të cilit i kishin dhanë besën e fjalën e nderit.

(Marrë nga libri me kujtime i Ismail Strazimirit me titull "Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë", botimet "Naimi". Botohet me shkurtime me rastin e përvjetorit të vrasjes së Elez Isufit, dhjetor 1924)

Historia e ngritjes së Muzeut "Vendorigjina e Kastriotëve" në Sinë

Nga **Besnik KËBEJ**

vijon nga numri i kaluar

Që në fillim e mori fjalën Prof.Stefanaqi, që mendueshëm dhe me një ton diskutimi përfundimtar tha:

"Dëgjo Aziz! Kemi diskutuar disa herë për këtë problem, për një muze të Kastriotëve. Tani ka ardhur koha të ndajmë mendjen dhe dhe të vendosim nëse do ta bëni muzeun në Sinë apo jo. Poqe se nuk e bëni, ta mbyllim ketë problem e ta lëmë farë këtë punë. Por unë mendoj se Dibrës i takon ta ketë këtë Muze".

Azizi u shpreh: "Unë kam ardhë bashkë me shefin e Arsimit dhe Kulturës, me mendjen që sot ta ndajmë këtë punë. Tani fjalën e ka shefi, se unë nuk kam gjë në dorë. Në këtë situatë të krijuar, duke patur parasysh diskutimet që ishin bërë me drejtuesit e rrethit në atë kohë, por edhe të mundësive që kishim ne si seksion, sidomos me Qendrën Ekonomike të Arsimit, që drejtohej me shumë passion e vendosmëri nga Shahin Kamberi, thashë: Ne do ta ndërtojmë Muzeun patjetër dhe do të organizojmë edhe sesionin shkencor me këtë rast. Me kaq takim, u kthyem në Peshkopi për të filluar punë.

Bashkë me drejtuesit e Kom.Ekz. të rrethit, Skënder Dema dje Avni Fida, drejtorin e Muzeut të rrethit Hysen Lala, përgjegjësin e Qendrës Ekonomike të Arsimit Shahin Kamberi, unë dhe Aziz Ndreu shkuam në Sinë. Këtu u takuam me drejtorin e shkollës Besnik Këbej dhe të gjithë bashkë u ndalëm në bahçen e Sefedin Priftit, ku nëna e tij, një malësore fisnike me veshje krahinore, na shërbeu me një kafe. Ishte një ditë e bukur shtatori, që akoma bari ishte i gjelbërt në baçen e Sefedinit. Nën hijen e pemëve u zhvillua biseda për muzeun e për Heroin tonë, Skënderbeun. U fol për toponimet, për tregimet popullore, për legjendat etj, që lidhen me lastriotët e Skënderbeun, material gojore që kishin mbledhur mësuesit e nxënësit e shkollës 8-vjeçare Sinë, ku drejtor ishte Besnik Këbej. Pastaj dolëm te problem i vendosjes së Muzeut.

Në këtë punë, kontributi ishte i gjithë punonjësve të seksionit të Arsimit, të shkollës 8-vjeçare të Sinës, si dhe e zotërinjve Aziz Ndreu, Shahin Kamberi, Besnik Këbej, Hysen Lala, Hysni Bruçi, Lefko Popa, Duro Ibrahimi, Fitim Sula, Hamdi Kaci, Flamur Sala dhe sidomos specialistët gurëgdhendës duarartë të Sinës që bënë të mundur realizimin e objektivit tonë. U ndërtua, por veprat e artit vonuan përurimin nga nëntori 1982 në nëntor 1985.

Për përurimin e Muzeut u bë një program pune dhe u ftuan për të marrë pjesë drejtues të Ministrisë Arsimit dhe Kulturës, historianë e vetëranë, mësues e punonjë të kulturës. Morën pjesë drejtues të rrethit Dibër, ish Presidenti Haxhi Lleshi, Tefta Cami – minister e Arsimit dhe Kulturës etj. Më 1 nëntor 1985, në Peshkopi me këtë rast u organizua sesioni shkencor me historian dibranë dhe punonjës të Institutit të Historisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Kumtesat e këtij sesioni shkencor argumentuan më tej me fakte historike orginën të Kastriotëve dhe se Kastriotët ishin banorë të Çidhnës, të Sinës. Në muze u paraqitën fakte historike, të mveshura me këto toponime e tregime, me gojëdhëna e objekte për Skënderbeun e Kastriotët. U evidentua orgjina e Kastriotëve që nga Pal Kastrioti, Gjoni e Gjergji (Skënderbeu). Aty në muze u pasqyrua thënia e Gjon Muzakës, bashkëkohës i Skënderbeut: *"Ta dini se gjyshi i zotit Skënderbe quhej Pal Kastrioti dhe nuk kishte në zotërim më shumë se dy fshatra, të quajtuara Sinja dhe Gardhi i Poshtëm dhe prej këtij lindi zoti Skënderbe"*.

Gjithashtu u pasqyrua periudha e Gjon Kastriotit dhe veçanërisht u videntua rinia e Skënderbeut, kryengritja e përgjithshme e vitit 1443, betejat e udhëhequra prej tij në truallin e Dibrës. Trajtesat e mbajtura në sesionin shkencor më 1 nëntor 1985 u arkivuan në Muze të rrethit Dibër, të cilat mund të jenë botuar në organe të ndryshme.

Ajo që nuk është publikuar e botuar deri tani është fjala e Prof.Stefanaq Pollos, mbajtuar në këtë sesion shkencor, pasi kumtesën kryesore e lexoi Selami Pulaha. Në mbyllje, me kërkesën e drejtuesve të rrethit, sidomos me të veteran



Foto © Bernard Zotaj

Haxhi Lleshi, që merrte pjesë në ketë sesion, e mori fjalën dhe Stefanaq Pollo.

Në organizimin e këtij aktiviteti nuk kishte manjetefon, që të inçizonte diskutimet, pasi Stefanaq Pollo nuk kishte përgatitur diskutim me shkrim, unë mbajta disa shënime rreth fjalës së tij. Më pas këto shënime i hodhi në letër me makinë shkrimi Ahmet Tomja, shënime që i mori nga blloku im, në të cilat shënohet: "Prof. Stefanaq Pollo në fjalën e tij përmbyllëse bëri vlerësime dhe konkluzione me shumë vlerë për origjinën e Kastriotëve e për historinë e Dibrës. Në fjalën e tij, ai tha:

Sesioni shkencor ia arriti qëllimit. Nuk është hera e parë që organizohen sesione të tilla për Skënderbeun dhe epokën e tij. U tha se këtu populli ka tradita, në të cilat Dibra zë vend nderi se jo vetëm se është vendi i origjinës së Kastriotëve, por dibranët kanë treguar heroizëm në këto beteja. Është interesant një libër që është shkruar nga një autor arbëresh, jo vetëm se flet për çlirim kombëtar, por jo rastësisht e fillon me Dibrën. Ne do të kthehemi e do rikthehemi disa herë te kjo figurë. Kësaj figure kaq të madhe i jemi borxh, se edhe një pjesë të dokumentave nuk i këmi në dorë, të cilat do bëjmë çmos që t'i kemi për të studiuar këtë përiudhë të shkëlqyer.

Rëndësia e këtij sesioni është edhe lokal, edhe kombëtar, se bëjmë fjalë për ngjarje shumë të rëndësishme të shekullit XV. Këtu mbështetet plotësisht me dokumenta se vendi i orgjinës së Kastriotëve është Sina. Këtu duhet thënë se dihet diskutimi i gjatë që është bërë se kush është vendi i Kastriotëve, Hasi apo Sina. Shoku Selami Pulaha në kumtesën e tij argumentoi përparësinë e Sinës si vendi i Kastriotëve.

Nuk është e çuditshme që për njerëz të mëdhenj secili të ketë pretendime. Psh, *serbët kanë thënë se populli shqiptar nuk ka histori dhe Skënderbeun e bënë sllav*. Kur festuam 500-vjetorin e Skënderbeut, ne menduam të hartonim një bibliografi dhe u kërkuam bibliotekave të vendeve të ndryshme të na dërgonin literaturën që dispononin. Këtë kërkesë ia dërguam dhe bibliotekës së Athinës. Ajo na u përgjigj: Çuditemi se si ndërmerrni një punë të tillë, kur dihet se është grek. Dibranët punuan mirë për këtë dhe atyre u erdhi në ndihmë shkenca. Tani mund të themi se orgjina e Kastriotëve është Çidhna, është Sina.

Problemi i dytë është problem i Torviollit. Për këtë betejë, dihet se në fillim u lokalizua në Domosdovë, por dy shokë dibranë, Aziz Ndreu dhe Ali Hoxha u munduan ta lokalizonin në Dibër. Mendoj se më bindëse janë argumentat për në Dibrën e Poshme.

Se kur do lëvizet pllaka nga Domosdova, këtë e vendosin organet e pushtetit, por pritet dhe fjala e historiografisë tonë, e cila nuk do mungojë të jepet. Rëndësi ka toponimia, e cila i vjen në ndihmë historisë dhe plotëson atë.

Desha ta mbyll këtë fjalë, me atë që dëgjuam nga Ali Hoxha për Çidhnën: Çidhna zë një vend të veçantë në luftërat për liri. Pyeta se a ka ndonjë pllakë për të përkujtuar, do të thosha atë holokaust, ku gjetën vdekjen aq shumë njerëz, por nuk mora përgjigje. Sigurisht që është mirë të ketë.

Falenderoj seksionin e Arsimit dhe Kulturës për ftesën që na bëri dhe dëshiroj të bëjmë dhe sesione të tjera në këtë vend ku luftoi Gjergj Kastrioti – Skënderbeu dhe trimat e tij".

Pas sesionit shkencor, më datën 02 Nëntor 1985, u përurua Muzeu i Kastriotëve në Sinë. Në këtë përurim morën pjesë shumë banorë të fshatrave të Çidhnës e zonave të tjera, nxënës të të gjitha shkollave të zonave përreth e të tjerë.

Jehona e përurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë në shtypin shqiptar

Në gazetën "Zëri i Popullit", në faqen e parë shkruhej:

U përurua Muzeu i vendlildjes së Kastriotëve

Dje (të shtunën), më 2 nëntor 1985 – B.K) në fshatin Sinë të rrethit të Dibrës u përurua Muzeu i vendlindjes së Kastriotëve. Në cermoninë e organizuar me këtë rast, merrnin pjesë qindra kooperativistë të zonave të Fushë-Çidhnës e Kastriotit, patrotë e veteranë, të rinj e të reja .... Merrnin pjesë edhe kuadro drejtuese të organeve të partisë e pushtetit në rreth etj. .....

Shiritin e përurimit e të Muzeut e preu ministrja e Arsimit dhe Kulturës Tefta Cami.

Pastaj pjesëmarrësit vizituan Muzeun. Me këtë rast Instituti i Historisë, në bashkëpunin me seksionin e Arsimit dhe Kulturës të rrethit Peshkopi, organizuan një sesion shkencor, ku u mbajtën disa kumtesa për origjinën e Skënderbeut dhe të Kastriotëve, si banorë të heshëm të Çidhnës. ... (ATSH)

Gazeta "Ushtima e Maleve", e shtunë, 2 Nëntor 1985

Në faqen e parë ndër të tjera shkruhet:

Sesion shkencor për orgjinën e Kastriotëve

Seksioni i Arsimit i rrethit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë, me rastin e përurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë, organizuan dje një sesion shkencor për origjinën e Kastriotëve. Merrnin pjesë mësues të historisë, bashkëpunëtorë të Muzeut të rrethit, kuadro etj. Mori pjesë anëtari i Komitetit Qendror të Partisë Haxhi Lleshi, ministre e Arsimit dhe Kulturës Tefta Cami, anëtari i Kom.Qendror të PPSH Jeshar Menxhelxhiu, sekretari i parë i Komitetit të Partisë të rrethit Faik Kopaçi, kryetari i Kom. Ekz. të rrethit Rakip Dançe, drejtori i Institutit të Historisë Stefanaq Polloetj.

Sesionin e hapi sekretari i Kom.Ekz. K.P. të rrethit Ndue Kola. Pastaj u mbajtë disa kumtesa. Kumtesën " Kastriotët banorë të Çidhnës", e mbajti studiuesi, Doktori i shkencave historike Selami Pulaha e më pas mbajtën kumtesa Haziz Ndreu, studiuesi i historisë Luan Malltezi, Malo Hashorva, Ali Hoxha etj. ....

Korespondent i "Ushtima e Maleve"

Mbresa mga përurimi i Muzeu të Kastriotëve,

6 nëntor 1985

Shkruan Mevlud Buci

.... Kur u bë përurimi i Muzeut të Kastriotëve, gjëmoi ajo kënga e rapsodit të mirënjohur të Sinës, Rakip Pashnjari:

O moj Sina e Dibrës Poshtme,
Djep i lashtë i Kastriotëve ...,
Rrahi shqipja krahët malit,
Linde Gjergjin e Gjon Dibranit...
....

Etapa e Pestë

Refleksion për fazën e pestë

Më takon të theksoj se pas përurimit, vizitave në muze, shumica e pjesëmarrësve në orët e pasdites u shpërndanë, por mbetën shumë njerëz në Sinë. Aty qëndruan miqtë e ardhur nga Tirana dhe nga Peshkopia, të cilët shkuan në shtëpinë e Sefedindhe Shefki Priftit. Disa të tjerë te Sali dhe Shaban Tafa, të Besnik, Shaqir dhe Emin Kaloshi. Këto të fundit kishin miqtë e tyre nga larg. Disa shkuan edhe Në Sinë të Epërme. Pra, Sinjarët pritën me bujari miq e dashamirës të Muzeut, ashtu siç është zakoni 'darka kur hy në shtëpi të re'.

Këtu mbaron faza e pestë dhe fillon e gjashta

Ngjarjet e Marsit 1997

Shpërbërja e shtetit solli edhe në Sinë shkatërrime të shumta. Ndër objektet që pësoi dëmë ishte edhe Muzeu. Muzeu, ky objekt i rëndësishëm që u ngrit me shum mund e sakrifica u dëmtua nga keqbërësit, u vodhën objekte muzeale me vlerë e mbi të gjitha u muar blloku i përshtypjeve, me mendime e vlerësime nga vizitorët gjatë një periudhe mbi 12-vjeçare.

Në 550 vjetorin e Skënderbeut, viti 2018, u gëzova jo vetëm unë, por gjithë dashamitësit e këtij muzeu, që u rrethua dhe u zbukurua, për t'u pajisur e plotësuar më vonë me materialet e nevojshme. Kam besim se do të riparohet e do pajiset brenda me ato çka i takon. Edhe historianët e këtyre anëve do të punojnë më shumë, për të gjetur dhe botuar materiale dokumentare për të përforcuar mendimin se *'Kastriotët kur u fuqizuan, dolën nga Sina dhe ngritën fshatin e tyre, që mori emrin Kastriot'*. Dihet se Kastrioti është në kryqëzimin e rrugëve të rëndësishme të vendit.

* * *

Është në nderin e dibranëve, por edhe të Akademisë së Shkencave të RSH, të Institutit të Historisë, të organeve të pushtetit në qendër e veçanërisht në rrethin e Dibrës, që ta pasurojnë muzeun me objekte e dokumente, të paktën aq sa kishte para 1990-ës. Tashmë mundësitë janë për ta pasuruar më shumë, pasi mund të kërkohen dokumente jashtë vendit, sidomos në dokumentat e Turqisë e Romës, ku mendohet se ka shumë të dhëna për Dibrën e Dibranët.

Gjithashtu, Drejtoria Arsimore në Peshkopi duhet të gjejë kuadrin e duhur që të punojë në ketë institucion me cilësi të veçanta. Për sinjanët muzeu duhet të konsiderohet si vend i shenjtë.

KONKLUZIONE

(Në vend të Përmbylljes)

Territori Muhur-Sinjë është territori që plotëson dhe përputhet me dokumente, me pozicionin gjeostrategjik, me toponiminë, me arkeologjinë, se ky territor është territori më minimal që përmend Gj.Muzaka për gjyshin e Skënderbeut. Kemi sjellë dokumente dhe argumenta se gjyshi i Skënderbeut quhej Kastandin Mazrek Kastrioti dhe se ai ishte nga Mazreka e Epër në Muhur.

Kastriotët kanë lëvizur për jetë më të mirë nga Mazrekat në Sinjë dhe nga Sinja dolën në fshatin që formuan vetë në krahun e djathtë të Drinit të Zi, me emrin e tyre Kastriot, ashtu si shekuj më vonë fisi Alia i dha emrin fshatit Fushë-Alie.

Nëpër Muhur kalonte rruga kalorsiake me emrin Rruga Dibrane, kurse nëpër Sinjë kalonte Rruga Plakë. Në Muhur ndodhet qyteza e shekullit V-VI pas Krishtit; në Sinjë ndodhet ndoshta Kllezi dhe mes Sinjës dhe Muhurit qyteti i Trojës, që ka varre të shumta, ka ujin, ka dyqanet dhe pazaret, ka vendet fetare me emërtimet Popteshja e Madhe dhe Popteshja e Vogël.

Paraqitja e dokumentave për ekzistencën e Hasit në Fushë-Çidhën mbi lagjen Suli, pajton gjithë autorët e studiuesit, se Kastriotët ishin autoktonë në Dibër të Poshtme dhe me dibranët bashkë bënë histori, sa gjithë shqiptarët në çdo vend të Botës krenohen me Heroin tonë Gjergj Kastrioti – Skënderbeu.

cyan magenta yelloë black

Përfundimisht origjina dibrane e Kastriotëve është sanksionuar nga Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë më 1985 kur u inaugurua Muzeu historik i Kastriotëve në Sinë të Çidhnës, në Dibër të Poshtme.

Karakteri atdhetar i luftërave të Skënderbeut, themelues i shtetit të parë kombëtar shqiptar

Nga Ali HOXHA*

Skënderbeu nuk ka qenë as "Atlet i Krishtit" dhe nuk ka luftuar as për Krishtërimin, ashtu siç nuk ka luftuar as kundër Islamit. Skënderbeu ka qenë "atlet" vetëm i atdheut të vetë, sepse ai ka luftuar për të mbrojtur atdheun dhe shtetin e vet nga të gjithë armiqtë pushtues ngado që i vinin ata: si nga ata që i vinin nga Lindja islame, siç ishte ushtria e Perandorisë Osmane, ashtu edhe nga ata që i vinin nga Perëndimi i krishterë, siç ishte ushtria pushtuese veneciane.

Për Skënderbeun nuk mund të flitet e të shkruhet ndryshe, pëveçse kur është rasti për të bërë homazh për të, si në rastin tonë konkret në 550 vjetorin e ndarjes së tij nga kjo jetë, si dhe kur përmendja e emrit dhe e veprës së tij përdoret si shembull dhe model për t'u ndjekur nga brezat e sotëm dhe të ardhshëm, për frymëzimin dhe edukimin e tyre me dashurinë dhe sakrificën për atdheun.

Burrë shteti shqiptar, më i madhi i të gjitha kohërave është, pa dyshim, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, themeluesi i shtetit të parë kombëtar shqiptar.

Skënderbeu është emri më i nderuar, më i respektuar dhe më i dashur për gjithë shqiptarët, kudo që jetojnë dhe i tillë, ky emër do të jetë i nderuar për jetë të jetëve, sa kohë që do të ekzistojë në këtë botë kombi shqiptar dhe emri shqiptar, sepse emri i Skënderbeut është simboli numër një i kombit tonë; me emrin e tij lidhet krijimi i shtetit të parë kombëtar shqiptar, ndaj edhe flamuri i Skënderbeut është flamuri kombëtar shqiptar, i shtetit të Shqipërisë dhe i gjithë shqiptarëve në Kosovë, i atyre në trojet e veta në Maqedoni e në Mal të Zi, si dhe i atyre që jetojnë kudo, në diasporë.

Skënderbeu, gjenerali më i ri dhe më i lavdishëm i Perandorisë osmane, në kohën e vet, 575 vjet më parë, në nëntor të vitit 1443, i nxitur nga ndjenja e atdhedashurisë, për gjakun dhe truallin e të parëve të vet, thënë ndryshe, për ruajtjen e identitetit të vet, braktisi jetën luksoze, përrallore që bënte në oborrin e Sulltanit të superfuqisë më të madhe botërore të kohës së vet dhe, kur iu krijuan kushtet dhe rrethanat, në momentin e përshtatshëm për të, u kthye në Shqipëri, i shoqëruar nga 300 dibranë besnikë të tij ku, pasi çliroi, së pari, Dibrën dhe më pas Krujën, më 28 Nëntor 1443, në Kështjellën e Krujës valëviti i lirë Flamuri i Skënderbeut dhe i Principatës së Kastriotëve, Flamuri i Kuq me shkabën e zezë dy krenare, që më pas u bë flamuri kombëtar i gjithë Shqipërisë dhe i gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë. Më pas, në një kohë rekord, vetëm prej tre muajsh, Skënderbeu arriti bashkimin e të gjitha principatave shqiptare në Kuvendin ose Besëlidhjen e Lezhës, me 2 Mars 1444, ku Skënderbeu u zgjodh njëzëri kryekomandant i Përgjithshëm i ushtrisë së bashkuar kombëtare shqiptare, duke sanksionuar kështu de facto dhe de jure krijimin e shtetit të parë kombëtar shqiptar.

Emri i Skënderbeut u bë një simbol që e ka frymëzuar popullin shqiptar në të gjitha luftërat e tij qindra vjeçare kundër të gjithë pushtuesve të huaj. Në këtë aspekt edhe rilindasit shqiptar në të gjithë luftërat dhe përpjekjet e tyre për liri dhe pavarësi, jo vetëm që janë frymëzuar dhe udhëhequr nga emri dhe shembulli i Skënderbeut, por edhe shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, e ideuan dhe e realizuan më 28 Nëntor, pikërisht në të njëjtën datë, në të cilën e pat shpallur Skënderbeu për herë të parë në 1443. Ndaj një skenar filmi që ia kushtoi shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 Nëntor 1912, shkrimtari Ismail Kadare e ka quajtur me të drejtë, "Nëntori i dytë".

Edhe çlirimi i Shqipërisë prej pushtimit nazi-fashist në vitin 1944, u projektua dhe u realizua nga luftëtarët e lirisë pikërisht me 28 Nëntor, kur qeveria demokratike hyri në Tiranë, që të ishte në unison me dy 28 nëntorët e parë.

Për figurën e Skënderbeut, tash 600-vjet me radhë, shumë autorë, shqiptarë dhe të huaj, kanë shkruar shumë libra e studime të veçanta



Skënderbeu, si strateg e diplomat i madh, në luftën e tij atdhetare legjendare kundër superfuqisë më të madhe të kohës, ishte e natyrshme që duhej të kërkonte edhe aleatë të jashtëm. Në një kohë kur e gjithë Lindja islame ishte e pushtuar nga Perandoria osmane, ishte e natyrshme që Skënderbeu të kërkonte aleatë në Perëndim, duke shfrytëzuar rrethanat e kohës, konjukturat e kohës, por kjo nuk do të thotë aspak se Skënderbeu në veprimtarinë e tij të gjithanshme paska pas një "qëndrim të premë në favor të Perëndimit të krishterë..."

shkencore dhe artistike, shumë filma artistikë e dokumentarë janë bërë për të, shumë piktura e kompozime muzikore i janë kushtuar këtij kolosi, shumë përmendore janë ngritur për të, jo vetëm në trevat shqiptare, por edhe në sheshet qendore të shumë kryeqyteteve të shteteve të Europës dhe të Amerikës, pa u ndalur këtu në emrin e tij që u është vënë ndërmarrjeve dhe institucioneve të ndryshme si, shkollave, shesheve, rrugëve, skuadrave sportive, firmave ekonomike, prodhimeve industriale etj.

Nisur nga aspekte e qëllime të caktuara pragmatike, pse jo edhe politike, shumë autorë të ndryshëm, kryesisht të huaj, në shkrimet e tyre kanë bërë edhe spekulime të qëllimshme deri edhe në mohimin e origjinës shqiptare të Skënderbeut, deri në absurditet, me synimin për të vjedhur e përvetësuar edhe figurën e tij, duke e shpallur Skënderbeun dikush me origjinë serbe, apo dikush tjetër në grek. Ky spekulim e ka një shpjegim, pasi bëhet fjalë për atë periudhë të mesjetës kur sapo kishte filluar krijimi i shteteve të reja në ballkan dhe fqinjët shovinistë përpiqeshin të rrëmbënin sa më shumë jo vetëm nga trojet shqiptare, por mundoheshin që të përvetësonin edhe herojntë dhe historinë e shqiptarëve. Por, ajo që duhet të theksojmë këtu, është fakti se kohët e fundit kanë dalë edhe disa autorë të huaj si Shmidt-i etj, apo edhe ndonjë vendas, nënshtetas shqiptar por me gjak (origjinë) të përzier, të cilët për qëllime të caktuara pragmatike apo ndoshta edhe të nxitur nga qarqe të caktuara politike, nga brenda apo nga jashtë vendit, që me ndonjë libër të tyre kanë tentuar të denigrojnë figurën e Skënderbeut (siç është, p.sh. libri i B.Blushit). Por ajo që dua të nënvizoj këtu është se si kjo kategori, ashtu edhe ndonjë autor tjetër i asaj kategorie, të cilët, duke mos pas kulturën e mjaftueshme historike, apo thjesht për të bërë emër, kërkon të sjellë origjinën e Skënderbeut nga fshati i vet, e pse jo, mundohet ta identifikojë edhe me fisin e vet, më e pakta që mund të themi për ato kategori autorësh, është se ata janë të atillë që, edhe pse shkojnë me ndërgjegje kundër rrymës, kundër së vërtetës, mjafton që me këtë mënyrë ata t'i bëjnë publicitet emrit të vet, për të hyrë në bibliografi si autorë që kanë shkruar për Skënderbeun, pavarësisht se çfarë kanë thënë, dhe sa i shërbejnë së vërtetës ose jo, apo nëse i lexon ndokush apo jo.

Lidhur me sa më sipër se, për atë kategori autorësh që nuk kanë kulturën e mjaftueshme historike, përmend këtu, se Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ka botuar, qysh në vitin 1989, një përmbledhje studimesh nga autorë shqiptarë dhe të huaj, në tre vëllime, me titull "STUDIME PËR EPOKËN E SKËNDERBEUT", nga vëllimi i dytë i të cilit, theksoj këtu studimin e autorit nga Kosova, Flamur Hadri, me titull: "Historiografia shqiptare mbi personalitetin e Skënderbeut, origjinën dhe rininë e tij". Në të njëjtën kohë i kujtojmë lexuesit se lidhur me origjinën dhe jetën e Skënderbeut, materiale më të bollshme gjen në veprën e akademikut Kristo Frashëri, kushtuar jetës e veprës së Skënderbeut. (Tiranë 2002, fq.54-56, me titull "Nga ishin Kastriotët")

Por vula e të gjitha studimeve për origjinën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut është deklarata e Gjon Muzakës, bashkëkohës, bashkëluftëtar dhe mik (me krushqi) i Skënderbeut:

"Ta dini se gjyshi i Skënderbeut quhej Pal Kastrioti dhe se ai kishte në pronësi të tij vetëm dy katunde në Dibër të Poshtme, Sinën dhe Gardhin e Poshtëm."

Përfundimisht origjina dibrane e Kastriotëve është sanksionuar nga Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë më 1985 kur u inaugurua Muzeu historik i Kastriotëve në Sinë të Çidhnës, në Dibër të Poshtme.

Për çlirimin dhe mbrojtjen e atdheut të vet, Shqipërisë, Skënderbeu zhvilloi dhe drejtoi 30 beteja për 25 vjet me radhë, prej të cilave fitoi 29 beteja kundër ushtrive të Perandorisë osmane, superfuqisë më të madhe të asaj kohe, ndërsa humbi vetëm një betejë, por edhe këtë vetëm për shkak të tradhtisë nga brenda ("Tirana Observer", datë 11 janar 2008, f. 19).

Lidhur me vlerësimin e figurës së Skënderbeut, mjafton të përmendim vetëm një fragment nga kërkesa e dy senatorëve amerikanë, Dana Rohbracher dhe Tom Lantos, që paraqitën për një rezolutë në Kongresin amerikan të SHBA-së në shenjë nderimi dhe përkujtimi për 600 vjetorin e lindjes së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut: "Sipas gjeneralmajorit James ~olfe, komandanti i ushtrisë britanike në Kuebek, "Skënderbeu ua kalon të gjithë oficerëve të lashtë dhe të kohëve moderne, në drejtimin e një ushtrie të vogël ofensive" dhe ... Sipas historianit britanik, Eduard Gibon "Entuziazmi i kalorësisë dhe religjionit e kanë renditur princin shqiptar përkrah Aleksandrit të Madh dhe Pirros" (cituar sipas gazetës "Tema", dt. 4 nëntor 2005, f. 9).

Nisur nga fakti i pozicionit gjeografik të Shqipërisë, ashtu siç përcaktohet në rezolutën e lartpërmendur, me luftën e tij për liri, "populli shqiptar, nën udhëheqjen e Skënderbeut, parandaloi rënien e Romës dhe të Italisë në sundimin e Perandorisë otomane, duke i rihapur kështu rrugën Rilindjes-Renecencës italiane".

Por ajo që më nxiti të bëj këtë shkrim është fakti, se kanë tërhequr vëmendjen disa mendime të ndryshme të shprehura kohë më parë në shtypin e përditshëm lidhur me figurën e Skënderbeut, ku kanë bërë analiza subjektive, të cilat janë jo vetëm shumë larg të vërtetës historike, por të nisur nga qëllime të caktuara pragmatiste, apo për konjuktura të caktuara politike, kanë arritur aq larg, sa të mohojnë edhe karakterin atdhetar të luftës legjendare të Skënderbeut. Ata kanë shtrembëruar të vërtetën historike, sikur Skënderbeu, gjoja, paska luftuar për të mbrojtur krishterimin perëndimor, apo Skënderbeu ka qenë atlet i Krishtit etj. Pa dashur të hyjë në polemikë me askënd, po përmend shkrimin me titull "Orientimi katolik i luftës së Skënderbeut..." të Dr. Sami Repishtit, botuar në gazeta "Tema", të datës 21 nëntor 2005, f. 19, ku, ndër të tjera, shkruhet: "Figura poliedrike e Skënderbeut, sundimtar, diplomat, strateg ushtarak dhe mbrojtës i krishterimit perëndimor mbetet gjithherë epiqendër e krijimtarisë kombëtare shqiptare dhe personalitet qendror që bashkoi dhe vazhdon të bashkojë shqiptarët, brenda dhe jashtë Shqipërisë, pa dallim feje, krahine dhe ideologjie politike". Dhe, më tej, vazhdon: "I lindur në një vend si Shqipëria, kurdoherë një urë midis Lindjes dhe Perëndimit, veprimtaria e gjithanshme e Skënderbeut karakterizohet nga një marrje qëndrimi të premë në favor të njërës – Perëndimit të krishterë dhe kundër tjetrës – Lindjes Islamike, një qëndrim unik në atmosferën politike të Ballkanit në shek. XV".

Ky mendim, jo vetëm nuk shpreh aspak të vërtetën historike, pasi është një mendim thjesht subjektiv, në kundërshtim diametralisht të kundërt me realitetin historik, por është dhe krejt i pabesueshëm për cilindo lexues që ka, sadopak, njohje dhe kulturë historike. Është i papranueshëm se shtrembëron karakterin patriotik të luftës së Skënderbeut, kur thuhet "Orientimi katolik i luftës së Skënderbeut". Gjithkush e di se Skënderbeu nuk ka luftuar as për krishterimin perëndimor dhe as për Krishtin, pasi ai ka luftuar në radhë të parë, për lirinë e atdheut të vet me luftërat e tij kundër Perandorisë Osmane, pavarësisht se lufta e tij indirekt ka kontribuar edhe në mbrojtjen e Krishtërimit perëndimor, por kjo kurrsesi nuk do të thotë se lufta e Skënderbeut ka karakter fetar me orientim katolik. Autori i mendimeve të lartpërmendura bie në kontradiktë me vetveten, pasi në qoftë se Skënderbeu do të kishte luftuar për katolicizmin e për krishterimin perëndimor, atëherë ai kurrë nuk do të kishte pasur mbështetjen e përkrahjen e shumciës së popullsisë shqiptare myslimane dhe ortodokse, në gjallërinë e tij (dokumentet historike vërtetojnë se islamizmi i shqiptarëve, në disa treva arriti përmasa të mëdha qysh në kohën e Skënderbeut. "Atëherë, mbi 60 % e banorëve të Shkupit dhe të Manastirit ishin muslimanë" (cituar sipas Kasem Biçokut, në "Tema", datë 2 mars 2005, f. 9), po ashtu dhe pas vdekjes së tij, ithtarët e tij, myslimanë, nuk do ta ngrinin aq lart siç bënë Rilindasit tanë të ndritur Naim Frashëri, Hoxha Tahsim, etj., deri tek Haxhi Vehbi Dibra, ish-kryetar i Senatit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë që e shkëputi edhe KMSH nga Halifati i Stambollit etj.

Skënderbeu, si strateg e diplomat i madh, në luftën e tij atdhetare legjendare kundër superfuqisë më të madhe të kohës, ishte e natyrshme që duhej të kërkonte edhe aleatë të jashtëm. Në një kohë kur e gjithë Lindja islame ishte e pushtuar nga Perandoria osmane, ishte e natyrshme që Skënderbeu të kërkonte aleatë në Perëndim, duke shfrytëzuar rrethanat e kohës, konjukturat e kohës, por kjo nuk do të thotë aspak se Skënderbeu në veprimtarinë e tij të gjithanshme paska pas një "qëndrim të premë në favor të Perëndimit të krishterë...", pasi, siç do të theksojmë më poshtë, ai ka luftuar dhe kundër Perëndimit të krishterë. Lidhur me kërkimin e aleatëve në Perëndim nga ana e Skënderbeut, kjo nuk do të thotë aspak se Skënderbeu, luftës së tij çlirimtare e mbrojtëse të atdheut të vet, i paska dhënë karakter katolik. Për analogji mjafton të kujtojmë një moment historik të ditëve tona kur, në vitet 1990-91, ish-Presidenti Ramiz Alia, me emër mysliman por me bindje ateiste, edhe pse në atë kohë ishte në fuqi Kushtetuta e vitit 1976, kur shteti shqiptar ishte i sanksionuar si i vetmi shtet ateist në botë dhe me ligj ndalohej ushtrimi i fesë në Shqipëri, i imponuar nga rrethanat e kohës, u detyrua që të lidhte marrëdhënie diplomatike me shtetin e Vatikanit.

vijon në numrin e ardhshëm

Rruga e Arbërit nr. 152
histori

Në mesin e shekullit XX, filluan disa përpjekje serioze për ndriçimin e historisë së Kastriotëve dhe të Heroit tonë Kombëtar, deri në vitin 1443. I pari ishte Fan Noli, i ndjekur nga Profesor Aleks Buda, Profesor Kristo Frashëri...

Origjina *dhe vendlindja* **e Skënderbeut**

Nga **Bardhyl HOXHA***

Si për çdo figurë të madhe historike, ashtu edhe për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, historia botërore është interesuar të ketë sa më tepër njohuri edhe për jetën personale dhe shoqërore të heroit, para se ai të vihej në krye të luftës legjendare, me qëllim që nëpërmjet tyre, të ndriçojë sadopak formimin e tij shoqëror, politik dhe ushtarak, që kanë ndikuar të shquhej në mënyrë të mahnitshme gjatë epopesë së tij të shkëlqyer në shek. XV.

Vepra e madhërishme historike e Skënderbeut dhe origjina shqiptare e tij, kanë rëndësi të jashtëzakonshme për kombin shqiptar dhe lartësimin e identitetit tonë kombëtar, por gjithsesi, mospërcaktimi ende i origjinës krahinore të Kastriotëve dhe i vendlindjes së Skënderbeut (zyrtarisht), krijojnë një boshllëk të pajustifikueshëm në historinë tonë kombëtare. Për qindra vjet me radhë, burimi kryesor që pati në dorë historiografia botërore për të njohur origjinën, familjen, rininë dhe veprimtarinë e Skënderbeut deri në vitin 1443, ka qenë vepra e Marin Barletit.

Studimet e mëvonshme dhe dalja në dritë e disa dokumenteve të epokës Skërderbegiane, veçanërisht argumentimi shkencor i Profesor Kristo Frasheri, i cili përveç të tjerave, ka shkelë me këmbë çdo pëllëmbë të Çidhnës që lidhen me Kastriotet, krijojnë logjikën historike dhe mbështetjen burimore të besueshme se Çidhna, është origjina e Kastriotëve. Zgjedhja e Dibrës si mbështetje për realizimin e Strategjisë së tij, si dhe pritja shumë e përzemërt dhe mbështetja e pa diskutueshme që i ofrojnë dibranët Skënderbeut, janë tregues të lidhjeve të gjakut me dibranët. Në vitin 1985, krahina e Çidhnës është përcaktuar nga historianët si qendra e Principatës së Kastriotëve dhe vendlindja e heroit kombëtar të shqiptarëve Gjergj Kastriot Skënderbeut, e cila u shoqërua me ndërtimin e Muzeut të Kastriotëve, në fshatin Sinë, në largësi 20 kilometra nga qyteti i Peshkopisë. Vepra e Marin Barletit, për disa shekuj, ka qenë referenca bazë e historiografisë në lidhje me familjen Kastrioti dhe jetën e Skënderbeut nga lindja deri në vitin 1443, kur mori luftën çlirimtare kundër pushtimin osman. Edhe pse të cekëta, veçanërisht për rininë e heroit, kanë qenë më të pasura, krahasuar me informacione të shkëputura dhe ta paplota, që përmbanin burimet e tjera letrare deri në gjysmën e dytë të shek. XIX. Madje, edhe kur gjendej ndonjë burim, informacioni i të cilit nuk pajtohej në ndonjë pikë me veprën e Barletit, historianët e ndryshëm vazhduan ta pranonin tregimin e humanistit shkodran, si më të besueshëm se sa burimet e tjera letrare.

Sipas M. Barleti, deri më 1443, Kastriotët qenë një familje fisnike nga krahina e Ematit (Aemathia), emër me të cilin studiuesit e ndryshëm nënkuptonin krahinën e Matit. Më tej, ai përshkruan historinë e Kastriotëve në gjysmën e parë të shekullit të XV, përfshirë historinë e djemëve të Gjon Kastriotit, veçanërisht të Gjergjit, deri në arratisjen e tij nga ushtria osmane dhe shpalljen e kryengritjes kundër Sulltanit. Tregimi i Barletit për pjesën e parë të jetës së heroit sundoi në vija të përgjithshme në hsitoriografinë shqiptare dhe botërore deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Aférsisht në këtë mënyrë e përshkruan këtë pjesë të jetës së Skënderbeut, edhe historiani tjetër shqiptar, Dhimitër Frangu, bashkëkohës i Skënderbeut dhe i Barletit.

Megjithatë, pati edhe historianë të cilët nuk u treguan shumë entuziastë për mënyrën romantike me të cilën, humanisti shkodran, i ka përshkruar këto ngjarje. Kështu që në shekullin e XIX, V. Markushevi, K. Jireçeku dhe P. Pisani vunë re se tregimi i M. Barletit nuk pajtohej me disa dokumenta, të cilët filluan të shfaqeshin më vonë.

Në mesin e shekullit XX, filluan disa përpjekje serioze për ndriçimin e historisë së Kastriotëve dhe të Heroit tonë Kombëtar, deri në vitin 1443. I pari ishte Fan Noli, i ndjekur nga Profesor Aleks Buda, Profesor Kristo Frashëri, Profesor Kasem Biçoku etj., përfshirë disa studiues dhe historianë dibranë.

Në vitin 1967, Profesor Frashëri hedh dritë mbi pjesën shumë të errët të jetës së Skënderbeut gjatë viteve 30 të shek. XV dhe në pragun e kryengritjes çlirimtare të vitit 1443. Krahas burimeve të kancelarive dhe kronikave të ndryshme, lindore e perëndimore, një vend të rëndësishëm në këtë studim zë analiza që ai i bën letrës së një funksionari osman të këtyre viteve të sapozbuluara në arkivat e Stambollit, me nr. 6665 dhe veprës së kronistit osman, Idriz Bitlisit, gjithashtu i pashfrytëzuar deri atëherë nga historiografia botërore për Skënderbeun.

KASTRIOTËT DHE SKËNDERBEU DERI NË VITIN 1443

Fan Noli, ishte studiuesi i parë që analizoi me sy kritik të gjithë veprën e Barletit dhe propozoi një variant të ri mbi jetën e heroit deri në vitin 1443. Në disertacionin e tij të vitit 1947, në kapitullin "Fillime legjendare", Noli u tregua shume kritik ndaj veprës së Barletit. Sikurse ka vënë në dukje Profesor Frashëri, Fan Noli solli tre lloj argumente: logjikën historike, kontradiktat e Barletit dhe të dhënat dokumentare. Është e pamundur të besohet, thotë F. Noli, që një djalë i vogël 9-vjeçar, që u dërgua në një shkollë ushtarake pranë një pallati perandorak, që shërbeu më tej, për shumë kohë si komandant i shquar në radhët e ushtrisë osmane dhe që qëndroi për 29 vjet me radhë larg atdheut, prindërve, bashkëatdhetarëve, të kthehej në mënyrë të papritur në Shqipëri, si një nga çlirimtarët më të devotshëm dhe organizatorët më të talentuar të luftës çlirimtare që ka njohur mesjeta. Po ashtu, Barleti thotë se Skënderbeu u kthye në Shqipëri më 1443, pasi qëndroi larg atdheut 29 vjet me radhë, por nga ana tjetër, në dy raste të veprës së tij, Ai le të kuptohet se heroi u kthye në atdheun e vet qysh më 1438.

Po ashtu, disa të dhëna dokumentare, i japin argumenta Fan Nolit ta kritikojë veprën e Barletit, sipas tëve vëllezërit e Skënderbeut nuk u helmuan nga Sulltani, mbasi njëri prej tyre, Stanishi, ishte gjallë në vitin 1445, ndërsa tjetri, Reposhi, ka vdekur qetësisht në një manastir të krishterë më 1431. Më tej, Noli sjell dëshminë e një bashkëkohësi italian të Skënderbeut, G. Pontano, i cili pohon se heroi vajti peng te Sulltani kur ishte djalë i rritur. Për të gjetur vitin se kur vajti peng, F. Noli shfrytëzon dy aktet e zbuluara në manastirin e Hilandarit qysh në vitin 1848, nga të cilët njëri tregon se Gjon Kastrioti me të tre djemtë e tij, Reposhin, Kostandinin dhe Gjergjin blenë më 1426 një pirg nga manastiri i përmendur që ndodhet në Malin e Shenjtë, kurse tjetri përmend faktin se Gjon Kastrioti bashke me të katër djemtë e tij, Stanishin, Reposhin, Kostandinin dhe Gjergjin i dhuruan po atë vit dy fshatra, Radostushën dhe Trebishtin, po këtij manastiri. Kjo vërteton, thotë F. Noli, se deri më 1426, pra deri sa u bë 21 vjeç, Skënderbeu ndodhej pranë të atit, në Shqipëri, përndryshe emri i tij nuk do të mund të figuronte në dy aktet e Hilandarit.

Sipas pikëpamjes së F.Nolit, Skënderbeu duhet të jetë dorëzuar peng në vitin 1430, sepse atëherë Gjon Kastrioti u mund prej sulltan Muratit II. Ai gjen mbështetje, për këtë fakt, te historiani francez i shekullit XVII, H. Spondanus, i cili duke trajtuar ngjarjet e kësaj periudhe, ka pohuar se Gjergj Kastrioti u dorëzua peng më 1431, pra kur ai ishte rreth 26 vjeç. Madje, F. Noli ngul këmbë se edhe pas kësaj date, Skënderbeu nuk ka qëndruar vazhdimisht larg Shqipërisë. Ai largohej nga shtëpia e vet vetëm për të marrë pjesë në fushatat ushtarake që ndërmerrte sulltani kundër shteteteve të tjera. Pas përfundimit të tyre, Skënderbeu kthehej në Shqipëri, pranë familjes dhe bashkëatdhetarëve të vet.

Prandaj, përfundon F. Noli, heroi nuk ka pasur nevojë të ikte fshehurazi nga mjedisi turk, pasi ai ndodhej në Shqipëri. Për të provuar praninë e tij në Shqipëri dhe përgatitjet e tij për kthesën e vitit 1443, F. Noli përmend dy dokumente që shpallin Skënderbeun dhe Stanishin qytetarë nderi të Venedikut më 1438 dhe të Raguzës më 1439. Historiografia shqiptare nuk u pajtua plotësisht me trajtesën e Fan Nolit, duke vënë në dukje dy çështje: e para, rrëzimi i tregimit tradicional të Barletit dhe e dyta zëvendësimi i këtij tregimi me Punimin e Nolit. Rrëzimi i të parit nuk vërteton medoemos saktësinë e të dytit. Prandaj historianët shqiptarë të ditëve tona i morën në shqyrtim me objektivitet shkencor të dyja këto aspekte të problemit për të provuar më parë se çfarë të vërtete ka në tregimin e Barletit dhe sa i qëndron kritikës. varianti i ri i Nolit. Profesor Aleks Buda, në vitin 1951, botoi një punim shkencor me objekt disertacionin e Nolit, ku analizoi me sy kritik të dy autorët: Barletin dhe Nolin. Edhe Profesor Buda, pranon mundësinë që Skënderbeu të jetë kthyer në Shqipëri me lejen e sulltanit pak kohë para luftës hungarezo-osmane dhe që këtej të ketë shkuar në betejën e Nishit, prej nga ai u arratis për të filluar kryengritjen çlirimtare të vitit 1443. "Fakti që burimet perëndimore – shkruan ai – heshtin për kthimin e parë në Shqipëri si vasal i sulltanit dhe përmendin vetëm kthimin e dytë nga Nishi si kryengritës, mund të shpjegohet sepse të dy ngjarjet kanë qenë afër njëra-tjetrës, saqë në kujtimin e biografëve u bënë një". Sidoqoftë, përfundon A. Buda, "një vit më vonë ose më përpara, ky mbetet gjithmonë një kthim nga oborri i sulltanit kur Skënderbeu pat kaluar rininë e tij, gjë që Noli e mohon plotësisht".

Tre vjet pas kritikës së A. Budës, historiani turk N. Inalçik botoi defterin mufasal të sanxhakut të Shqipërisë/sancak-i Arvanid/, hartuar nga administrata osmane në vitet 1431-1432, ku figurojnë tri shënime që tregojnë se në vitin 1438 Skënderbeu ndodhej në Shqipëri dhe shërbente në sistemin feudal-ushtarak të kazasë së Krujës. Ky fakt i ri së bashku me indikacionet e njohura më parë, u pasqyrua në Volumin e I të "Historisë së Shqipërisë", botim i Universitetit të Tiranës më 1959, ku periudha e parë e jetës së Skënderbeut, trajtohet në një këndvështrim të ri dhe veçanërisht në pranimin e faktit që Skënderbeu merret peng në moshën 18 vjeçare dhe jo 9-vjeçare, kur Murati II pushtoi pjesën më të madhe të Shqipërisë.

Në vitin 1967, Profesor Frashëri hedh dritë mbi pjesën shumë të errët të jetës së Skënderbeut gjatë viteve 30 të shek. XV dhe në pragun e kryengritjes çlirimtare të vitit 1443. Krahas burimeve të kancelarive dhe kronikave të ndryshme, lindore e perëndimore, një vend të rëndësishëm në këtë studim zë analiza që ai i bën letrës së një funksionari osman të këtyre viteve të sapozbuluara në arkivat e Stambollit, me nr. 6665 dhe veprës së kronistit osman, Idriz Bitlisit, gjithashtu i pashfrytëzuar deri atëherë nga historiografia botërore për Skënderbeun. Nëpërmjet analizës së këtyre burimeve, K. Frashëri del në përfundimin se Gjon Kastrioti, pas dështimit të kryengritjes që ndërmori më 1430, e ruajti sundimin e vet vetëm në krahinën e Mesies, derisa vdiq në vitin 1437. Në këtë kohë Gjergj Kastrioti me emrin Skënder, por pa titullin "bej" gjendej në Shqipëri dhe ishte një spahi në zonën e Dibrës dhe se, më në fund, përpiqej, duke pasur edhe përkrahjen e banorëve misianë, që të zinte vendin e të atit, si sundimtar i Misies.

Duke shfrytëzuar të dhënat që japin tre historianë të vjetër osmanë, Saad-ed-Dini SollakZade, Munexhim Bashi, të cilët nga ana e tyre janë mbështetur te analistët osmanë të shek. XV, Profesor Frashëri pohon se pasi shfaqet më 1438 si subash i Krujës, emri i Skënderbeut zhduket për disa vjet nga burimet historike. Megjithatë, sipas tij, duhet të jetë emëruar rreth vitit 1440 sanxhakbej në krye të sanxhakut të Dibrës. Profesor Frashëri, si përfundim thekson "kthesa e madhe që ndodhi në Shqipëri në vitin 1443, nuk e nxori në mënyrë të befasishme Skënderbeun në skenën historike. Kjo logjikë e ngjarjeve, shpreh qartë parakushtet e suksesit të kryengritjes çlirimtare të vitit 1443, që ishin kontakti paraprak me popullin dhe përgatitja disa vjeçare e Skënderbeut, për kthesën historike të vitit 1443, përfshirë lidhjet me botën e jashtme. Skërderbeu njohu forcën dhe pulsin e bashkatdhetarëve, të njohën edhe talentin dhe urtësinë e Tij, përpara se t'i përvisheshin epopesë legjendare njëçerekshekullore".

KASTRIOTI, KASTRIOTËT DHE VENDLINDJA E SKËNDERBEUT

Historiografia e re shqiptare e gjeti të zgjidhur problemin e origjinës etnike të Kastriotëve dhe të Skënderbeut. Tezat absurde të pak historianëve të huaj të shek. XIX, të cilët pretendonin që heroi kombëtar i shqiptarëve ishte me kombësi sllave ose greke, qenë rrëzuar përfundimisht nga historiografia e paraluftës për Skënderbeun. Në asgjësimin përfundimtar të këtyre tezave fantaziste, patën dhënë një kontribut të veçantë historianët shqiptarë të periudhës midis dy luftëtarëve botërore, F. Noli dhe A. Gegaj, të cilët argumentuan me materiale të reja, origjinën shqiptare të Skënderbeut, të theksuar vazhdimisht nga Barleti. Vlen të theksohet se, vërtetimin e shqiptarësisë e ka bërë vetë Skënderbeu, në letrën që ai i drejtonte princit të Tarentit, Johan de Ursinit më 30 tetor 1460. Kështu, pas Luftës së Dytë Botërore, asnjë historian i huaj nuk e vuri më në dyshim origjinën shqiptare të heroit kombëtar të shek. XV. Përkundrazi, historiografia e re shqiptare e zgjeroi më tepër problematikën e historisë personale të Skënderbeut dhe kërkoi të zgjidhte edhe origjinën krahinore të Kastriotëve, madje edhe vendin ku lindi Skënderbeu. Qysh në fillim u duk se të dyja këto çështje të lidhura ngushtë midis tyre, paraqisnin vështirësi për një zgjidhje të kënaqshme, pasi të dhënat burimore që ekzistonin për origjinën krahinore të Kastriotëve, linin shteg për interpretime të ndryshme. Ndërsa për vendlindjen e Skënderbeut, nuk ekzistonin fare të dhëna dokumentare.

Ndërsa përsa i përket origjinës krahinore të Kastriotëve, kontradiktat kanë filluar që me pohimet e biografëve të vjetër shqiptarë të heroit. Për shembull, Barleti shkruante se "Kastriotët buronin nga një familje fisnike e Ematit (ex Aemathia)", të cilën historianët e identifikonin me krahinën e Matit. Ndërsa Gjon Muzaka, në veprën e tij "Breve Memoria" theksonte se gjyshi i Skënderbeut, Pal Kastrioti, zotëronte dy fshatra që ndodhen në rrethin e Dibrës: Sinën dhe Gardhin e Poshtëm. Pohimi i tretë vjen nga kronika raguziane e Pjetër Lukarit, i cili thotë se Kastriotët ishin nga "fshati Kastrat jo larg lumit Drin në krahinën e Hasit në Shqipëri".

Një tjetër historian shqiptar, A. Gegaj shprehej se Kastriotët ishin nga krahina e Hasit, kurse mbiemrin e tyre e kanë marrë nga pronat që kishin në fshatin Kastri të Mirditës.... Ndërsa Noli në "Historinë e Skënderbeut", të botuar më 1921, bie dakord me Barletin, se Kastriotët ishin nga krahina e Matit. Edhe për Profesor Budën, Kastriotët rridhnin nga fshati Kastrat i Hasit ..... Origjinën e Kastriotëve nga krahina e Hasit e pranuan edhe autorët e "Historisë së Shqipërisë" të vitit 1959. Në vitin 1959, Historiani dibran Hilmi Sadiku, në gjurmim të Hasit të Kukësit si origjine e Kastriotëve, në punimin e tij "Rreth tezes së Hasit si origjinë e Kastriotëve" botuar ne gazetën "Ushtima e Maleve" në qershor 1986, shpjegon se, pasi *ka kërkuar të vjelë të* dhëna gojore si legjenda dhe toponime nga tregimtare nga Hasi i Kukësit , si dhe studimeve të botimeve folklorike te fundit te shek XIX dhe fillimit te shek XX, përfshirë botimin e Institutit Folklorik, Tiranë 1967 "Tregime dhe këngë për Skënderbeun" shkruan se: **"***Është fakt se në traditat e Hasit të Kukësit nuk thuhej asnje legjende, toponim, apo e dhënë gojore, qe t'i përmendi Kastriotet, jo me te flase per origjinën e tyre nga kjo krahine"*.

Në vitin 1974, çështja e origjinës krahinore të Kastriotëve, u bë objekt i një studimi të veçantë të Profesor K. Frashëri, i cili për herë të parë edhe çështjen e vendit ku lindi Skënderbeu. Në artikullin e tij me titull "Nga ishin Kastriotët? Ku lindi Skënderbeu?", ai shtroi për diskutim dhe ballafaqim, të gjitha burimet arkivore dhe letrare, të cilave u shtoi edhe të dhënat toponimike që mblodhi në terren. Nga analiza e këtyre të dhënave, Profesor Frashëri del në përfundimin

Skënderbeu, ky hero i rrallë i luftës çlirimtare, kishte krijuar prej kohësh lidhje të ngushta, veçanërisht me vëllezërit e tij të gjakut, dibranët.



Një pikturë e bukur vaji në pëlhurë (55 x 40 cm) e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut nga Roberto Gammone. (Foto marrë nga profili ne FB i Micky Haxhiislami)

Pas këtyre hulumtimeve dokumentare dhe diskutimeve shkencore, mund të thuhet si përfundim se historiografia shqiptare e ditëve tona e ka dritësuar versionin që sundonte në historiografinë e mëparshme për Skënderbeun, për jetën dhe veprimtarinë e heroit deri në pragun e kryengritjes çlirimtare të vitit 1443. Sipas saj Kastriotët ishin një familje shqiptare nga Dibra e Poshtme. Emrin e tyre familjar ata e morën nga fshati Kastriot i krahinës së sotme të Çidhnës, i cili ndodhet pranë lumit Drin.

se, me emrin Has, kronika raguziane e Lukarit dhe koleksioni boshnjak i Fermexhinit, nuk kanë pasur parasysh krahinën e sotme të Kukësit, pasi kjo krahinë, deri në fund të shek. XVI quhej Pashtrik. Ata, sipas Profesor Frashëri, kanë patur parasysh një nga krahinat e rrethit të Dibrës, qendra e së cilës është Çidhna, e masakruar barbarisht nga sulltan Mehmeti II më 1466, në gjirin e së cilës ndodhen fshatrat Kastriot, Sinë dhe Gardhi i Poshtëm, që lidhen historikisht me familjen e Skënderbeut. Nuk është e rastit, thotë autori, që bashkëkohësi i heroit, R. Volaterrano, e quan të atin e Skënderbeut Gjon Dibra ose Gjon Dibrani. Më tej, Profesor Frashëri vë në dukje se nga defteri turk, i hartuar në vitin 1467, del se në fshatin Sinë, që një shekull më parë ishte zotërim feudal i Pal Kastriotit, banonte një familje me të njëjtin mbiemër, e cila ishte familja e Dhimitër Kastriotit. Kjo tregon se Kastriotët ishin vendosur prej kohësh në fshatin Sinë".

Sipas Fjalorit Enciklobedik Shqiptare, botim i Akademisë së Shkencave, Tirane 2008, ne fq. 1136 shkruan: *Kastrioti është vendbanim i lashte nga gjetjet ne Kodren e Gështenjës. Ne shek XIII ishte nen zotërim të Kastriotëve*. Nje informacion i tille i dërgon Kastriotët ne fshatin Kastriot me se një shekull para Pal Kastriotit, gjyshit te Skenderbeut, zotërues i Sines dhe Gardhit te Poshtem, i te parit Kastriotas qe permendet nga deshmite e kohes se tyre.

Por edhe pse ishin nga fshati Sinë, shkruan Profesor Frashëri, Kastriotët pronat e tyre i kishin poshtë në fushë. Pikërisht në mes të asaj fushe, pranë lumit Drin, rreth dy orë larg Sinës, ndodhet fshati Kastriot. Pra, Profesor Frashëri pajtohet, për nga emri me kronikën e Fermexhinit, dhe për nga pozicioni gjeografik, në raport me largësinë nga Drini, me kronikën e Lukarit. Në fshatin Kastriot gjendjen mjaft 25 toponime, si Kodra e Gështenjës, që vendasit e quajnë Kulla, ose Kalaja e Gjon Kastriotit, dhe më tej janë Porta e Kalasë, Kopështi i Gjonit, Bunari i Gjonit, Ogradja e Gjonit, Kishat, Kroi i Kastriotit, si dhe kaluerthi, Guri i Luftës, Kodra e Shamatës etj., që flasin per kete vend si banim i Gjon Kastriotit. Të gjitha këto të dhëna përfundon Profesor Frashëri, mbështesin traditën popullore dibrane, sipas së cilës Skënderbeu lindi në Shëngjergj (lagje e Sinës) dhe u rrit në Çelias (lagje e Kastriotit).

Duke ju referuar Defterit turk të vitit 1571, Profesor Kristo Frashëri në librin e tij "Skënderbeu, Jeta dhe Vepra" shkruan për dy troje ngjitur me njëri tjetrin: "Truallishtja e Gjonit" dhe "Truallishtja "Kuqka" (Kuka, K. F.). Për truallishten e Gjonit shkruan edhe humanisti Italian, bashkëkohes i Skënderbeut, Rafael Volaterano, në vitin 1506. Dhe në këtë vend me dy troja, janë respektivisht dy fshatra: Kastrioti dhe Kukajt, prane njeri tjetrit. Në atë periudhë këta fshatra kanë qenë në të djathtë të përroit të Kastriotit, për të cilën flet toponomia e pasur dhe objektet arkeologjike siperfaqësore.

Pas masakrës së Çidhnës, me 1 gusht 1466, rrjedhojë e dështimeve të Sulltan Mehmetit II për marrjen e Krujës, ushtria osmane i rrafshoi këto dy fshatra, pasi ishin vendbanim i Kastrioteve. Kjo është edhe arsyeja, pse këta dy fshatra nuk eksistojnë në defterin turk 1467. Pas disa viteve ndërpreje, rifillimi i jetës së këtyre dy fshatrave nisi mbi këto germadha, por fare pak më në jug, në të majtë të perroit të Kastriotit, pranë njeri tjetrin, ku janë edhe sot.

Nga fisi i Kuka kanë shërbyer në ushtrinë e Skenderbeut, si komandantë të shquar dhe shumë besnik: Pal, Pjetër, Rajan, Gjergj dhe Lekë Kuka. Pali ka rënë në betejën e Torviollit, kurse Gjergji është rjepur i gjalle në Anadoll, në prezencë të Sulltanit bashkë me shtatë komandantë të tjerë të zënë rob në betejën (fitorja e hidhur) e Vajkalit, Fushë-Bulqizë me 1456. Për këtë gjest kaq të urryer, në betejën e dytë të Vajkalit, një muaj më vonë, Skënderbeu e shpartalloi keqas ushtrinë turke. Pra siç vërehet në dokumente, janë dy truallishte, ku janë vendosur dy fshatra përkatësisht Kastrioti dhe Kukaj ngjitur me njeri tjetrie si dhe dy fise, Kastriotët dhe Kuket. Vlen të përmendet, thekson Studiuesi Koltraka, se marrëdhëniet midis banorëve të këtyre dy fshatrave janë të veçanta, jo si të jenë dy fshatra apo një fshat, por si një fis i vetëm. Po ashtu, deri vonë varrezat dhe institucionin fetar e kanë pasur të përbashkët. Një trashëgimni e tillë, e veçantë (ndryshe nga fshatrat tjerë), vazhdon që nga periudha e Kastriotëve.

Studiuesi Murat Koltraka, **n**ë shkrimin e tij "Ku është vendlindja e Skënderbeut?" i referohet një të dhëne tjetër, që daton më 18 tetor 1467, ku Gjoni i Aragones, informon nga Napoli, se një delegacion i dërguar prej Skënderbeut per bisedime me mbretin e Napolit, Ferdinantin, *përbehej nga katër vetë, tre prej të cilëve ishin dibrane* dhe pikërisht, Pjeter Kuka, Zaharia Gropa dhe Pal Maneshi. Dy të fundit kishin sfiduar kampionët e ushtrisë turke ne duelet provokuese para luftimeve ne dy betejat e Oranikut në Dibër, më 1448 dhe 1456, me lejen e Skenderbeut. Pali ishte nga Çidhna e Eperme (Gryke – Noka e sotme) dhe fisi i tij pasqyrohet në rregjistrat turk në vitet 1467 dhe 1602. Zaharia Gropa ishte nga Zerqani, pasardhës i gropajve të famshem, zotërues të Dibrës ne shek XIII-XIV. Ndërsa Pjeter Kuka ishte nga fshati Kukaj, fqinjë me Kastriotet. *Në fund të shkrimit të tij, Gjoni i Aragones, thekson se këta ishin të një gjaku me Skënderbeun*.

Origjinën dibrane të familjes Kastrioti e kundërshtoi K. Biçoku, i cili në një artikull polemik me punimin e Profesor Frashërit, të botuar në vitin 1974, i qëndron tezës së mëparshme të origjinës së tyre nga krahina e Hasit të Kukësit. Por argumentet e tij nuk u dukën bindëse, pasi të paktën dy autorë të tjerë shqiptarë, H. Ndreu dhe A. Hoxha e përforcuan tezën e origjinës dibrane së kastriotëve, duke sjellë argumente të tjera mjaft interesante.

Studiuesi Haziz Ndreu, në librin e tij "Kastriotët nga Trojet Arbërore", njohës i shquar i folklorit dhe tradites të kësaj zone, shkruan: "Që nga Dibra e Epër e deri në Lurë, të gjithë thonë se vendlindja e Skënderbeu është fshati Kastriot". Po në këtë libër, autori sjell një intervistë të vitit 1973, me Sulë Brugën nga Gurë-Lura, student në Stamboll, i cili pohon se: "Në një orë mësimi të historisë, në vitin 1906, në Stamboll, mësuesi i historise përmend emrin e Skënderbeut. Një student i një kombësie tjetër, e pyet profesorin, se ku kishte lindur Skënderbeu? Përgjigjia e profesorit ishte e shkurtër: "Skënderbeu ka lindur në Celias të Dibrës. Jam 83 vjeç, ka thënë Sulë Bruga, por edhe sot e kësaj dite, nuk e di në ç'vend bie Celiasi". Nërkohë që Celiasi i Dibrës, ishte një lagje e Kastriotit të Kastrioteve, në krahinën e Cidhnës në Dibrën e Poshtme. Gojëdhënat dhe materiali arkeologjik siperfaqesore, i pastudiuar deri tani, i shperdoruar nder vite, flasin se Katrioti perbehej nga dy lagje te medha. Njera ishte Troja, qe fillonte tek kishat ne jug-lindje te Kalase dhe me shtrirje drejte jugut arrinte ne Terzishte, qender zejtarie e tregetie ne ate periudhe, ku sot eshte shkolla e mesme "Gjergj Kastrioti, Skënderbeu", me pas vijonte drejte perendimit. Lagjia tjeter ishte Celiasi, nje territori mbi 16 ha qe fillonte tek kishat dhe me drejtim perendimin arrinte deri ne fshatin Bllice, te ciles i perkasin tere toponimet e paraqitura me siper. Ndokush mund te kete xhelozi per heroin tone kombetar, per bemat, famen, marredhenien qe ai ndertoi me kombin e tij dhe Evropen ushtarake e politike te kohes, duke u perpjekur ta ridimensionojne ate. Skenderbeu nuk iu ofrua historise si personazh i letersise, por historia dhe personaliteti i tij dominues ne epoken kur jetoi, te qenurit mbrojtes dhe jozaptues, te qenurit konseguent ne filozofine e lirise, te qenurit ne anen e drejte e bene ate lende per qindra e mijera libra qe u shkruajten per shekuj me rradhe. Ndonje mendje e roberuar, e pajisur me nje guxim regresist perpiqet sot te tjetersoje rolin e Skenderbeut ne historine tone apo historine e qyteterimit europian. Kjo eshte nje perpjekje e mjerueshme sepse historia nuk pranon leksione, ajo jep te tilla. Hipotezat e humbasin terrenin perballe fakteve; interpretimi kerkon moralitet te larte dhe profesionalizem. Dokumentat arkivore, vleresimet e bashkekohesve, si Papet e Romes apo familjet mbreterore me te cilet ai ishte ne aleance, ato te humanizmit dhe iluminizmit europian, tekstet e historigrafeve me ne ze te koherave, jane per ne nje burim i lirshem krenarie dhe sasi e bollshme informacioni per nje histori objektive te ketij burri qe u be shpirti i historise se mesjetes.

Mjafton te sjellim ndermend Volterin, qe nga katedrat e Parisit u kujtonte bashkekohesve se: "Neqoftese perandoret bizantine do kishin qene Skenderbege, perandoria e Lindjes do te ishte ruajtur".

PËRFUNDIME

Pas këtyre hulumtimeve dokumentare dhe diskutimeve shkencore, mund të thuhet si përfundim se historiografia shqiptare e ditëve tona e ka dritësuar versionin që sundonte në historiografinë e mëparshme për Skënderbeun, për jetën dhe veprimtarinë e heroit deri në pragun e kryengritjes çlirimtare të vitit 1443. Sipas saj Kastriotët ishin një familje shqiptare nga Dibra e Poshtme. Emrin e tyre familjar ata e morën nga fshati Kastriot i krahinës së sotme të Çidhnës, i cili ndodhet pranë lumit Drin.

Gjyshi i Skënderbeut ishte Pal Kastrioti, i cili gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV ishte një feudal i vogël – zot i Sinës dhe i Gardhit të Poshtëm, dy fshatra këto që ndodhen në malësinë i Çidhnës, në pjesën veriperëndimore të rrethit të Dibrës. Biri i tij, Gjon Kastrioti, e forcoi pozitën feudale që trashëgoi nga i ati. Ai e shtriu sundimin e vet në krahinën e Dibrës, pastaj në atë të Matit dhe më në fund, para vitit 1407, në viset bregdetare të Mises, midis Lezhës dhe Krujës. Gjatë kësaj periudhe duket se familja e Gjonit banonte herë në Sinë, herë në Kastriot. Pikërisht në lagjen Shëgjerth të fshatit Sinë lindi më 1405 Gjergj Kastrioti, i cili sipas traditës popullore u rrit në lagjen Çelias të fshatit Kastriot.

Gjergj Kastrioti, pasi mbaroi shkollën e içoglanëv, duhet të jetë kthyer përkohësisht në Shqipëri, pranë familjes në vitin 1426. Por më vonë, duke qenë bir vasali, në radhët e ushtrisë osmane, ai mori pjesë në fushatat ushtarake të Perandorisë Osmane. Në mes të viteve '30 ai shfaqet si spahi timari në rrethin e Dibrës dhe në vitin 1438 si subash i vilajetit të Krujës. Për hir të aftësive të tij ushtarake ai u bë sanxhakbej dhe, rreth vitit 1440, u vu në krye të sanxhakut të Dibrës. Ndërkohë, Skënderbeu gatoi projektin për të organizuar një kryengritje çlirimtare antiosmane. Duket se për këtë projekt, që do t'i sillte atdheut të vet lirinë, ai filloi të punonte të paktën qysh nga viti 1438, mbasi qysh nga ky vit e shohim të krijojë lidhje të fshehta me disa shtete të afërtra (me Venedikun, Raguzën, Napolin, Hungareinë) për t'i pasur si aleatë në luftën kundër pushtuesve osmanë.

Në vjeshtën e vitit 1443, kur filloi lufta hungaro-osmane, me urdhër të sulltanit, Skënderbeu u nis për në frontin e Nishit. Nisja e tij duhet të jetë bërë nga Dibra, ndryshe nuk kuptohet prania e 300 e ca shqiptarëve në repartin që isthe nën komandën e tij. Vazhdimi i ngjarjeve është i njohur. Sapo Janosh Huniadi filloi sulmin kundër ushtrisë osmane, Skënderbeu me repartin e vet e braktisi frontin dhe u nis me nxitim në drejtim të Shqipërisë, ku dha sinjalin e kryengritjes së përgjithshme çlirimtare. Gatishmëria që ai gjeti në masat popullore, tregon se Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, ky hero i rrallë i luftës çlirimtare, kishte krijuar prej kohësh lidhje të ngushta, veçanërisht me vëllezërit e tij të gjakut, dibranët.

LITERATURA

1. M. Barleti, Historia e Skënderbeut, Tiranë, 1967.
2. D. Franco, Commentario delle cose de 'Turchi e del Signor Giorgio Schanderbeg, Principe di Epyro, Venedik, 1545, f. 2-5.
3. V. Makusev, Istoriceskija Razyskanija o Slavjanah v Albanii v Srednie Veka, Warzawa, 1871.
4. C. Jirecek, Geschichte der Bulgaren, Praga, 1876.
5. P. Pisani, La Légende de Scanderbeg, Paris 1891.
6. F. S. Noli, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Prishtinë, 1968.
7. K. Frashëri, Gjergj Kastrioti Skënderbeu në pragun e kryengritjes çlirimtare t vitit 1443, në: "Studime historike", 91967), nr. 4, f. 209- 210.
8. J. J. Pontanus De Bello Napolitano, etj. vëll. II, Napoli, 1519.
9. V. Grigorovic Ocerk Ucennego Putesestvija po Europejskaj Turcii, Kazan, 1848.
10. H. Spondanus, Annales Ecclesiastici ab Anno MCXCVII ad Finem MDCXI V. vëll. II, Ticino 1680.
11. A. Buda, Fytyra e Skënderbeut në dritën e të dhënave të reja, në "Buletinin e Institutit të Shkencave", Tiranë 3-4 (1951).
12. H. Inalcik, 835 Hicri, suret-i defter-i isancak-i Arvanid, Ankara, 1954, timaret, nr. 314, 324, 335.
13. Historia e Shqipërisë, vëll. II, Tiranë, 1959.
14. K. Frashëri, Aktet e Hilandarit, në "Mësuesi", Tiranë, 28 korrik 1967 dhe 4 gusht 1967.
15. K. Biçoku, Mbi disa çështje lidhur me veprimtarinë e Gjergj Kastriotit Skënderbeut para vitit 1443, në "studime historike", 2, (1970).
16. F. S. Noli, Historia e Skënderbeut, Boston, 1921.
17. A. Gegaj, L'Albanie et l'invasion turque au 15e siécle, Paris 1937.
18. Ch. Hopf, Chroniques Gréco-romanes, etj. Berlin, 1871.
19. P. Luccari, Annali di Rausa, venezia, 1605.
20. F. S. Noli, Historia e Skënderbeut, Boston, 1921.
21. F. Noli, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Prishtinë, 1968.
22. Historia e Shqipërisë, vëll. I, Tiranë 1959.
23. K. Frashëri, Nga na ishin Kastriotët? KU lindi Skënderbeu? Në "Mësuesi", Tiranë, 1974, nr. 35 dhe 36.
24. K. Biçoku, rreth çështjes "Nga ishin Kastriotët", në "Mësuesi", Tiranë, nr. 49 dhe 50, 1974.
25. H. Ndreu, Toponimia në ndihmë të historisë së Kastriotëve, në "Mësuesi", Tiranë, nr. 15, 1975.
26. A. Hoxha, Mbi lokalizimin e fushës së betejës së Torviollit, në "Studime historike, 3", 1979, f. 241-242.

*** Gjeneral Brigade (R),**
Doktor i Shkencave Inxhinierike.

Kujtimit të Islam Çengës

Poetët nuk vdesin

Nga **Xhafer MARTINI**

Islami na iku dhe tani që nuk e kemi, kujtohemi për të me një ndiesi brenge në shpirt: sa pak ndejtëm me të, sa pak biseduam. Kur herë-herë e shikonim që kalonte pranë nesh, dëshira për ta ndaluar dhe për ta takuar, ishte e madhe, por duke mos dashur t'ia trembnim pëllumbat e mendimeve, e linim të shkonte, e linim për një radhë tjetër, siç e lash unë herën e fundit kur e pashë të hynte tek botuesi B. Karoshi. Hyri papritur, në fillim nuk e njoha: sëmundja e kishte shpërfytyruar aq shumë sa ai nuk ishte më Islami i parë, Islami që kisha njohur gjithë jetën. Ai më buzëqeshi. Nga buzëqeshja e njoha. Ajo nuk i kishte ndryshuar, veçse ishte bërë disi e mpirë. Islami sikur donte të më thoshte:

"Nuk më njohe? Jam Islami". Për disa çaste vazhduam të flasim në heshtje vetëm me sy:

"Më fal, Islam, por nuk të njoha, ti paske ndryshuar fare!"

"Kam bërë rrugë të gjatë, - më tha ai po me sy.- Jam takuar me Vdekjen. Jam i saj tani. Pothuaj kam ardhur me leje, me lejen e saj...".

"Ç'thua Islam?! Ku e lëmë ne vdekjen të të marrë ty në këtë moshë!".

Filozofët "optimistë" thonë se "njeriu me vdekjen nuk takohet kurrë, se, sa është ai, vdekja nuk ka ardhur dhe, kur vjen ajo, ai nuk është". Kur pashë Islamin atë ditë, nuk e pranova arsyetimin e tyre. Vdekja kishte ardhur tek Islami. Më i pranueshëm m'u duk mendimi tjetër për vdekjen: "Nuk vdesim vetëm atëherë kur vdesim fizikisht, ajo ka filluar gradualisht, shumë kohë më parë. Aftësi pas aftësie, interes pas interesi, mundësi pas mundësie:ne kemi filluar të shpërbëhemi, ndër kohë që jetojmë" (Martini: "Filozofia popullore", Tiranë 2017, f. 223) Islami dhe Vdekja atë ditë ishin bashkë. Ajo gjithnjë është tek ne, tek të gjithë, brenda nesh, por e fshehur. Tek Islami ishte bërë e dukshme. Kjo ishte një arsye më shumë që unë të këmbëngulja që të rrinim një copë herë bashkë, me nga një gotë raki përpara siç kishim ndenjur shumë herë, që nga vitet tetëdhjetë...

Por m'u duk se Islami nxitonte, atë ditë nuk ishte shumë i ngeshëm... Dhe unë e lash për një ditë tjetër...Po ditë tjetër nuk kishte pasë...

Tani Islami nuk është më. Ne jetojmë me brengën e heshtjes që nuk e dëgjojmë më zërin e tij. Por gjithnjë ka një ngushëllim: poetët nuk vdesin, ose vdesin përgjysmë,si mund të thuhet. U vdes vetëm trupi, por shpirtin e lënë tek të gjallët në formë vargjesh dhe librash poetikë. Madje kohët e fundit ishin poetët që i dilnin zot Islamit sa herë kur vdekja i hakërrohej dhe donte ta merrte. Por e gjente me dy nga më të mëdhejtë, me Nazim Hikmetin dhe Carlos Ernest Gracia. Atëherë ajo mendonte të mos ngutej shumë përderisa Islami rrinte vetë me të vdekur. Po ku ta dinte ajo se ata ishin të vdekur të pavdekshëm! Vdekja nuk ka pushtet mbi poetët.

Ja tani ne nuk kemi Islamin, por kemi librat e tij, madje unë kam në dorë librin e tij më të ri që fatkeqësisht është edhe libri i tij i fundit. Ka një titull shumë të bukur: "Shtëpia prej fjale", përmbajtja e të cilit pasqyrohet edhe në kopertinë. Po përse prej fjale? Asnjë shtëpi tjetër nuk të mbron, as edhe kështjella më e fortë që u ka rezistuar gjyleve të topave. Veç shtëpisë prej fjale nuk ka ç't'i bëj vdekja. Atë nuk e merr dot. Ja si shkruan poeti:


"Shtëpia ime e përhershme
në Qiellin e Shtatë
Vdekjen e lasha pas,
Poshtë tokësorët, si milingonat në lëkurë lisi,
Ngjiten,



Zbresin,
Përplasen,
Rrëzohen,
Ngrihen
Si një lukuni e pafund mbijetese".

Ky është një fragment nga vjersha e mrekullueshme "Paradise" që tregon se poeti ka ikur, nuk është më me ne dhe tani ai çuditet se si jemi ne tokësorët, sa ambicje dhe përplasje kemi, sa shumë shtyhemi dhe vritemi me njeri-tjetrin, sa të marrë tregohemi në këtë përleshje për të fituar më shumë tokë, më shumë hapësirë, më shumë pasuri, kur gjithçka është e kotë. Poetit që ka hipur në Qiellin e Shtatë ne i dukemi si milingonat në lëkurën e lisit...Çfarë përfytyrimi Shekspiran! Çfarë tmerri Dantesk! Unë gjithnjë kam thënë se Islami është poet, por tani po them se është poet i madh.

Budallallëkun e njerërzimit, marrëzinë e tij ai na e kujton me vjershën tjetër me të cilën hapet vëllimi: "Shtëpia prej fjale", që



Janë poezi që poeti i ka shkruar kur është takuar një herë me vdekjen kur ajo ka ardhur për ta marrë dhe poeti i ka kërkuar leje sa për ta përmbushur dëshirën që t'ua lërë njerëzve edhe një libër - amanetin e fundit.

po e japë të gjithën:

"...desha të ndërtoj një shtëpi tej e tej me xhama,
Por xhamat
u thyen nga cikma e borës
Që zbriti si shtriga nga malet.
Desha të ndërtoj një shtëpi prej lumi,
Por lumi u tha nga zhegu i verës
Dhe mbeti rëra me gurët e zallit.
Desha të ndërtoj një shtëpi prej fjale,
Por fjalët ikën dhe fletët u zverdhën
Në degën e vjeshtës së fundit.
Desha të ndërtoj një shtëpi me zogj,
Por zogjtë fluturuan në perëndimin e largët
Dhe harruan rrugën e kthimit.

... dhe ndërtova një shtëpi
Prej xhami,
Prej lumi,
Prej librash
Prej zogjsh

Një shtëpi prej fjale!

Kjo është një vjershë filozofike me përmbajtje të thellë, me mesazhe të rëndësishme për ne të gjallët, mesazhe që na i ka dërguar një njeri me mendje të fuqishme dhe me zemër të zjarrtë, në kohën që jetonte në atë "zonën gri", as në tokë as në qiell, si thotë populli , kur ai nuk ishte më toksor, por as qiellor, kur ai sapo rrihte krahët që të fitonte lartësinë për fluturim. Por shkëputja gjithnjë është e vështirë se toka ka rëndesën e vet, ka forcë tërheqëse. Pikërisht kur ishte në këtë zonë gri, kur stilolapsi mezi e rrinte në dorë, ai na dha mesazhin: o njerëz, mos u grindi dhe u kacafytni ashtu, mos u vrisni midis veti dhe mos ia bëni të zezë jetën njeri-tjetrit, sepse gjithçka është e rrënueshme, asgjë nuk është e sigurtë, e përjetshme. Nuk do t'i merrni me vete kullat, kështjellat, katedralet, vilat luksoze, veturat e markës së fundit, plazhet, asgjë e asaj bote nuk vlen sa vleni ju vetë. Por, mjerisht, as më i mençuri prej jush këtë nuk mund ta kuptojë pa ardhur këtu ku jam unë tani...Prandaj unë bëra këtë shtëpi prej fjale se brenda saj jam më i sigurtë se brenda një shtëpie me mure të trasha, brenda saj e di se do të jetoj më gjatë... Varet si i kam zgjedhur fjalët...

Ja, ky është mesazhi filozofik i Islamit. Unë, të paktën, kështu e kam kuptuar. Është mesazh për njeriun, është dashuri për njeriun, paralajmërim dhe këshillë për t'u bërë i mençur. Qiriu i Naimit na ndritte që të shihnim njwri-tjetrin, "qiriu " i Islamit na këshillon ta duam njwri-tjetrin. Islami u sos si qiriu që bën dritë!

Të vjen çudi që vjershat e Islamit vinë si plotësim i njwra-tjetrës në ide, në mesazhe. Islami na mëson se filozofikisht ka dy Botë, Bota e të Vdekurve dhe Bota e të Gjallëve. (Vjersha "Shpirti i gjyshit"). Të mençurit janë të vdekurit, na thotë Islami, se ata e kanë kaluar përvojën e jetës, përvojën e të gjallëve. Bota e gjallë, megjithëse shumë e shkurtër, u ka mësuar atyre shumë gjëra, mbi të gjitha u mësoi se ajo qe e marrëzishme, qesharake në një kuptim, marroqe, e padrejtë, pa humanizëm, ku njerëzit theren e vriten pa e ditur se çfarë i pret. Të vdekurit çuditen sa të marrë paskëshin qenë. Ata tani janë krejt ndryshe- të çliruar nga trupi, nga ai hamall i urryer që është burim i të gjitha ligësive: i epsheve, i etjeve, i sqimës, egoizmit, marrëzisë, pangopshmërisë, me dëshirat e tij të pafundme që nuk e kënaqin kurrë. Ata çuditen me atë që kanë qenë. Ata do të donin sinqerisht t'i lajmëronin tokësorët dhe t'i bindnin ata që të mos sillen ashtu si sillen dhe të mos veprojnë ashtu si veprojnë, ta mposhtin babëzinë e vet që u helmon jetën. Por si t'i lajmërojnë? Ata kanë shkuar tek nuk ka më kthim. Por mund t'i lajmërojnë me poetët që janë të vdekshmit e gjallë, me ata që nuk kanë për vdekur plotësisht, me ata që jetojnë në dy botë. Nëse nuk mësojnë as nga poetët, do të përplasen dy botët:

"U dynd Bota e të Vdekurve dhe drejt
Botës së të Gjallëve,
U përmbysën shtëpitë prej guri
Shtëpitë prej dheu të milingonave,
U thyen degët e mimozave.
Rrasat e mermerit, epitafet,
shkallët e betonit.
Dhanë shpirt: Prometeu, Eva,
Adami, Premti.
Keopsi,Homeri, Aleksandri, Napoleoni
Zapata, Buda, Konfuci, Krishti,
Muhamedi, Lenini, Linkolni...
U dynd Bota e Gjallë drejt Botës së Vdekur
Unë jam mes valësh në pritje
të betejës së fundit
Një varkë e harruar, por kurrë e braktisur..." (Nga vjersha: "Shpirti i gjyshit")

Shumë e bukur, vjershë antologjike, është edhe "Arroganca e vdekjes". Edhe kjo është vjershë filozofike. Trajtohet poetikisht dhe filozofikisht se ç'është vdekja. Që ajo nuk është e mirë, kjo dihet. Ajo nuk na merr për dore për të na çuar atje ku duhet të shkojmë siç marrim fëmijët për t'i çuar në kopsht. Ajo na shtyn, na përplas, na torturon, nganjëherë edhe na fyen. Ajo nuk ka një mënyrë për të na marrë, por një milionë mënyra. Disa janë shumë tronditëse. Ajo nuk na e bën këtë përse na urren, por kjo është natyra e saj. Vetëm rrallë Vdekja meriton të quhet mbretëreshë: kur na merr në gjumë, kur na merr pa na gjykuar fare. Por përgjithësisht është arrogante dhe Islami e ka provuar shpesh "arrogancën" e saj:

"Jo, nuk do të des!
As njeriu i zakonshëm nuk vdes kaq papritur
Aq më pak një poet
Që nuk e njeh arrogancën e vdekjes.
Tensioni, pehlivan
Në një tra humb ekuilibrin;
Kolisteroli plumbos dyer e deriçka damarësh
E kockat ziejnë në mjegull e në shi
Si kazan me bërsi rrushi.
Kurrë nuk kam dashur të shoh fotot e rinisë
Të mbyllura në një dosje jeshile
Para se të vija tek ti,
Para se të shkundej mani në kopsht,
para se të iknin dallëndyshet...
Ju them
Se asnjë njeri i zakonshëm nuk vdes
Kaq papritur,
Aq më pak një poet
Që nuk e njeh arrogancën e vdekjes".

Islami thotë se vdekja është brenda nesh, në trupin tonë, ne gdhihemi dhe ngrysemi me vdekjen, ne flejmë me vdekjen, ne hamë dhe



pimë me vdekjen, ne qeshim dhe qajmë me vdekjen, ajo është ne dhe ne jemi ajo. Kurthet na i ngre organizmi ynë që nuk punon ashtu si duhet dhe, më në fund, ngec. Vdekja, thotë poeti, nuk vjen, atë e kemi ne në organizmin tonë.Ajo është kudo, në çdo ind dhe kërkon të çara për të avancuara përpara për të pushtuar tërë organizmin. Vdekja, është, në një kuptim, si uji (por jo jetdhënëse si uji), që depërton në të çarën më të hollë. Tensioni e ndihmon duke egërsuar gjakun, gjaku e ndihmon duke vërshuar nëpër damarë dhe vena, por këto, të mbylluara nga kolisteroli pëlcasin nga vrullimi dhe derdhin gjakun aty ku nuk duhet. Plumbat e kolisterolit, thotë poeti, dëshmojnë që në organizmin tonë ka filluar lufta. Kur luftën e kemi brenda nesh, ç'budallallëk është të luftojmë edhe jashtë, thotë poeti, dy fronte nuk përballohen. Nuk ka mesazh më të lartë, por kur e thua poetikisht ka vlerë. Islami e thotë me poezi të vërtetë.

Në këtë vëllim, që u shkrua në pragun e vdekjes, vdekja përmendet shumë. Por në libër nuk ka pesimizëm. Poezia ka buruar prej një shpirti heroik që me fatkeqësinë e tij nuk ka dashur të bëjë fatkeq edhe të tjerët, përkundrazi, nga fatkeqësia e tij ka dashur dhe ia ka arritur, të mësojnë të tjerët. Kjo është fisnikëri poeti. Këtë nuk e kanë të gjithë njerëzit. Ne duhet ta falenderojmë dhe t'i jemi shumë mirënjohës Islamit që e kishte dhe na e dha fisnikërinë.

Në libër nuk ka urrejtje, përkundrazi, nuk ka libër që të jetë kundër urrejtjes si ky. Mos urreni, - ky është kryemesazhi. Në libër ka shumë dashuri, shumë mirësi. Në poezitë e Islamit ka shumë pëllumba, dallëndyshe, blerim, lumenj, kroje, lule, rreze dielli, shkëlqim ylberi, ngjyra... Është paradoksale kur e mendon që ky libër është shkruar në muzgun e jetës, ku dritat dhe ngjyrat e gjithçka e bukur dhe e praruar humbet. Ahmet Prençi, një tjetër poet i talentuar, me kujdesin direkt të të cilit na vjen në duar ky libër i fundit i Islamit, në një vjershë të tij dedikuar poetit , shkruan:

"Mijëra radhë ku munde i shkrove,
me frymëzim e muzë
Mbi një urë, ulur mbi një gur, në yje,
në tërfil,
E fjalën e keqe s'e nxore kurrë nga
të tuat buzë
Zakon poeti: fisnik, i bukur, zemërmirë".

(Vjersha "Islam Çengës").

Po, i tillë ishte Islami. Çlironte kurdoherë energji pozitive. Kur ishe me Islamin ndjeheshe disi i dashuruar me veten: Nuk ishte ajo ndiesia narciste por ajo lumturia që shprazej prej zemrës së tij dhe vinte në zemrën tënde.

Po jap poezinë pa titull që është më dëshmuesja e optimizmit të tij të jashtëzakonshëm:

"Mendo gjëra të bukura për nesër,
Jemi lodhur dhe plakur duke kujtuar të djeshmen,
E djeshmja që na vjen më e vogël në shtat.
Mendo për të nesërmen
Pa thyer pasqyrën
Pa thyer shpinën
Pa xhelozi
Se ndoshta do të ketë më shumë bukë
Më shumë liri,
Më shumë mirënjohje.
E djeshmja le të flejë në paqe
Pavarësisht nga krismat e armëve
Murit të rënë të shtëpisë në fshat
Dhe maces së plakur që zgjohet vonë.
E unë
sot nuk do të vdes
do të pres të nesërmen...

Ahmet Prençi e ka paraqitur librin me një parathënie shumë të bukur, njerëzore. Mjaftonte botimi i kësaj parathënie për ta kujtuar Islamin në faqet e gazetës sonë "Rruga e Arbërit", por mua nuk m'u ndejtë pa shkruar dy fjalë edhe vetë. Libri, lumturisht, ka shumë poezi, njëra më e bukur se tjera. Është mbase i vetmi libër që nuk ka poezi të dobëta. Edhe me tre vargje poeti shpreh tridhjetë mijë ndjenja:

"Unë mendoj
Se ka diçka më shumë njerëzore te kali,
Është heshtja."

Ja, kjo është poezia. Duket sikur nuk thotë asgjë, por thotë shumë, shumë. Poetët i kanë dashur shumë kuajt. Janë dy qenie fisnike.

Optimizmi nuk vdes edhe pse në shumë poezi trajtohet raporti i njeriut me vdekjen, raporti i të gjallëve me të vdekurit, jeta e Këtushme me jetën e Përtejme. Janë poezi që poeti i ka shkruar kur është takuar një herë me vdekjen kur ajo ka ardhur për ta marrë dhe poeti i ka kërkuar leje sa për ta përmbushur dëshirën që t'ua lërë njerëzve edhe një libër- amanetin e fundit. Dhe vdekja ia ka dhënë lejen. Vdekja e ka dhënë lejen, por ajo nuk e ka ndërruar natyrën e saj, i ka shkaktuar Islamit shumë dhimbje dhe pafuqi për të shkruar. Megjithëse ai shkroi, në atë pak kohë kur për të nuk ishte as ditë as natë, por muzg, kur dritat dhe ngjyrat humbasin, kur pamja bëhet e kufizuar dhe mendja bëhet e turbulluar, ai nuk i humbi as logjikën, as ndjenjën, as ngjyrat, dritat, asgjë. Doli fitimtar mbi vdekjen ani pse ajo, më në fund, e mori.

"Shtëpia prej fjale", me Islamin në prag!

Nga **Ahmet PRENÇI**

Të hënën, në ditën e pestë të Nëntorit 2018, në orën 12.53 minuta, poeti Islam Çenga ndërroi jetë! Pata fatin ta shoh edhe një herë, pak minuta para se të jepte frymën e fundit, ndërsa vështrimet tona kryqëzoheshin duke folur poetikisht, pa fjalë, pa lëvizje. Ai po bëhej gati për në mbretërinë e qiellit, ndërsa unë zbrita në sheshin para pallatit dhe, së bashku me Ben Hysenin qëndruam heshtur, derisa familjarët na sollën lajmin, që me mendje e prisnim, por me zemër e shtynim sa mundeshim;- Islami, na la! "Na la!". Pra, të gjithë e kuptuam se ai iku, si zogu që grihet nga dega dhe fluturon qiellit të pamasë.

Mësuesin tim të dashur, poetin e pashtershëm, mikun e çmuar s'do mundesha ta takoja më, përveçse në ëndrrat, kujtimet dhe në librat e tij.

Bisedën e fundit me Islamin e bëra të premten e datës 2 Nëntor, në mesditë, pranë krevatit të tij. Ishte i lodhur, krejt i tretur, "si një varg", siç thoshte ai, në njërën nga poezitë e tij. Atë ditë biseduam për amanetin, që më kishte lënë disa ditë më parë; botimin e librit e tij më të ri. Nuk e thamë as unë e as ai, por në fakt, të dy e ndjenim, se ai ishte libri i tij i fundit...

Gjatë sëmundjes së tij të gjatë, plot një vit e shtatë muaj, kishte botuar librin, "Dy pëllëmbë qiell", ku cikli i këtij vëllimi, "Vdekatari" ishte një paralajmërim i hidhur, për çdo mik e lexues të vëmendshëm. Islami kishte shkruar aty prologun e udhëtimit të tij pa kthim, një udhëtim qiellor, i gjatë e i përjetshëm.

Javët e fundit, sa herë takoheshim, e shihja se nuk i ndante nga dora poezitë e poetit turk Nazim Hikmet dhe librin e poetit të dashur latin, Carlos Ernesto Garcia. Tek kafe "Aroma", pranë shtëpisë së tij, ku unë gati çdo dite do shkoja e ta takoja, e gjeja teksa merrej një ditë me njërin autor e një ditë me tjetrin. Këto ishin dy librat e fundit, me të cilët u nda Islami nga kjo botë, që do të thotë se ishin edhe librat më të dashur për të në atë periudhë. Ishte njëra nga këto ditë, kur krejt papritur, më tha se kishte gati një vëllim të ri me poezi. U befasova, pasi nuk e mendoja se ai kishte patur forcë të shkruante më, ndërkohë që as laptopin nuk e hapte prej kohësh. "Gjithë jeta ime është një udhëtim dhe i vetmi vend familjar, ku kthehem gjithnjë, është sëmundja ime!", pati thënë Niçja. Dhe këta 19 muaj të Lames, ishin si të Niçes së sëmurë", - mendova në ato çaste!

-Janë poezi të hershme këto? - e pyeta, duke menduar se kishte gërmuar në sënduqe, ku mund të kishte arkivuar poezi të shkruara në kohë të ndryshme dhe tani donte t'u jepte frymën e tij të fundit.

-Jo, jo! Janë poezi të shkruara tani!

Pushoi pak, mori frymë thellë dhe vazhdoi: Shkak për t'i shkruar këto poezi u bë biseda, që bëmë dy muaj më parë tek kafja me Arben Çejkun, - sqaroi me zërin, që ashtu si trupi i tij i ishte tkurrur, i ishte zbehur thellë.. Heshti një copë herë dhe, pyeti:

-Të kujtohet?

-Po, patjetër që e kujtoj - i përgjigjem.

Në fakt ishte një bisedë e bërë pak kohë më pare, po tek bar "Aroma". Atë ditë u diskutua për librin e Platonit, "Apologjia e Sokratit", e më pas për Danten, për Nicen, për... Arbeni i foli me shumë pasion mbi raportin e trupit me shpirtin, mbi frikërat për vdekjen, mbi poetët e shkrimtarët, që i kanë shkruar bukur dhe vdekjes, mbi hapsirën e vendin e veçantë, që kanë poetët në parajsë etj. Në fakt, ishte një bisedë e gjatë plot art e filozofi, që Beni e bëri me shumë dëshirë. Sigurisht, për t'i dhënë kurajo poetit tonë, që nga çasti në çast mund të ftohej në dyluftim nga vdekja, dhe të mundej si Pushkini. Mesa duket, ai këto fjalë po priste dhe unë me Benin, prandaj ishim aty.

-Kjo bisedë me Benin më nxiti të shkruaj këtë vëllim me poezi! -më tha. Dhe amaneti i Islamit ishte që unë të ndiqja tek shtëpia botuese "Dita Print" botimin e librit.

-Bëj ç'të duash me të, unë nuk kam mundësi ta ndjek proçesin e botimit, nuk lëviz dot më...

Bisedova me botuesin, një nga miqtë e çmuar të poetit, zotin Naim Buci, të cilin e sqarova mbi urgjencën që kisha për botimin e këtij libri. Naimi, u angazhua shumë seriozisht dhe me shumë dashamirësi, ndaj gjej rastin ta falënderoj atë së bashku me Alketa Lekën e Sokrat Gjovarën dhe stafin e shtypshkronjës.

Draftin e përgatitur ja tregova Islamit, tre ditë para se ai të na linte. Kjo ishte edhe biseda jonë e fundit. Ramë dakord për të gjitha detajet finale të librit dhe për titullin "Shtëpia prej fjale" dhe jo për "Paradise", siç e kishte titulluar ai në fillim. Bëri dhe dedikimin që e kishte me shumë merak. I lexova me zë poezinë, që do të vihej e para e që do të mbante si titull atë që i vumë edhe librit. Ja lexova dy herë që të ndryshonte ndonjë fjalë, por ai buzëqeshi me shumë dashamirësi, i pëlqeu... Ishte plotësisht dakord dhe e dha miratimin përfundimtarë për librin.

Të hënën, një kopje të printuar do ia sillja unë, thjesht për ta parë para se të futej në print.

Nuk arriti ta shikonte. Ndërkohë që nga shtypshkronja me njoftuan që të merrja këtë kopje, Nadi më njoftoi se Islami ishte shumë rëndë. Vajta tek banesa dhe kjo ishte dita, që unë do e shikoja me frymën e fundit poetin vdekatar.

Një kopje speciale të librit "Shtëpia prej fjale" e printuam me shumë urgjencë dhe ia dhamë me vete Islamit, si një pasaportë për në atë botë. Sot që libri është në duart tuaja, them se amaneti u përmbush! Ai e mori kopjen e parë të librit të tij, në një mënyrë që askush nuk e kishte imagjinuar, në një mënyrë më shumë sesa poetike! Një njeri po shuhej në shtratin e vdekjes, ndërsa shpirti i tij poetik po ngjallej si një libër në shtypshkronjë. Dhe ja, tani e kemi të gjallë mikun tonë, poetin që më shumë dhe më bukur se askush tjetër i këndoi jetës, dashurisë dhe vendlindjes së tij të bukur, Peshkopisë! Ditën e parë të panairit të librit, së bashku me Arben Çejkun shkuam fillimisht tek varri i poetit Islam Çenga, për të hyrë në panair, nga "Shtëpia prej fjale", në pragun e së cilës ishte Islami.

Ndërsa lexon këto poezi, nuk mund të mos reflektosh thellë! Janë fjalët dhe vargjet e një poeti, që këtë vëllim e shkroi duke pritur ditët, orët, minutat dhe sekondat për të kapërcyer në qiell, në qiellin e pafund, që nuk është më metaforë e poezive të tij, por banesa e përjetshme, nga ku ai rri e na vështron.

Lamtumirë Islam Çenga!



Rruga e Arbërit nr. 152
homazh

"Vikama e Skënderbeut", një poemë dhe poezi të suksesshme të autorit Astrit Gjunkshi

Me datë 3 dhjetor u mblodhën shumë miq të autorit Astrit Gjunkshi, poetë e lexues të apasionuar pas poezisë në mjediset e Qendrës Multifunksionale 'Ten'- ish kinema 'Dajti », në Tiranë, në veprimtarinë për prezantimin e librit «Vikama e Skënderbeut», krijim i këtij autori tashmë të suksesshëm. Libri, botim i M&B, është sponsorizuar nga z. Musa Riçku, botuesi i gazetës «Rruga e Arbrit» dhe përmban nga një poemë dhe poezi mjaft të arrira artistikisht e me përmbajtje me mjaft vlera. Ai u prezantua nga autori nga recensenti z. Behar Metohu. Regjisori, aktori e shkrimtari Aqif Ademi interpretoi disa poezi që u duatrokitën nga auditori, që vlerësoi shumë krijimtarinë e autorit. Bashkë me këtë libër, autori prezantoi edhe librin tjetër «Të hapësh botën e njeriut», që përfshin gjithashtu një poemë dhe poezi të tjera. Paraqitjen e reçencës për këtë libër e bëri dr. Stavri Trako.

Figura e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu ka qenë e pranishme në disa poezi që autori ka shkruar në librat e botuar në dy vitet e fundit. Por, ai gjykoi se nuk ishin të mjaftueshme ato poezi për të shprehur në vargje nderimin e pakufishëm të popullit tonë dhe ndjesinë e tij personale për njeriun më të madh që ka lindur kombi shqiptar në historinë e tij.

Dhe, pikërisht ky vit i 550 vjetorit të vdekjes së Heroit, ishte momenti më se i duhur që e frymëzoi atë për të shkruar një vepër më të plotë poetike, që përfshin poemën prej afro 30 faqe "Vikama e Skënderbeut", si dhe një «paketë» më të plotë me poezi kushtuar epokës Skënderbegiane dhe disa poezi me mesazhe që duhet të përçojë edhe sot te kombi shqiptar vepra e tij e lavdishme.


Poema «Vikama e Skënderbeut», që i ka djënë titullin të gjithë librit është vendosur në pjesën e parë të tij. Në pjesën e dytë janë sjellë disa poezi që evokojnë jetën e heroit dhe të popullit të tij gjatë asaj epoke të betejave fitimtare kundër perandorisë otomane. Në pjesën e tretë sillen poezi me temë aktuale, të cilat trajtojnë kryesisht momente të shqetësimeve të përditshme të shoqërisë sonë dhe të njeriut të thjeshtë, por mesazhet që ato japin parashtrojnë nevojën e reflektimit shoqëror me forcën e virtutit dhe të shpirtit të madh të lirisë, drejtësisë e krenarisë më të mirë kombëtare që kemi trashëguar nga Skënderbeu.

Poema « Vikama e Skënderbeut » është një vepër me subjekt që sjell në ditët e sotme një element kyç të historisë së epokës së Skënderbeut, siç janë fushëbetejat më të spikatura ku Heroi bëri historinë e tij dhe të kombit tonë, së bashku me popullin e tij. Nga pikëpamja historike, vepra është bazuar në leximet e marra nga historianë seriozë, kryesisht në shkrimet e profesor Kristo Frashëri, por dhe nga autorë të tjerë të parapëlqyer, përfshirë historianë të trevës dibrane.

Në veçanti, duke vlerësuar përpjekjet heroike për liri të mbarë popullit shqiptar, autori nënvizon rolin e veçantë të popullit të Dibrës në fitoret e Skënderbeut. Këtë pohim të fundit, autori e bazon në faktet historike të 18 betejave të zhvilluara jo rastësisht në këtë trevë. Si një prej strategëve më të mëdhenj të kohës së tij, Skënderbeu i ka përzgjedhur fushëbetejat me zgjuarësi, pikërisht për shkak të veçorive të terrenit në kufijtë me zotërimet otomane, por edhe të lidhjes së veçantë që ai kishte me Dibrën si vend i tij i origjinës dhe mbështetjes masive të popullit dibran.

Megjithatë, libri është një vepër letrare dhe jo historike. Për këtë arsye, autori përpiqet që elementët historikë t'i trajtojë artistikisht, duke mos hyrë në shumë detaje historike. Ai shfrytëzon ato elementë të spikatur historik që i shërbejnë synimit të tij për të përjetuar në ditët e sotme atë shpirt të madh të lirisë dhe të virtuteve që bënë të mundur fitoren e nje populli të vogël mbi superfuqinë e kohës.

Autori nënvizon se ishin shpirti i madh për liri i Skënderbeut dhe virtutet e zotësia si prijës i madh që bashkuan rreth tij princat e përçarë dhe popullin në sakrificat e paimagjinueshme, në betejat fitimtare kundër ushtrive të mëdha të sulltanëve. Ai arriti që këtë shpirt ta ngulisë thellë te komandantët dhe populli i tij, dhe këtu qëndron kyçi i shkëlqimit të asaj epokës së tij. Thelbi i synimit të poemës është të ngjallë sot këtë shpirt të madh te kombi shqiptar, duke u kthyer në vlerat më të mira të traditës,



përkundër deformimeve të mëdha aktuale në shoqërinë tonë.

Prandaj, dy personazhet e librit, Drit Rahoniku, shqiptar me origjinë nga Dibra e Madhe dhe arbëreshi Xhorxhio Bali, stërnip i plakut Balë, në vargjet e poemës e venë vazhdimisht theksin në këto vlera. Në çdo fushëbetejë që vizitojnë, shpirti i dikurshëm i kohës së Skënderbeut rritet vazhdimisht brenda shpirtit të tyre, deri në formën e një shtjelle të fuqishme. Përqasur me realitetin, ata të dy shpresojnë që kjo shtjellë të hyjë në të gjithë shpirtrat e shqiptarëve e t'i mobilizojë ata në përpjekje aktive për zhvillime europiane të kombit.

Vikama e Skënderbeut është thirrja e madhe simbolike e Heroit drejtuar kombit, përmes dy personazheve, për të çliruar energjitë më pozitive për progres të gjithanshëm të shoqërisë e të kombit shqiptar. Ky mesazh përshkon si poemën, ashtu dhe poezitë e përfshira në dy pjesët e tjera të librit.

Mendojmë se lexuesit do ta shijojnë këtë libër, me një lexim të vemendshëm, për vetë specifikën që ka kjo vepër e cila bashkon elementë letrarë, historik, filozofik e psiko-socialë. Njëkohësisht, libri përban një kontribut me vlerë në përkujtimin që kombi i përkushtoi Gjergj Kastriotit- Skënderbeut në jubileun të largimit të tij për në parajsë, me synimin për ta bërë edhe më të gjallë në ditët tona me ringjalljen e vlerave të tij më të spikatura në shoqëri dhe në trojet shqiptare.

Këto dy libra shpien në katër kolanën poetike të autorit Astrit Gjunkshi, duke konsoliduar kështu këtë studiues të fushës së sigurisë globale edhe si shkrimtar me mjaft vlera.

Ruzhdi Lata,dritë e shqiptarisë...

Nga **MEVLUD BUCI**



Ruzhdi Lata ishte një burrë i ndritur,ai gjithë jetën luftoi për shqiparinë dhe për fenë.Si njeri me fjalë të matur prej diplomat,me mendje të urtë prej filozofi,ai e kishte përsosur veten në rrugën e studimeve;kështu ka studiuar veprimtarinë e Anton Çetës,ka drejtuar Dibrën e Madhe si kryetar komune dhe Myftininë e saj.Në librin tim:"Myftinia e Dibrës dhe Ruzhdi Lata"i cili ,në vitin 2009 ,mori çmim të parë nga Akademia Islame në konkursin mbarëkombëtar të krijuesve të diasporës,në mënyrë modeste kam paraqitur punën e këtij njeriu,vështirësitë,pengesat dhe kapërcimet që ai u ka bërë atyre.Si mësues dhe drejtues arsimi në Dibër dhe bashkëpunëtor i shtypit, gjithnjë kam pasë parasysh fjalën e njerëzve të mençur dhe të korifejve të kulturës dibrane;dhe Ruzhdi Lata është njëri nga ata,edhe pse e njoha me vonesë, por, gjatë kontakteve me të, më duket vetja se duhej ta kisha njohur shumë kohë më parë.Në fillim të dhjetorit ,këtu rrëzë Rrunjës sime, dëgjova se Ruzhdi Lata kishte ndërruar jetë në nëntor 20018.Si ndodh me njeriun,nuk më besohej,ndërsa herën e fundit kisha pasur fatin të bëja foto me të, në zyrën e tij ,në Dibër të Madhe, duke ndjerë nga afër fjalët e tij,si njeriu i dashur popullor,punëtor i penës dhe i përkushtuar i besimit,e besues në vlerat fetare e njerëzore.Bir i thjeshtw i Dibrës dhe predikues i palodhur i vëllazërimit midis njerëzve,fjalëmbël e i sinqeërtë,njeri korrekt dhe me gjithë cilsitë që dallojnë një shqiptar të vërtetë që, meritueshëm,ngrihet në ato nivele.Ndaj sa dëgjova lajmin, kohën nuk e shava ,po thellë në vetvete psherëtiva dhe ndjeva dhimbje dhe u ula të shkruaj këto vargje:

Atë mëngjes marsi të vitit 2018
Me të shtrenjtin vëlla bëmë fotografi,
Tani shkove në parajsë ,ndërrove jetë
Zemër behar me shpirt dëlirësi.

U rrite në Hamje, rrëzë Kërçinit
Mes vuajtjeve nga klikë e Serbisë,
Përqafove dallgët e Drinit
Besimtar i rrallë i shqiptarisë.

Korbi i lartë i puthi retë
Runja lëshoi shtërngata,
Një misionar ndërroi jetë,
I shtrenjti, i thjeshti Ruzhdi Lata.

Në shtigje jete me prushe malli,
Kalove vëlla, zë shenjtëri,
Shpirti yt në dritë altari
Prijës i rrallë për myftini.

Sa herë më flisje me urtësi
Mendje,zemër m`i dritësoje,
Ruzhdi Lata mal për dibrani,
Besimtar,me hov shqiponje.

Shati yt, lis ndër livadhe,
Shpirti yt, shkulme Drini,
Lum çfarë ke moj Dibër e Madhe
Një Anton Çetë, vigan paqtimi.

Dhe kur thoje jam çidhnak
Se ç`na ndahu koha, epoka,
Gen mençurie fjalurtë në konak
Gen dibrani nga Grykë Noka.

Dhe le pas gjurmë trimnie
Gjurmë besimi e durimi,
Prijs i rrallë i myftinisë
Shpirt binjak me Murrën e Drinin.

Dibra këndej me gjelbërim e hijeshi
Përkulet shkrepbardha Runja
Zëbilbil për fe e vllazni
Si Omer kur qan Ajkuna...

Djep i nënës që të përkundi
Ndrit në simbol të krenarisë,
Ruzhdi Lata,jo nuk humbi
Rron në dritë të shqiptarisë...

Bëj pajtimin tënd me PayPal
përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

Meditim i Nazmi Koçit mbi supin e të cilit iku Zeqi Agolli

Zeqiu jetoi si njeri dhe iku si shenjt

Me Nazmi Koçin prej kohësh komunikojmë larg e larg, e kur ndodh që të jem në Tiranë pimë një kafe e marrim arratinë nëpër Dibër, luginës së Drinit e Zallit të Okshtunit, gjelbërimit e bukurive të natyrës e të njerëzve të një treve që të hyn e të del vetëm me shpirtin.

Më shkroi një letër, plot mall e dashuri për një njeri që iku pa ceremoni kur kundërshtari i tij "pushkë më pushkë" u nderua si një hero i madh... Letrën nuk mund ta mbyllja në ndonjë zarf në arkivin tim, nuk ishte për mua, ishte për të gjithë...


"I dashur Abdurahim!- shkruante

Ju përshëndes dhe ju uroj shëndet të plotë familjarisht.

Po flasim rrallë, por të kujtoj çdo ditë. Je duke bërë një punë shembullore dhe po vepron sipas një parimi që na thoshte dikur Ahmet Kaçori, sipas të cilit llamba ndriçon kudo që ta vendosësh, qoftë edhe në fund të korridorit.

Dhe ti ndriçon atje ku të ka rënë për pjesë. I ndjek e i vlerësoj mjaft shkrimet tua problemore. Me pëlqen qartësia dhe burrëria e shtrimit të problemeve, zë i fuqishëm i Dibrës e i Shqipërisë edhe atje ku jeton. Kësaj here dua të të përgëzoj me shumë zemër për shkrimin qe ke bërë për Zeqi Agollin. Në të kishte dashuri njerëzore për një njeri që u largua nga jeta, por dhe për memecët e shurdhët e kësaj bote.

Zeqi Agollin e pata shumë mik, jemi afër dhe me shtëpi. Me të më njohu Xhelil Gjoni, pasi ai pati një nevojë shëndetësore për mua. Ja ofrova me shumë kënaqësi në shtëpi. I njihja veprat e tij dhe për të më kishte folur im atë, Selmani, që kur isha fëmijë. Xhelili e donte



më i bukur shpirtërisht, këtë jo të gjithë ia shihnin se vinte disi i rezervuar. Kështu ndjehesha i lumtur që pata rastin fatlum që të bëhesha miku i tij.

Vdiq në mënyre krejt të pa pritur.

Vdiq në krahët e mi.

Ja si ndodhi: Me 3 nëntor, Xhelili pati ditëlindjen, e kishte përvjetor. Ai e bëri me fëmijët e tij që i erdhën apostafat nga jashtë. Ne vendosem që t'i pinim një kafe me këtë rast.

U takuam të premten më 16 nëntor dhe pimë atë kafen e zakonshme. Të nesërmen do të dilnim.

Në kafen e fundit me shprehu atë indinjatën e tij për çështjen e Mit'hat Frashërit.

"Ç'bëjnë këta? - me tha. "Po ne jemi gjallë dhe ai ka luftuar me armë kundër nesh. Unë mund të isha vrare nga plumbat e Mit'hatit e të shokëve të tij. Po të ishte për



Nazmi Koçi, Abdurahim Ashiku

dhe e kishte mik të vjetër. U bëmë miq dhe çdo të shtunë do të rrinim bashkë 1- 2 orë në kafe afër pallatit të tij (pranë Poliklinikës Qendrore këtu në Tiranë).

Në se ka të tillë, ai ishte edhe njeri edhe shenjt. Kur më pyeste, "po ty ç'të ka rënë mendja të bësh shoqëri me mua plakun?", i thosha se je shembulli me tipik i mundshëm që njeriu është i bukur në çdo moshë.

Dhe ai ishte i bukur vërtet. I bukur në mënyrë të padiskutueshme fizikisht, por akoma Mit'hatin e ca të tjerë ne nuk do të ishin rreshtuar midis fituesve të Luftës se Dytë Botërore dhe sot nuk do të kishte Shqipëri fare, as kështu me halle shumë siç e kemi tani".

Në kaq vjet njohje nuk e kisha parë asnjëherë të indinjuar në këtë shkallë dhe vendosa të bëj mjekun e ta qetësoj sa munda...

Të nesërme ishte 17 Nëntori, dita e çlirimit të Tiranës. Mora makinën dhe i vajta në shtëpi rreth orës 10 para dite. Jo vetëm ishte gati dhe me një entuziazëm të paparë, ju kishte thënë edhe vajzave se do te dilte me shokët për drekë, ishte zgjuar disa herë natën se mos mbetej vonë dhe zbriti menjëherë.

Ditën e çlirimit vendosa ti bëja një xhiro të vogël nëpër Tiranë dhe të shkonim të merrnim Xhelilin në shtëpi. Sistemuar mirë e bukur në makinë e duke shkëmbyer batuta, të buta e të kripura që vetëm ai dinte ti bënte, u nisem vetëm ne të dy për rrugë...

Nuk kishim bere as 50 metra rrugë me makinë, kur e ndërpreu bisedën dhe e vuri kokën në supin tim. U ktheva dhe e pashë, e kuptova se diçka shumë e keqe po ndodhte.

Duke ngarë makinën i hoqa protezën dhe vazhdova t'i flas. "Mbahu i thashë se je burrë i fortë", e putha në ballë dhe ndërrova drejtim, u nisa urgjent për në spital. Më kishin zënë rrugën, godita një makinë dhe kalova. Isha i detyruar të bëja shoferin, mjekun, shoqëruesin dhe familjarin. Pas 4 minutash ishim në urgjencën e spitalit...

Jetoi dhe nja një orë dhe dha shpirt në një ditë feste që ne po përgatiteshim ta festonim me shumë dëshirë....

Isha dhe jam ende i tronditur, u ndamë në mënyrë aq të pa pritur...

Mbi librin e përshtypjeve që kishin vënë familjarët në dalje të apartamentit u ula e shkrujta disa radhë me lot në sy...

Të dy e tradhtuam njëri-tjetrin jashtë natyrës sonë të vërtetë.

Ai kur më vuri kokën në sup e nuk më foli më...

Unë kur i hodha një dorë dhè dhe e lashë vetëm aty...

Zeqiu jetoi si njeri dhe iku si shenjt, bile tamam ditën e Çlirimit të Tiranës si një partizan i mirë që i kishte kryer me dinjitet detyrat.

Më mungon shumë, po, po, shumë ai njeri. Mbetet të jetojmë me kujtimin e tij të mirë."

Ti kishe bërë një mrekulli për të dhe për ne. Në këtë botë shurdh memece, ku njerëzit kanë "halle" të tjera dhe pak iu interesojnë vlerat njerëzore, solle dhe një herë një zë të fuqishëm, shumë të argumentuar se njerëz të tillë që bënë aq shumë për vendin e tyre nuk mund të largohen si hije e të harrohen aq shpejt.

Unë jam plotësisht në një mendje me ty dhe të përgëzoj...

Të përqafoj vëllazërisht, Nazmi Koçi

Tiranë,10 dhjetor 2018

***

Ishte një meditim njeriu për njeriun, miku për mikun, një shpirt i gjallë për një shpirt të arratisur.

Sikur të ishte shkruar me dorë, mbi letrën e bardhë pikat e lotit do t'i kishin shkrirë e bashkuar germat si bashkohen zemrat e njerëzve kur vajtojnë.

E bashkova lotin...

Abdurahim Ashiku, Athinë, 19.12.2018

Pranvera e fundit e Albana Ramës

Nga **Shaqir SKARRA**

Ubënë njëzet e pesë vite që Albana nuk është mes nesh. E lindur dhe rritur në Tiranë nga dy prindër të mrekullueshëm, Servet Rama e Nexhmie Rama (Cami). Ti Albana ishe jo vetëm cucë Shumbati, por edhe mbesa e miqve të mi; Emin, Maks, Sakip e Shpëtim Camit.

Ishe në moshën më të mirë kur ike nga kjo botë. Ti vazhdoje studimet në gjimnazin "Ismail Qemali dhe ishe me nota të shkëlqyera. Nuk i kishe nge lojërat e adoleshencës, sepse ti mendoje ndryshe nga shokët e shoqet e tua. Thonë se njeriu sapo lind, lindën së bashku me fatin dhe riskun që do ta ndjek gjatë gjithë jetës, thonë se lind bashkë me talentin për ata që e kanë, se jo të gjithë kanë talent. Ti kishe lindur e tillë nuk e more rrugës, e as ta dha kush. Jo, Albana ishe e talentuar në talentin tënd. Ti kishe ambicie të madhe Albana, premtoje për shumë por jeta jote u tregua e pa besë me ty, nuk të dha shumë kohë të shkëlqeje, dhe megjithatë e me atë kohë të shkurtër ti ishe dhe mbete një kometë gjithë shkëlqim.

Që e vogël fillove të merresh me atletikë në ekipin e "17 nëntorit" dhe gjithmonë keni shkëlqyer Albana. Nga atletika fillove me aerobi. Ende nuk njihej tek ne, madje paragjykohej, por ju me talentin tuaj i sfiduat të gjithë. E thjeshtë, e dashur, njerëzore, falje mirësi e dashuri për të tjerët. Ti e urreje egon, i doje shokët dhe shoqet e i ndihmoje të shkëlqenin edhe ata si ju. Kishe lindur vërtet artiste Albana nuk u bëre rrugës. Në shkollën e mesme "Ismail Qemali" krijove grupin e parë të aerobisë në vendin tonë nën drejtimin e Pëllumb Agalliut. Ishte iniciativë e madhe për kohën, sfidove të vjetrën.

Në vitin 1991, Shqipëria për herë të parë përfaqësohet në Moskë. Ishe ti që e bëre krenar çdo shqiptar në Moskë, duke nderuar veten dhe kombin me çmimin e lartë që more. Në koncertin e madh që u organizua në vendin tonë me rastin e 22 marsit ti Albana ishe edhe soliste edhe drejtuese e atij grupi fëmijësh. Në spektaklin televiziv "12 vallëzime pa një të shtunë" ku debutove së bashku me Enton Lugën talenti yt ra në sy edhe të organizatorëve dhe prezantuesve si Vera Grabocka e Adi Krasta. More edhe vlerësimet maksimale që mund të merren në një eveniment të madh kombëtar.

Edhe në spektaklin tjetër televiziv "Rreth fatit për 12 javë", në natën e vitit të ri debutove bukur duke shpalosur talentin tënd që nga dita në ditë vinte në rritje e emri yt po lakohej në të gjitha mediat vizive e të shkruara.

Duke parë talentin tënd, duke vëzhguar nga afër se aerobia që deri dje nuk njihej fare nga ne dhe në saj të guximit, vullnetit e talentit tënd mori një rritje dimensionale, të doli e drejta e studimit për në Francë Albana. Do të studioje në një nga Universitetet më të njohura të Francës vetëm për aerobi e kërcim klasik..

Në mëngjes të asaj pranvere të vitit 1996, ku lulet kishin çelur



ti u nise herët për në Gjirokastër. U përshëndete me të gjithë njerëzit e familjes me fjalën e madhe shqiptare: "Mirë ardhsh e e dalsh me suksese si gjithmonë". Kështu të uruan Serveti e Nexhmija, kështu të uroj dhe motra jote më e vogël Elona, po ku ta dinin ata se ti nuk do të ktheheshe e gjallë më nga Gjirokastra, ku ta dinin se fati yt do të ishte tragjik, se vdekja juaj e parakohshme udhëtonte së bashku me ju këtë pranverë.

Ishte pranvera e fundit për ty Albana, lulet kishin çelur por jo për ty se fundja ti nuk kishe nevojë për lule, ishe vetë lule, ishe një gonxhe në shpërthim. Makina me të cilën udhëtoje po ecte, po rrëshqiste mbi asfaltin e zi, ndoshta ishte shpejt, ndoshta ndodhi ndonjë defekt, ndoshta ishte shkruar që ditën që linde Albana por makina përmbyset në rrugë, përmbyset keq e aksidenti ishte fatal vetëm për ty. Në atë makinë kishte dhe të tjerë, por ti i duheshe Zotit atë ditë. Spitali i |Gjirokastrës ishte i pafuqishëm të shpëtonte nga kthetrat e zeza të vdekjes, po kështu edhe spitali ushtarak (sot trauma) u gjend i dorëzuar përballë forcës së Zotit.

Ora shënonte 2 e natës, shpirti yt Albana iku, iku nga kjo botë zhurmëmadhe e fluturoi lart në qiell. I le me lot në sy të gjithë, të gjithë kush u ndodh atë natë pranvere aty. Vdekja jote para kohe i pikëlloi të gjithë, pikëlloi edhe Vera Grabockën e Adi Krastën se ata më mirë se kushdo e dinin talentin tënd. Funerali yt ishte ndryshe, një turma e madhe e njerëzve që kërkonte të jepnin lamtumirën e fundit. Erdhën shokë e shoqe. Erdhi Shumbati e Dibra.

Albana, na këputi malli për ty, na kanë mbetur ende lotët në sy. Do të vijnë pranvera përsëri, do të çelin lulet që ti i deshe shumë. Jeta do të vazhdojë Albana por emri yt kurrë nuk do të harrohet. Do të kujtojnë të gjithë se ti ishe një kometë që shkëlqeve pak, por le gjurmë te të gjithë.

Rruga e Arbërit nr. 152



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

BOTIMET M&B

Librat më të shitur gjatë vitit 2018. Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë rrjetit të librarive "ADRION", librari "Art's" të Stacioni i Trenit në Tiranë, FletaXXI në Peshkopi ose mund ti porosisni përmes agjencive të shpërndarjes së librit.



printime dixhitale

DUKE FILLUAR NGA 1 KOPJE E VETME

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

cyan magenta yelloë black